

VENDIM
Nr. 505, datë 29.8.2018

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR HEQJEN NGA PËRDORIMI DHE ELIMINIMIN E NDOTËSVE ORGANIKË TË QËNDRUESHËM (NOQ)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm (NOQ), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Vendimi nr. 860, datë 20.12.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm”, shfuqizohet.
 3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe të gjitha ministratë e institucionet e përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT
PËR HEQJEN NGA PËRDORIMI DHE ELIMINIMIN E
NDOTËSVE ORGANIKË TË QËNDRUESHËM
(NOQ)

(Numri i projektit: GFL-2310-2760-4E40-2202)
Tiranë, maj 2018

SHKURTIMET

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
BAT	Përdorimi i teknikave më të mira
BE	Bashkimi Evropian
DDT	Diklor-difenil-trikloretan
DPPK	Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave
DRM	Drejtoria Rajonale e Mjedisit
ESP	Polistirenet e zgjeruara
ESX	Polistirenet e presuara
HBB	Hekzabromobifenili
HBCD	Hekzabromociklododekani
HCB	Hekzaklorbenzeni
HEC	Hidrocentral
INSTAT	Instituti i Statistikave
IShP	Instituti i Shëndetit Publik
KE	Këshilli Evropian
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
KM	Këshilli i Ministrave
MBZHR	Ministria përgjegjëse për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural
MIE	Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Energjinë
MFE	Ministria përgjegjëse për Financat dhe Ekonominë
MEPJ	Ministria përgjegjëse për Evropën dhe Punët e Jashtme
MTM	Ministria përgjegjëse për Mjedisin
MSHMS	Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale
NOQ	Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OJF	Organizata Jofitimprurëse
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PBDEs	Difenil eteret e polibromuara
PBB	Prodhimi i brendshëm bruto
PCBs	Bifenilet e poliklorinuara
PCDD	Dibenzo-p-dioksinat
PCDF	Dibenzofuranet e polikloruara
PCP	Pentaklorfenoli
PCNs	Naftalenet e poliklorinuara
PCNB	Pentakloronitrobenzen
PFOS	Acidi perfluoroktan sulfonik
PFOSF	Floruri i perfluoroktan sulfonilit
PeCB	Pentaklorobenzeni
PFC	Komponime të perflorinuara
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PMB	Produkte të mbrojtjes së bimëve
RGjM	Raporti i Gjendjes së Mjedisit
SOH	Substanca ozonholluese
UBT	Universiteti Bujqësor i Tiranës

UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
UPT	Universiteti Politeknik i Tiranës
UT	Universiteti i Tiranës
VIM	Vlerësimi i Impaktit Mjedisor
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky Plan Kombëtar Veprimi (PKV) i përditësuar, përbën një dokument të rëndësishëm për qeverinë shqiptare mbi menaxhimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ) në vendin tonë, pasi jep një vlerësim të gjendjes së inventarit aktual, aspektet ligjore, institucionale dhe teknike. Ai është përgatitur bazuar në metodologjinë e UNEP-it (Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin) për përgatitjen, rishikimin dhe përditësimin e PKV-së. Të gjitha institucionet dhe aktorët e përfshirë në menaxhimin e NOQ-ve në vend kanë pasur mundësinë për të kontribuar duke marrë pjesë në procesin e përditësimit dhe përgatitjes së PKV-së.

Konventa mbi NOQ-të është përgatitur në vitin 2001, në kuadër të përpjekjeve për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin dhe qëllimin për të kufizuar dhe eliminuar rrezikun nga NOQ-të. Shqipëria ka nënshkruar Konventën më 5 dhjetor 2001 dhe e ka ratifikuar atë më 4 tetor 2004. Konventa e NOQ-ve përcakton një varg detyrimesh që palët duhet të inkurajohen të ndërmarrin në lidhje me menaxhimin e NOQ-ve, si përcaktimin e pikave fokale kombëtare, nxitjen e shkëmbimit të informacionit, sigurimin e asistencës teknike, nxitjen dhe lehtësimin e ndërgjegjësimit të publikut me anë të pjesëmarrjes, konsultimit dhe edukimit, nxitjen e kërkimit, monitorimi dhe raportimi “në intervale periodike” mbi gjendjen dhe masat që duhet të merren për eliminimin ose reduktimin e NOQ-ve.

Në këtë kuadër, objektivi kryesor i këtij Plani Kombëtar Veprimi (PKV) konsiston në evidentimin e gjendjes së NOQ-ve në vendin tonë dhe përditësimin e Planit Kombëtar të Veprimit të parë (2006), për të mundësuar hartimin e masave dhe strategjisë për reduktimin, ndalimin dhe eliminimin e NOQ-ve.

Informacion i përgjithshëm

Shqipëria është një vend i vogël i pozicionuar në pjesën perëndimore të gadishullit të Ballkanit, në brigjet lindore të deteve Adriatik dhe Jon. Territori i saj ndodhet në koordinatat gjeografike 42°39' dhe 39°38' gjatësi gjeografike veriore dhe 21°4' dhe 19°16' gjatësi gjeografike lindore. Sipërfaqja e Shqipërisë është 28'748 km², nga të cilat rreth 27'398 km² janë tokë dhe 1'350 km² ujë. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë përcakton përfshirjen e territorit në zonën klimaterike nëntropikale Mesdhetare, me dimër të butë dhe të lagësht, verë të nxehtë dhe të thatë me reshje të përqendruara kryesisht gjatë gjysmës së ftohtë të vitit.

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë në Shqipëri është regjistruar së fundmi në vitin 2015 në 4541.39 dollarë amerikanë. Bujqësia mbetet një prej sektorëve më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm në Shqipëri. Bujqësia është burimi kryesor i punësimit dhe të ardhurave, veçanërisht në zonat rurale të vendit. Bujqësia kontribuon në 18.9% të PBB-së së vendit. Sektori i industrisë ka kontribuar qëndrueshëm me rreth 11% të PBB-së. Aktivitetet kryesore industriale janë industria e nxjerrjes së naftës dhe gazit, industria e përpunimit, industria e lehtë, industria e ushqimit dhe pijeve, prodhimi i çimentos, metalurgjia dhe minierat.

Shqipëria është e pasur me shumë burime energjie, naftë dhe gaz, qymyr dhe lëndë djegëse fosile, si dhe hidrocentrale dhe burime të tjera të rinovueshme energjie dhe sektori i energjisë kontribuon me rreth 10% të PBB-së. Pjesa tjetër e kontributit në PBB përfshin sektorë të ndryshëm të ekonomisë si të shërbimeve, ndërtimit, transportit, komunikimit etj.

Përmbledhje e çështjeve mjedisore

Shqipëria ka trashëguar shumë probleme mjedisore nga e kaluara, të tilla si: erozioni i tokës, shpyllëzimi, humbja e biodiversitetit, mbetjet urbane, ndotja e ajrit në zonat urbane dhe industriale, ndotja e tokës të shkaktuar nga mbetjet e dëmshme të industrive etj.

Raporti i Gjendjes së Mjedisit (RGjM) përgatitet çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM). Informacioni mbi gjendjen e mjedisit është dokumenti bazë që analizon gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Shqipëri, dhe jep rekomandime për politikën e planifikimit mjedisor me bazë njëvjeçare.

Cilësia e ajrit në Shqipëri ndryshon shumë në varësi të vendndodhjes: në zonat rurale dhe malore ajri është i pastër, ndërkohë që në qytete dhe në afërsi të zonave industriale cilësia është shumë më e dobët. Monitorimi i cilësisë së ajrit përqendrohet për indikatorët: PM₁₀, PM_{2.5}, O₃, NO₂, SO₂, CO dhe Benzeni.

Bazuar në vlerësimin e të dhënave të vitit të fundit në Tiranë është vëzhguar një rënie prej 20% në nivelin e përqendrimit të PM₁₀ dhe PM_{2.5}. Kjo ka ndodhur për shkak të përmirësimeve të bëra në infrastrukturë dhe për shkak të disa masave legislative të ndërmarra në lidhje me standardizimin e makinave dhe automjeteve të përdorura. Në nivel kombëtar, përqendrimi i CO-së dhe Benzenit është në përputhje me standardet e BE-së.

Shqipëria është e pasur me burime ujore, monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe ujërave bregdetare tregon një përmirësim të cilësisë së ujërave gjatë viteve të fundit, për shkak të disa investimeve të bëra në infrastrukturën e trajtimit të ujërave të ndotura.

Shqipëria ka një nivel të lartë diversiteti biologjik të peizazheve, ekosistemeve dhe nivelin e specieve, kjo në raport me sipërfaqen e vogël që ka vendi ynë.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve industriale ka pësuar një trend rritës gjatë viteve të fundit, kjo shpjegohet midis të tjerave me anë të ndryshimit të sjelljes shoqërore të njerëzve dhe si reflektim i ndryshimit të stilit të tyre të jetesës. Mbetjet industriale dhe mbetjet urbane përbëjnë grupin kryesor të mbetjeve në vendin tonë. Mbetjet e menaxhuara trajtohen kryesisht duke i depozituar ato në landfille dhe vende të tjera ruajtëse të miratuara nga organet përkatëse të qeverisjes vendore.

Një ligj i ri mbi mbrojtjen mjedisore është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2012. Objektivi i tij ka qenë rritja e nivelit të mbrojtjes mjedisore duke vendosur një rrjet të konsoliduar institucionesh mjedisore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, i lidhur me implementimin e politikave mjedisore. Në përgjithësi Shqipëria ka treguar progres mbi çështjet mjedisore, në lidhje me menaxhimin e problemeve mjedisore, por duhen ende shumë përpjekje veçanërisht për implementimin e legjislacionit mjedisor. Në fazat e para të zhvillimit të tyre janë, veçanërisht trajtimi i ujërave dhe menaxhimi i mbetjeve.

Politikat mjedisore, kuadri ligjor dhe institucional që kanë lidhje me NOQ

Bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë kërkohet që institucionet të ruajnë një mjedis të shëndetshëm, ekologjikisht të përshtatshëm për brezat aktualë dhe ata të ardhshëm. Këshilli i Ministrave (KM) ka përgjegjësinë për zhvillimin e politikave mjedisore në Shqipëri. Institucioni kryesor përgjegjës për çështjet mjedisore është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), e cila synon të zhvillojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen e mjedisit, nga pikëpamja e zhvillimit të qëndrueshëm. Për disa çështje mjedisore janë përgjegjëse disa ministri të tjera dhe agjenci shtetërore në nivel qendror dhe lokal.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) u themelua në vitin 2014 dhe është një institucion qendror publik, i pavarur në vendimmarrje dhe që e ushtron juridiksionin e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë. Në nivel lokal, ka disa autoritete lokale bashkë me drejtoritë rajonale të mjedisit (DRM) dhe inspektoratin lokal të cilët marrin masa për të mbrojtur shëndetin e njerëzve dhe mjedisin nga kimikatet.

Në dekadën e fundit dhe veçanërisht që nga viti 2001, janë hartuar dhe miratuar disa ligje dhe akte ligjore për mjedisin. Korniza ligjore kombëtare e Shqipërisë është e harmonizuar gjerësisht me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE). Ajo bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përbëhet nga ligje dhe akte nënligjore, të tilla si vendime të Këshillit të Ministrave (VKM), akte ministrore, rregulla, udhëzime dhe standarde.

Përveç kornizës ligjore shqiptare, Republika e Shqipërisë respekton detyrimet ndërkombëtare të vendosura nga konventat dhe marrëveshjet e ratifikuara nga shteti shqiptar, siç është Konventa e Stokholmit mbi Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (NOQ), e ratifikuar nga ligji nr. 9263, datë 29.7.2004.

Legjislacioni në lidhje me substancat kimike në Republikën e Shqipërisë rregullon menaxhimin e substancave dhe përzierjeve kimike, produkteve të mbrojtjes së bimëve, substancave shpërthyes, substancat e gazta dhe të lëngshme të djegshme, substancat e rrezikshme, substancat ozonholluese, ndotësit organikë të qëndrueshëm etj.

Akti i parë nënligjor që lidhet drejtpërdrejt me NOQ-të është VKM-ja nr. 860 datë 20.12.2006, “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm”, që kishte për qëllim rehabilitimin e disa zonave të ndotura me NOQ, si dhe eliminimin dhe largimin e mbetjeve të kimikateve, NOQ-ve nga vendi ynë për djegjen e tyre.

Një akt nënligjor i rëndësishëm që lidhet me NOQ-të është VKM-ja nr. 360, datë 29.4.2015, “Për miratimin e listës së Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”, i cili ka për qëllim të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga ndotësit organikë të qëndrueshëm (NOQ), bazuar në parimin e parandalimit, nëpërmjet: a) ndalimit, nxjerrjes nga përdorimi të NOQ-ve ose kufizimit të prodhimit, vendosjes në treg dhe përdorimit sipas përcaktimeve të dhëna në këtë vendim; b) reduktimit të shkarkimeve në mjedis të NOQ-ve deri në eliminimin e tyre; c) menaxhimit të mbetjeve që kanë në përbërjen e tyre ose që janë të kontaminuara me NOQ.

Gjithashtu, VKM-ja nr. 387, datë 6.5.2015, “Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-

ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura”, ka për qëllim të rregullojë asgjësimin e kontrolluar të PCB-ve, çndotjen ose asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e PCB-ve të përdorura, në mënyrë që ato të eliminohen plotësisht në vendin tonë.

Çështjet e mëposhtme janë identifikuar për t’u konsideruar në lidhje me kuadrin institucional ekzistues në Shqipëri:

- Vlerësimi i organeve dhe strukturave ekzistuese, si kapaciteti më i rëndësishëm veprues, për vlerësimin e rëndësisë të çështjeve që rrjedhin nga Konventa e NOQ-ve;
- Rivlerësimi dhe përditësimi i detyrimeve konkrete, që institucionet përkatëse kanë aktualisht në lidhje me menaxhimin e NOQ-ve, në përputhje me funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre;
- Krijimi i skemës së re institucionale, e cila të përfshijë të gjitha strukturat dhe organet në nivel qendror dhe vendor, përcaktimin e roleve, funksioneve, përgjegjësiave, kompetencave dhe detyrave të secilit prej tyre, marrëdhënien e tyre dhe rregullat e funksionimit të të gjithë sistemit;
- Përcaktimin e pikave të kontaktit në nivel kombëtar dhe lokal dhe/ose sektorial, të cilat së bashku përbëjnë Rrjetin Kombëtar të NOQ-ve;
- Pikat e kontaktit duhet të ndërtojnë skemën e tyre të komunikimit, si dhe duhet të përgatisin programe operative për mënyrën e realizimit të detyrave respektive.

Në kuadër të përgjegjësiave për zbatimin e Konventës së Stokholmit është e nevojshme të ndërmerren një numër masash si vijon:

- Përmirësimi /përditësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor kombëtar në lidhje me çështjet që adresojnë NOQ;
- Rritja e kapaciteteve institucionale në nivel qendror dhe lokal;
- Vlerësimi dhe përgatitja e një inventari kombëtar të NOQ-ve, si dhe përditësimi i tij;
- Hartimi, përditësimi dhe zbatimi i një plani kombëtar për menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre kimikateve në mënyrë për të reduktuar ndikimet e tyre negative në shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Vlerësimi i gjendjes së NOQ-ve në Shqipëri

Pesticidet NOQs

Vlerësimi aktual i gjendjes së pesticideve NOQ bazohet kryesisht te NOQ-të e rinj pasi inventari i NOQ-ve të tjerë, të cilët janë listuar në Konventën e Stokholmit në vitin 2001, janë prezantuar në PKV-në e parë të vitit 2006.

Në grupin e NOQ-ve të rinj të përdorur si pesticide futen: klordekone (chlordecone), alpha heksaklorocikloheksani, beta heksaklorocikloheksani, lindani, pentaklorobenzeni dhe endosulfani. Për NOQ-të e rinj të përdorur si pesticide, të dhënat u morën nga Ministria përgjegjëse për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe kompanitë tregtuese mbi sasinë e importit, përdorimin dhe gjendjen e mundshme të tyre deri tani. Të dhënat e marra tregojnë që nga gjithë NOQ-të e rinj të përdorur si pesticide, vetëm endosulfani është importuar, tregtuar dhe përdorur në vendin tonë gjatë 10-vjeçarit të fundit. Importi i thiodanit në vendin tonë ka vazhduar deri në vitin 2005 dhe më pas është ndaluar. Sasia e përdorur nga viti 2004 më 2007 është 7820 litra thiodan dhe bazuar në këto të dhëna mund të prezumohet që mbetjet e endosulfanit në mjedis janë jo të konsiderueshme.

DDT-ja dhe lindani

DDT-ja dhe heksakloran/lindani u hoqën nga Shqipëria në kuadër të projektit të MMPAU-së, “Ripaketimi dhe heqja nga Shqipëria e pesticideve dhe e kimikateve të tjera nga Bishti i Pallës”, të financuar nga qeveria holandeze dhe ky eliminim u përfundua në korrik 2006.

Gjatë inspektimit të vendeve me mbetje të mundshme të këtyre pesticideve sidomos në Portoromano–Durrës, konstatohet që ish-zona qendrore e prodhimit të lindanit pas largimit të mbetjeve, është e rrethuar dhe kapsuluar (betonuar) dhe në parim nuk lejon ndotje të mëtejshme. Por emeteimet e mëparshme nëpërmjet: ajrit, rrjedhjeve ujore, erozionit të tokës dhe bazuar në qëndrueshmërinë e lartë të këtyre komponimeve na çojnë në përfundimin se monitorimi i zonës përreth, analiza të tokave, ujërave, e organizmave bimorë dhe shtazorë, analizimi i mostrave të gjakut të njeriut për vlerësimin e ndikimit në shëndet dhe mjedis të NOQ-ve dhe mbetjeve të tyre dhe ecurinë e këtyre komponimeve është i domosdoshëm.

Përfundime dhe rekomandime

- Nuk ka gjendje fizike dhe nuk përdoren pesticide NOQ në vendin tonë;
- Nuk ka një vlerësim dhe monitorim të mbetjeve të pesticideve NOQ në mjedis dhe shëndet, të transportit të tyre në organizma bimorë dhe shtazorë.
- Nuk kryhen analiza të papastërtive ose të komponimeve shoqëruese të pesticideve që importohen/tregtohen në vendin tonë, pasi ata mund të përmbajnë pesticide NOQ.

- Të realizohen studime të gjendjes së pesticideve NOQ në mjedis për të marrë masat për reduktimin/eliminimin në zonat që mund të rezultojnë me nivele të larta ose tej normave të lejuara;
- Të monitorohen mbetjet e pesticideve NOQ në zonat e ndotura, hotspotet e evidentuara ndikimi i tyre në mjedis dhe shëndet dhe të jenë pjesë e vlerësimit dhe raportimit të gjendjes së mjedisit në vendin tonë.
- Të realizohen analiza cilësore dhe sasiore jo vetëm të lëndëve aktive të pesticideve që lejohen të importohen/tregtohen në vendin tonë, por edhe e papastërtive ose mbetjeve të tyre për prezencë të mundshme të pesticideve NOQ.

Bifenilet e poliklorinuara (PCBs)

Gjendja ose inventari i PCB-ve në vendin tonë lidhet kryesisht me përmbajtjen e tyre në transformatorët/kondesatorët që përdoren në sistemin energjetik. Sistemi energjetik aktual përbëhet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE). Informacioni mbi gjendjen e transformatorëve dhe mundësinë e përmbajtjes së PCB-ve që lidhet kryesisht me ekzistencën e transformatorëve të vjetër të prodhuar para viteve 1990 u morr nga kompanitë e mësipërme.

Të dhënat aktuale mbi inventarin e transformatorëve në sistemin energjetik të vendit tonë tregojnë që ka një numër total të transformatorëve rreth 12789, dhe sasia totale e vajit të transformatorëve ishte rreth 8.679.542 litra.

Rreth 47% e sasisë së përgjithshme të transformatorëve janë prodhuar para vitit 1990 (rreth 6000 copë) dhe vjetërsia mesatare e transformatorëve është më e madhe se 28 vjet. Rreth 97 % e transformatorëve janë transformatorë të vegjël të vendosur në kabina elektrike që i përkasin OSHEE-së. Pjesa tjetër e transformatorëve është vendosur në HEC-et e KESH-it dhe në nënstacionet e OST-së e OSHEE-së, rreth 288 prej tyre i përkasin OSHEE-së, 39 i përkasin KESH-it dhe 67 i përkasin OST-së.

Nga të dhënat e inventarit të parë të PCB-ve rezultoi se 5,3% e sasisë së vajit pritej të ishte e ndotur me PCB-në. Aktualisht, KESH-i ka kryesisht transformatorë të rinj që i takojnë periudhës pas vitit 1990, duke përjashtuar mundësinë e përmbajtjes së PCB-ve në vajin e tyre pasi dhe mbushja me vaj e transformatorëve bëhet me vaj pa përmbajtje të PCB-ve.

Në objektet energjetike shqiptare janë akoma në përdorim mjaft transformatorë të vjetër të prodhuar para vitit 1990, të cilët kanë krijuar ndotje të mjedisit veçanërisht në tokë dhe ujë për shkak të rrjedhjeve të vajit dhe pikimeve gjatë procesit të mirëmbajtjes ose për shkak të vjetërsisë së tyre.

Një vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet zonave më të ndotura me vaj transformatorësh siç janë reparti i riparimit të transformatorëve në Tiranë që i përket OSHEE-së dhe reparti i rigjenerimit të vajit në Tiranë që i përket OST-së.

Përfundime dhe rekomandime

- Për shkak të përdorimit të transformatorëve shumë të vjetër, riparimit të tyre në kushte jo plotësisht me standarde rezultojnë që disa mjedise poshtë transformatorëve ose në mjediset e riparimit të tyre të vërehen rrjedhje vaji dhe ndotje potenciale të mjedisit përreth me PCB-të, kjo sidomos në repartin e riparimit të transformatorëve në Tiranë ku ndodhet edhe magazina qendrore për të gjithë transformatorët e dëmtuar që vijnë nga të gjitha rrethet e Shqipërisë dhe Reparti i Rigjenerimit të Vajit në Tiranë.

- Sipas të dhënave të inventarit rezultojnë që prania e PCB-ve në vendin tonë është relativisht e ulët, por një studim më i plotë duhet në këtë drejtim.

- Duhet të ndërmerren masat e nevojshme për pastrimin e vendeve të ndotura me vajra të pajisjeve elektrike dhe, potencialisht, me PCBs.

- Duhet të funksionojë një sistem monitorimi për kontrollin e pajisjeve me PCBs dhe analiza të sistemeve mjedisore mbi prezencën potenciale të PCBs për të marrë masa mbi reduktimin/eliminimin e PCBs nga mjedisi.

NOQ-të e prodhuar joqëllimisht

Llogaritja e shkarkimeve të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht PCDD/PCDF bazohet në metodologjinë e dhënë nga UNEP-i (2013). Sipas kësaj metodologjie identifikohen 10 burime të mundshme të shkarkimeve të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht, me emetime në ajër, ujë, tokë, produkte dhe mbetje që shprehen në gram toksicitet ekuivalent në vit.

Të dhënat përmbledhëse të inventarit aktual të shkarkimeve të mundshme të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht në vendin tonë janë afro 49 g TEQ/vit.

Burimi i djegieve të pakontrolluara të mbetjeve është kontribuesi kryesor i emetimeve të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht në mjedis me afro 40% të emetimeve. Vërehet një pakësim i kontributit të djegieve të pakontrolluara të mbetjeve në emetimin e NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht krahasuar me raportimin

e parë në vitin 2006, nga 73.54% në 40% për shkak të disa masave të marra vitet e fundit në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në vendin tonë. Djegia e mbetjeve në impiante djegieje ose incenerator është, gjithashtu, një burim i emetimit në mjedis të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht me afro 13%, këtu vendin kryesor e zënë djegia e mbetjeve spitalore.

Përfundime dhe rekomandime

- Djegiet e pakontrolluara të mbetjeve janë kontribuesi kryesor i emetimeve në mjedis të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht.

- Djegia e mbetjeve në impiante djegieje ose incenerator është gjithashtu një burim i emetimit në mjedis të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht, këtu vendin kryesor e zënë djegia e mbetjeve spitalore.

- Masa të përshtatshme duhet të ndërmerren për menaxhimin e mbetjeve në mënyrë që të reduktohet emetimi në mjedis të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht dhe efektet negative që shkaktojnë në shëndetin e banorëve, veçanërisht për djegien e mbetjeve të pakontrolluara dhe mbetjeve spitalore.

Difenil eteret e polibromuara (PBDEs): heksaBDE, heptaBDE, tetraBDE dhe pentaBDE

PoliBrom Difenil Eteret (PBDEs) janë një grup komponimesh organike aromatike të bromuara, të cilat janë përdorur në industrinë elektronike për prodhimin skeleteve plastike të pajisjeve kompjuterike dhe në industrinë e transportit për prodhimin e mbushjeve në automjete.

Metodologjia e inventarit të NOQ-PBDEs në mallra dhe produkte të ndryshme, si dhe mbetjet e tyre bazohet në udhëzuesin për inventarin e PBDEs që listohen në Konventën e Stokholmit si NOQ.

Të dhënat e inventarit tregojnë se një sasi prej 2130 kg PBDEs në pajisjet elektrike dhe elektronike dhe sasia kryesore prej afro 1999 kg gjendet në pajisjet elektrike dhe elektronike të përdorura ose shitura. Nga të dhënat e marra vihet re se sasia e NOQ-PBDEs që kalon si mbetje është më e lartë (**128.25 kg**) se sasia e NOQ-PBDEs që hyn gjatë importimit (**3.22 kg**).

Të dhënat e inventarit tregojnë se një sasi prej afro 28952 kg PBDEs gjendet në makineritë e transportit dhe sasia më e madhe e NOQ-PBDEs vjen nga makinat e prodhuara para vitit 2005 (afërsisht 25077 kg) në krahasim me makinat e prodhuar pas vitit 2005 (127 kg).

Përfundime dhe rekomandime

- Burimet kryesore për emetimin në mjedis të NOQ-PBDEs janë pajisjet elektrike dhe elektronike të vjetra ose kryesisht kompjuterët dhe televizorët CRT, si dhe automjetet e transportit të prodhuara para vitit 2005, pasi këto mallra kanë përmbajtje më të lartë të komponimeve të PBDEs.

- Reduktimi i përdorimit të kompjuterëve dhe televizorëve CRT dhe automjeteve të prodhuara para 2005 është i domosdoshëm për të reduktuar/eliminuar emetimin e NOQ-PBDEs në mjedis.

Acidi perfluoroktan sulfonik (PFOS), kripërat e tij dhe floruri i perfluoroktan sulfonilit (PFOF)

PFOS-ja dhe kripërat e tij janë përdorur në disa sektorë ekonomikë. Inventari i tyre, para së gjithash, bazohet në përcaktimin e burimeve ku këto komponime janë të pranishëm dhe të dhënat e mbledhura janë përdorur për llogaritjen e sasisë së PFOS-ve. Inventarizimi i PFOSs bazohet në udhëzuesin e UNEP-së “Udhëzues për inventarin e acidit perfluoroktan sulfonik (PFOS) dhe kimikateve të lidhura me të që janë listuar në Konventën e Stokholmit si Ndotës Organikë të Qëndrueshëm” (UNEP 2012).

Sasia e llogaritur e PFOS-ve varion nga 186.75 kg/vit në 12552.5 kg/vit ose sasia mesatare gjendje e PFOS-vë është afro 7208 kg/vit. Burimi kryesor i tyre vjen nga përdorimi i letrave të kuzhinës, dhe kartonëve të ndryshëm e variojnë nga 500 kg/vit deri në 5000 kg/vit, e ndjekur nga përdorimi i qilimave sintetik; tekstileve dhe sixhadeve, si dhe përdorimi i lëkurëve me variacion nga 250–2500 kg/vit; 200–2000 kg/vit dhe 150–1500 kg/vit, respektivisht.

Përfundime dhe rekomandime

- Burimet kryesore të emetimit në mjedis në vendin tonë të acidit perfluoroktan sulfonik (PFOS) dhe substancave që lidhen me të janë kartonët, ambalazhet dhe letrat e plastifikuara, produktet e lëkurës dhe lëngjet hidraulike etj., ndërsa ky komponim nuk ka pasur përdorim si pesticid.

- Kontrolli i cilësisë së produkteve që mund të përmbajnë PFOS është i rëndësishëm për të reduktuar/eliminuar emetimin në mjedis dhe efektet negative të mundshme në shëndet të NOQ-PFOS dhe substancave që lidhen me të.

Hekzabromciklododekan (HBCD)

Aplikimi kryesor i HBCD-ve është në shkumat polistirene që përdoren për izolim, të cilat përdoren gjerësisht për ndërtime dhe konstruksione. Izolimi me këta tipa shkumash mund të gjendet dhe në mjetet e transportit dhe argjinaturat e rrugëve dhe hekurudhave. Këto shkuma polistirene gjenden në dy forma dhe përmbajnë 0.7 deri 3%. Aplikimi i dytë më i rëndësishëm është në mbulesat tekstile ku HBCD-ve ndodhet në përqendrime 2.2–4.3%.

Një aplikim tjetër, por më i vogël është në pajisjet elektrike dhe elektronike në të cilat përqendrimi i

HBCD-ve varion nga 1–7%.

Inventarizimi i HBCD-ve në nivel kombëtar sikurse në të gjitha rastet e inventarizimit të ndotësve organikë të qëndrueshëm bazohet në udhëzuesin e UNEP-it për inventarin e HBCD-ve (2015).

Të dhënat e marra tregojnë se njerëzit janë të ekspozuar gjerësisht ndaj HBCD-ve. Ndotja më e madhe vjen nga tekstilet e përdorura në mobiliet shtëpiake. Madje duhet theksuar fakti se sasia e HBCD-ve që vjen nga tekstilet e mobilieve është më e lartë sesa sasia e përgjithshme e HBCD-ve që vjen nga sektori i ndërtimit përkatësisht **11990 kg** dhe **76940 kg** nga tekstilet e mobilieve të shtëpive

Përfundime dhe rekomandime

- Ndotja më e madhe me HBCD-në vjen nga tekstilet e përdorura në mobiliet dhe mjediset shtëpiake dhe më pas nga sektori i ndërtimit.

- Përdorimi i materialeve izoluese në sektorin e ndërtimit duhet të jetë i kontrolluar për cilësinë e mallrave që përdoren sidomos në raport me përmbajtjen e HBCD.

- Forcimi i kontrollit dhe vlerësimi i cilësisë së tekstileve dhe materialeve izoluese që mund të përmbajnë HBCD është i rëndësishëm për të reduktuar/eliminuar emetimin në mjedis të NOQ-HBCD-së, për të minimizuar efektet e HBCD-së në shëndetin e fëmijëve dhe mbrojtjen e punëtorëve nga ekspozimi në punë i këtyre komponimeve në sektorin e ndërtimit.

- Kontrolli dhe monitorimi i vazhdueshëm i burimeve të emetimit në mjedis të NOQ-ve është i domosdoshëm për të ruajtur dhe vlerësuar ndikimin e HBCD-së në mjedisi dhe shëndetin e njeriut në përgjithësi, fëmijëve dhe punëtorëve në veçanti, pasi këto komponime janë të dëmshme për mjedisin dhe rrezikojnë shëndetin e njeriut.

Hekzabromobifenili (HBB)

Hekzabromobifenili (HBB) për shkak të prodhimit të tij në sasi shumë të vogla dhe përdorimit të kufizuar, si dhe ku shumica e materialeve që përmbanin HBB janë shkatërruar dekada më parë, sipas të dhënave të UNEP-it (2012), ky komponim nuk është subjekt i inventarit dhe planit të veprimit për vendin tonë.

NOQs e tjerë të rinj (hekszlorobutadieni, pentaklorofenoli me kripërat dhe esteret e tij, naftalenet e poliklorinuar)

Në vendin tonë këto komponime kimike nuk janë prodhuar për shkak të mungesës së industrisë kimike, por ato janë ose mund të jenë importuar si produkte më vete ose si pjesë përbërëse e produkteve të tjera. Meqë edhe prodhimi i tyre ka ndaluar edhe në botë vite më parë, grupi i punës nuk mundi të gjente të dhëna rreth importit dhe përdorimit të tyre si komponime kimike.

Megjithatë, një inventar dhe plan veprimi për këto si papastërti në formulimet kimike ose në përbërje të artikujve të tjerë, duhet të planifikohet, veçanërisht për pentaklorofenolin me kripërat dhe esteret e tij (PCP), i cili është përdorur në të kaluarën në vendin tonë.

Mbetjet dhe vendet e ndotura me NOQs

Në këtë kuadër mund të citojmë dy pikat kryesore të listuar në planin e parë të veprimit për NOQs:

- Studimi i terrenit dhe zhvillimi i planeve rehabilituese për zonat potencialisht të ndotura me NOQ;

- Studime në terren, marrje kampionësh dhe analizimi i tyre, përcaktimi i përparësive, përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i kostos për projektet e rehabilitimit të zonave të ndotura.

Të dyja këto detyra nuk janë realizuar plotësisht dhe kërkojnë vëmendjen e Ministrisë së Mjedisit dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për t'u realizuar.

Strategjia dhe elementet për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit

Nga analiza e gjendjes së NOQ-ve në Shqipëri janë identifikuar objektivat dhe planet specifike të menaxhimit dhe/ose asgjësimit të tyre në përmbushje të detyrimeve të Konventës së Stokholmit, si më poshtë:

- Përcaktimi i përgjegjësive institucionale në nivel kombëtar dhe rajonal për asgjësimin dhe menaxhimin e komponimeve të NOQ-ve dhe rritjen e kapaciteteve institucionale dhe sektoriale për zbatimin e detyrimeve të Konventës dhe mënyrën e raportimit;

- Krijimi i sistemeve menaxhuese dhe forcimi i kapaciteteve teknike për eliminimin/ reduktimin e mbeturinave që gjenerojnë substanca të NOQ-ve me qëllim shmangien e emetimit të paqëllimshëm të tyre në mjedis;

- Hartimi në përputhje me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, të akteve nën ligjore (bazuar në ligjin për kimikatet, 2015) për administrimin mjedisor të NOQ-ve, duke përfshirë normat e përcaktuara për NOQ-të në komponentët e mjedisit, shkarkimet nga aktivitetet ekonomike, monitorimin dhe limitet në produktet ushqimore;

- Caktimi i institucioneve për monitorimin e NOQ-ve në mjedis (ajër, ujë tokës dhe biota) dhe

përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për kryerjen e monitorimit (mostrimi dhe analizat përkatëse);

- Informimi nëpërmjet formave dhe mjeteve të ndryshme të komunikimit të gjendjes në mjedis dhe efekteve në shëndet të prezencës së NOQ-ve nga institucionet përgjegjëse qendrore dhe lokale, aktorët industrialë, dhe qendrat respektive të kërkimit veçanërisht të efekteve të dioksinave dhe furaneve;

- Sigurimi i financimeve të nevojshme për rritjen e kapaciteteve institucionale, asistencë teknike, përcaktimin e mekanizmave më të sigurta për zbatimin e Konventës së Stokholmit dhe monitorimin e tyre në mjedis kryesisht nëpërmjet fondeve të buxhetit të qeverisë;

- Zgjerimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit, shkëmbimi i informacionit shkencor për të administruar NOQ-të dhe përdorimin e teknologjive më të mira të mundshme (BAT) dhe praktikat më të mira të mundshme mjedisore (BEP).

- Eliminimi i pajisjeve që përmbajnë PCB nga përdorimi.

Objektivat dhe prioritetet për zbatimin e Konventës së Stokholmit janë të përcaktuara në planet e mëposhtme të veprimit në përputhje me rekomandimet e Konventës së Stokholmit:

1. Plani i Veprimit për masat institucionale dhe rregullatore për zbatimin e Konventës së Stokholmit dhe raportimi;

2. Plani i Veprimit për PBDEs, PFOS, PFOSF dhe HBCD;

3. Plani i Veprimit për NOQ-të e tjerë të rinj;

4. Plani i Veprimit për PCB-të dhe pajisje që përmbajnë PCB;

5. Plani i Veprimit për Komponente/procese prodhojnë substanca NOQ në mënyrë të paqëllimtë;

6. Plani i Veprimit për të zonave të ndotura;

7. Plani i Veprimit për monitorimin e përgjithshëm të kimikateve NOQ;

8. Plan i Veprimit për arsim, ngritjen e vetëdijes dhe informimit publik.

Plani i veprimit për forcimin e masave institucionale dhe rregullatore

Bazuar në legjislacionin mjedisor në tërësi dhe të NOQ-ve në veçanti, duke konsideruar dispozitat e Konventës së Stokholmit, si dhe traktate të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, politikat kombëtare dhe prioritetet për forcimin institucional dhe rregullator sugjerohet:

- NOQ-të të përfshihen si pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit;

- Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit mjedisor me atë të BE-së;

- Ngritja dhe vënia në eficiencë e “Zyrës së Kimikateve”, “Regjistrit Kombëtar të kimikateve të importuara”, “Komisionit ndërministror të kimikateve” dhe akteve të tjera nën ligjore për menaxhimin e kimikateve dhe NOQ-ve.

Plani i Veprimit për PBDE-të, PFOS, PFOSF HBCD dhe NOQ-të e tjerë të rinj

Në Planin Kombëtar të Veprimit për këto substanca kërkohet të përfshihen këto masa kryesore:

- Inventarizim të të gjitha pajisjeve /makinerive të cilat përmbajnë PBDEs, PFOS, PFOSF dhe HBCD;

- Identifikimi pajisjeve dhe mallrave të importuara që përmbajnë këto komponime;

- Krijimin e bazës së të dhënave sipas specifikave të produkteve/pajisjeve dhe mallrave që përmbajnë këta NOQ.

- Krijimin e bazës ligjore për menaxhimin e tyre;

- Eliminimi i mbetjeve industriale dhe tregtare që përmbajnë këto komponime NOQ.

Plani i Veprimit për PCBs dhe Pajisjet që Përmbajnë PCBs

Masat e mëposhtme rekomandohen për PCBs dhe pajisjet që përmbajnë PCBs në kuadër të PKV-së:

- Për të përpunuar dhe zbatuar rregullore në lidhje me administrimin, trajtimin, monitorimin, heqjen dhe eliminimin e vajit dhe pajisjeve të ndotura me PCBs;

- Përcaktimi dhe zbatimi i rregullores së brendshme të KESH/OSHE/OST në menaxhimin transformatorëve, trajtimin dhe heqjen nga puna të tyre;

- Trajnimi i punonjësve përgjegjës për trajtimin dhe mirëmbajtjen e transformatorëve;

- Krijimi i kapaciteteve për analizën gjysmësasiore (me test-kite) për të vlerësuar përmbajtjen e PCB-ve në vajin e transformatorëve;

- Krijimi i kapaciteteve laboratorike në nivel kombëtar për analizën sasiore dhe cilësore të PCB-ve në vajin e transformatorëve;

- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për rrezikun e substancave PCBs;

- Identifikimi i vendeve të ndotura me PCBs dhe rehabilitimi i tyre;

- Eliminimi i vajit mineral të ndotur me PCBs;

- Projektimi dhe vënia në vend e një program monitorimi të PCB-ve në nivel kombëtar.

Plani i Veprimit për NOQ-të e Prodhuar Joqëllimisht

Për administrimin e këtyre NOQ-ve, më poshtë janë identifikuar masat specifike për mirë menaxhimin e

tyre:

- Plotësimi i legjislacionit dhe rregulloreve në lidhje me parandalimin e ndotjes industriale, kontrollit, si dhe administrimin e mbetjeve;
- Forcimi i kapaciteteve (humane dhe teknike) për institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve (sidomos në menaxhimin e landfilleve dhe parandalimi e djegies së hapur);
- Masa për reduktimin e emetimeve të dioksinave dhe furaneve nga venddepozitimet dhe djegia e mbetjeve;
- Futja e teknikave dhe praktikave më të mira menaxhimi në sektorin industrial dhe të ndërtimit;
- Zhvillimi dhe zbatimi i praktikave bashkëkohore të trajtimit të mbetjeve spitalore në mbarë vendin, për të minimizuar emetimet e NOQ-ve jo të qëllimshme.
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë për menaxhimin mjedisor të mbetjeve;
- Përditësimi i rregullt i inventarit të emetimeve të NOQ-ve jo të qëllimshme.

Plani i Veprimit për Mbetjet e NOQ-ve dhe Vendet e Ndotura

Bazuar në analizën dhe gjendjen aktuale në menaxhimin e mbetjeve dhe vendet e ndotura, masat e propozuara për menaxhimin më të mirë të mbetjeve dhe rehabilitimin e vendeve ose zonave të ndotura janë si vijon:

- Forcimi i kapaciteteve ligjore dhe institucionale për menaxhimin e mbetjeve me NOQ, në nivel lokal dhe qendror;
- Rehabilitimi përfundimtar i vendeve të ndotura me NOQ nëpërmjet hartimit të planeve të rehabilitimit, specifik për çdo vend sipas nivelit të kontaminimit të tyre.

Plani i Veprimit për Monitorimin e Përgjithshëm të Kimikateve NOQ

Zbatimi i monitorimit të NOQ-ve do të bëjë të mundur një njohje të saktë të situatës për përmbajtjen e NOQ-ve në komponentët e rëndësishëm të mjedisit, kontributin e aktiviteteve të ndryshme sociale dhe ekonomike në ndotjen e mjedisit e shkaktuar nga kjo kategori e kimikateve të rrezikshme, analizën e rrezikut, dhe mbi këtë bazë, përcaktimi i masave përkatëse të cilat duhet të kontribuojnë për përmirësimin e mjedisit dhe arritjen e standardeve mjedisore.

Në këtë kontekst, këto masa kryesore duhet të ndërmerren:

- Monitorimi i NOQ-ve në zona dhe mjedise të ndryshme, si pjesë e programit kombëtar të monitorimit;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale për studimin dhe kërkimin në lidhje me çështjet e NOQ-ve.

Plani i Veprimit për Arsimin, Ndërgjegjësim dhe Informim Publik

Masat e mëposhtme duhet të ndërmerren me qëllim për të rritur qasjen e publikut në informacionet lidhur me komponimet NOQ dhe rritjen e ndërgjegjësimit së tyre:

- Rritja e ndërgjegjësimit në komunitetet, informimi publik, angazhimi dhe aksesimi i rrjetit të Organizatave Jofitimprurëse (OJF) në dokumente dhe të dhëna analitike mbi rrezikshmërinë e NOQ-ve dhe efektet e tyre në shëndetin e njeriut dhe mjedisit;
- Trajnimi i personelit që merret direkt me përdorimin e komponimeve të NOQ-ve;
- Angazhimi i medias në problemet mjedisore që lidhen me komponimet e NOQ-ve;
- Futja e njohurive mbi NOQ-të në programet shkollore.

Propozimet dhe prioritetet për ndërtimin e kapaciteteve

Nevojat prioritare për ngritjen e kapaciteteve për të realizuar përputhshmërinë me kërkesat e Konventës dhe arritjen e objektivave të PKV-së, citohen më poshtë për fushat e veçanta prioritare:

1. Ngritja dhe funksionimi i njësisë së NOQ-ve në Ministrinë përgjegjëse për Turizmin dhe Mjedisin:

- Monitorimi i përmbushjes së detyrimeve që vijnë nga Konventa e Stokholmit dhe politikat e lidhura me NOQ-të.
- Koordinimi i aktiviteteve të ministrive që adresojnë NOQ-të, dhe sigurojnë shkëmbimin e informacionit.
- Monitorimi i përmbushjes së legjislacionit mjedisor në të njëjtën linjë me direktivat e BE-së mbi NOQ-të.
- Monitorimi i zbatimit të këshillimeve me institucionet dhe ekspertët në lidhje me ato aktivitete që implementohen me qëllim largimin dhe eliminimin e NOQ-ve dhe rehabilitimin e zonave të ndotura.
- Vlerësimi i projekteve të lidhura me NOQ-të.

2. Ministria përgjegjëse për fushën e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria përgjegjëse për Ekonominë duhet të sigurojnë kapacitetet teknike për menaxhimin e PCB-ve, zëvendësimin e vajrave me PCBs dhe pajisjeve që përdorin këto vajra, si dhe eliminimi i tyre në mënyrë të sigurt mjedisore.

3. Ministrinë përkatëse dhe ministria përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin duhet të hartojë

procedurat për ruajtjen e sigurt të NOQ-ve (kryesisht ato që përmbajnë vajra), dhe pajisje që përmbajnë NOQ deri në eliminimin përfundimtar.

4. Përgatitjen e studimeve dhe projekteve për eliminimin e NOQ-ve ose materialeve/pajisjeve të ndotura me NOQ.

5. Organizimin e trajnimeve dhe seminareve me aktorë të ndryshëm për çështjet që lidhen me monitorimin, kontrollin, ruajtjen e sigurt dhe eliminimin e NOQ-ve.

6. Rritja e ndërgjegjësimit publik për impaktin e NOQ-ve mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Përmbledhja e aktiviteteve dhe mjetet financiare të nevojshme për zbatimin e PKV-së

Mjetet financiare të nevojshme për implementimin e PKV-së për periudhën 2019–2024 janë parashikuar të jenë afro **618,500.00 EURO**, ashtu siç paraqiten në tabelën më poshtë. Fondet e nevojshme për zbatimin e PKV-së mund të sigurohen nga burime të ndryshme financiare, si: buxheti i shtetit, Bashkimi Evropian, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare për mjedisin, donacionet private etj.

1. HYRJE

Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (NOQ) janë kimikate të qëndrueshme në mjedis dhe që paraqesin rrezik të lartë për shkak të efekteve negative për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Komponentet NOQ janë përdorur në mbarë botën në industri, bujqësi, komunikim etj.

Duke njohur rolin e madh të kimikateve në përmirësimin e cilësisë së jetës, është gjithashtu e njohur mirë se çdo kimikat mund të ketë efekte negative në varësi të vetive dhe të ekspozimit ndaj tyre. Kjo është arsyeja pse përpjekjet ndërkombëtare dhe kombëtare janë të drejtuara për të kontrolluar kimikatet, riskun që lidhet me to, nëpërmjet menaxhimit të mirë të tyre gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre, duke përfshirë: i) gjetjen e alternativave më pak të rrezikshme; ii) reduktimin e ekspozimit; iii) menaxhimin e tregtisë së tyre; dhe iv) rritjen e ndërgjegjësimit për rrezikun e tyre mjedisor.

Meqenëse NOQ-të nuk shpërbëhen mund të gjenden lehtë në tokë, në liqene, në ujë, te peshqit, te kafshët, te bimët, në ushqim dhe te njerëzit edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë nga përdorimi apo shkarkimi i tyre në mjedis. NOQ-të mund të lëvizin lehtë nëpërmjet zinxhirit ushqimor nga një nivel trofik në tjetrin, si dhe nga pjesa abiotike e mjedisit te pjesa biotike e tij.

Studime të shumta vërtetojnë toksicitetin e NOQ-ve të ndryshme për njerëzit. Përveç kësaj, shkencëtarët pranojnë se NOQ-të mund të shkaktojnë këto probleme shëndetësore te kafshët, të cilat përdoren si kavie për të parashikuar rrezikun për njerëzit. Dioksina si një komponim NOQ është e njohur ndërkombëtarisht si një substancë kancerogjene për njeriun.

Ndotja e trupit të njeriut nga NOQ-të ka ndodhur, duke përbërë një shqetësim real për shëndetin e njeriut gjatë disa dekadave të fundit. Për pasojë, vitet e fundit ka pasur rritje të frekuencës së kancerit të gjirit, shumë studime kanë treguar gjithashtu rritje dramatike të çrregullimeve të organeve riprodhuese etj.

Konventa mbi NOQ-të është përgatitur në vitin 2001, në kuadër të përpjekjeve për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin dhe qëllimin për të kufizuar dhe eliminuar rrezikun nga NOQ-të. Deri më sot, 152 vende e kanë nënshkruar Konventën e Stokholmit, ndërsa 179 vende e kanë ratifikuar atë.

Shqipëria ka nënshkruar Konventën më 5 dhjetor 2001 dhe e ka ratifikuar atë më 4 tetor 2004. Konventa e NOQ-ve përcakton një varg detyrimesh që palët duhet ose të inkurajohen të ndër marrin në lidhje me menaxhimin e NOQ-ve, si përcaktimin e pikave fokale kombëtare, nxitjen e shkëmbimit të informacionit, sigurimin e asistencës teknike, nxitjen dhe lehtësimin e ndërgjegjësimit të publikut me anë të pjesëmarrjes, konsultimit dhe edukimit, nxitjen e kërkimit, monitorimit dhe raportimin “në intervale periodike” mbi gjendjen dhe masat për eliminimin ose reduktimin e NOQ-ve.

Masat më të rëndësishme që vendet nënshkruese të Konventës duhet të aplikojnë për reduktimin e emetimeve të ndotësve të mësipërm, në bazë të dispozitave të Konventës, janë:

- a) Aplikimi i teknikave më të mira (TMM) në instalimet industriale (neni 5).
- b) Nxitja e zhvillimit dhe kur është e nevojshme, kërkesa për përdorimin e zëvendësimit të materialeve të modifikuara, prodhimeve dhe proceseve për parandalimin e formimit dhe emetimin e kimikateve të aneksit C në mjedis (neni 5).
- c) Reduktimi i emetimeve NOQ nga stoqet e pesticideve, si dhe nga mbetjet (neni 6).
- d) Përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit (PKV) në bazë të dispozitave të Konventës nga vendet anëtare (neni 7).
- e) Zbatimi i masave për promovimin e informimit publik në lidhje me dispozitat e Konventës (neni 10).
- f) Kryerja e një studimi për kontrollin e burimeve, emetimeve dhe nivelet e NOQ-ve në mjedis dhe shëndetin e njeriut (neni 11).
- g) Paraqitja e raporteve të shteteve anëtare përmes Sekretariatit në lidhje me zbatimin e Konventës (neni 15).
- h) Vlerësimi i efektivitetit të Konventës (neni 16).

Konventa parashikon edhe procedurën që duhet ndjekur për klasifikimin e kimikateve të tjera në katalogun e NOQ-vë në të ardhmen.

Në këtë kuadër, objektivi kryesor i këtij Planit Kombëtar Veprimi (PKV) konsiston në evidentimin e gjendjes së NOQ-ve në vendin tonë dhe përditësimin e Planit Kombëtar të Veprimit të parë (2006), për të mundësuar hartimin e masave dhe strategjisë për reduktimin, ndalimin dhe eliminimin e NOQ-ve.

Objektivat specifike të PKV-së janë si vijon:

- Të identifikojë dhe të mbledhë informacion mbi opsionet e mundshme për menaxhimin e NOQ-ve me qëllim për të përmbushur detyrimet sipas Konventës së Stokholmit (dhe detyrimet përkatëse sipas Konventës së Roterdamit dhe të Bazelit), duke vlerësuar kufizimet, kostot dhe përfitimet e secilit opsion.

- Të analizojë të dhënat e inventarit duke identifikuar burimet kryesore, fushat dhe sektorët ekonomikë që lidhen me përdorimin dhe emetimin e NOQ-ve, si nga industria, bujqësia dhe sektorët e tjerë të ekonomisë, si dhe prodhimet e tyre jo të qëllimshme.

- Të vendosë prioritetet mbi veprimet e nevojshme për të përmbushur kërkesat e Konventës së Stokholmit dhe objektivat e vendit.

- Të hartohet një draft i përditësuar i PKV-së me qëllim për të përmbushur nevojat e Konventës së Stokholmit dhe objektivat e saj, si dhe kërkesat specifike të vendit sipas prioriteteve, duke i koordinuar me aktivitetet e tjera kombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm.

- Të identifikojë kërkesat për ndihmë për të realizuar vlerësimin dhe mbledhjen e informacionit të nevojshëm, si dhe për të zbatuar PKV-në.

2. PROFILI I VENDIT

2.1 Profili i vendit

2.1.1 Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore

Shqipëria është një vend i vogël, i pozicionuar në pjesën perëndimore të gadishullit të Ballkanit, në brigjet lindore të deteve Adriatik dhe Jon. Territori i saj ndodhet në koordinatat gjeografike 42°39' dhe 39°38' gjatësi gjeografike veriore dhe 21°4' dhe 19°16' gjatësi gjeografike lindore.

Sipërfaqja e Shqipërisë është 28'748 km², nga të cilat rreth 27'398 km² janë tokë dhe 1'350 km² ujë (figura 1). Gjatësia e kufirit shtetëror është 1'094 km, nga të cilat 657 km janë kufij tokësorë, 316 km kufij detarë, dhe 72 km janë kufij liqenesh. Shqipëria e ndan kufirin e saj verior me Malin e Zi dhe Kosovën, kufirin lindor me Republikën e Maqedonisë dhe atë juglindor me Greqinë. Rreth 75% e territorit të Shqipërisë është e përbërë nga kodrat dhe malet, me një gjatësi mbi 300m mbi nivelin e detit. Maja më e lartë është mali i Korabit (2'751m). Pjesa tjetër përbëhet nga fusha (rrafshina) bregdetare dhe kodra të ulëta.



Figura 1. Harta e Shqipërisë

Pozicioni gjeografik i Shqipërisë përcakton përfshirjen e territorit në zonën klimaterike nëntropikale mesdhetare, me dimër të butë dhe të lagësht, verë të nxehtë dhe të thatë me reshje të përqendruara kryesisht gjatë gjysmës së ftohtë të vitit. Ndikimi i detit ndjehet përgjatë bregut perëndimor dhe duke u zhvendosur në lindje zbutet, me temperatura më të ulëta dhe reshje më të pakta. Përgjithësisht elementet klimaterike dallojnë shumë në zona të ndryshme të vendit, veçanërisht temperaturat dhe reshjet.

Shqipëria ka një mbulim bimor të llojeve me diversitet të lartë, të cilat, të grupuara sipas vlerave të tyre mund të ndahen në: bimësi për lëndë drusore, për dru zjarri, për kullota, për industri, për mjekësi, për zbukurim etj. Shkurret mesdhetare mbulojnë 42% të sipërfaqes së vendit (veçanërisht në pjesët perëndimore dhe juglindore). Fauna është po ashtu e diversifikuar. Të pranishme janë dhe disa specie endemike. Te mishngrënësit përmendim ujkun, dhelprën, çakallin, ariun e murrmë, macen e egër etj. Barngrënësit, si: dreri, dhia e egër, derri i egër, lepuri i egër etj., kanë një rëndësi të veçantë. Rreth 350 tipa zogjsh ekzistojnë në Shqipëri. Fauna është dëmtuar nga gjuetia e pakontrolluar, shpyllëzimi, rikuperimi i ligatinave dhe kënetave, përdorimi i kimikateve në bujqësi, ndotja e tokës, ujit dhe ajrit.

2.1.2 Karakteristikat e përgjithshme të popullsisë

Deri në vitin 1990 Shqipëria kishte rreth 3'182'417 banorë dhe rritja e popullsisë ka ardhur si rezultat i rritjes natyrore. Pas kësaj kohe, numri i popullsisë dhe proceset e tjera demografike janë ndikuar nga proceset e emigrimit dhe kushtet social-ekonomike. Popullsia e Shqipërisë është homogjene. Përgjatë periudhës 1960–1990, shqiptarët përbënin 97% të popullsisë. Pjesa tjetër ishin grekë (1.85%), maqedonas (0.15%) etj. Pas vitit 1990, situata ndryshoi për shkak të kthimit të minoritetit grek në Greqi.

Tabela 1. Të dhëna për demografinë

Gjuha zyrtare	Shqip
Popullsia (2011)	2 800 138
Popullsia urbane	1 498508
Popullsia rurale	1 301 630

Burimi: INSTAT

Norma e alfabetizimit ka qëndruar konstante në rreth 99% dhe për ta ruajtur atë po bëhen përpjekje të vazhdueshme. Pavarësisht se shkollimi është i detyrueshëm vetëm për 9 klasat e para, pjesa më e madhe e të rinjve vazhdojnë deri në të 12-n. Viti akademik, i ndarë në dy semestra, fillon në shtator/tetor dhe përfundon në qershor/korrik. Arsimi bazë zgjat 9 vjet, i shoqëruar nga një periudhë jo e detyrueshme që kalohet në parashkollë. Arsimi dytësor, i njohur si arsimi i rregullt, kërkon dhe ndjekjen e 3 viteve deri në përfundim. Fokusi është vendosur në të mësuarit akademik dhe përgatitjen për në universitet.

2.1.3 Organizimi politik dhe administrativ

Shqipëria njihet zyrtarisht si Republika e Shqipërisë. qeverisja e Shqipërisë është Demokraci Parlamentare me 140 anëtarë në legjislacionin e saj. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës është kreu i shtetit. Presidenti zgjidhet nga Parlamenti për një mandat pesëvjeçar dhe ka mundësinë e zgjedhjes për një mandat të dytë. Kandidatit, për t'u bërë president, i duhen tri të pestat e mazhorancës së Parlamentit prej 140 votash (84 vota), në një prej tri raundeve të votimit, ose një shumicë e thjeshtë në raundin e katërt ose të pestë.

Pushteti legjislativ ushtrohet nga Parlamenti dhe qeveria. Kryeministri është kreu i qeverisë dhe caktohet nga presidenti me propozimin e partisë ose koalicionit të partive që kanë shumicën në Parlament.

Pushteti juridik ushtrohet nga gjykatat dhe prokuroria, në përputhje me Kushtetutën dhe fuqinë e dhënë nga ligji. Gjykatësit kanë pushtetin për të shqyrtuar të gjitha çështjet penale, penale ushtarake, administrative, si dhe çështjet e tjera të përcaktuara me ligj, ndërkohë që prokuroria ka detyrimin për të marrë pjesë në gjyqet penale, por jo ato civile. Sistemi shqiptar i drejtësisë përfshin gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë.

Shqipëria është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, NATO-s, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), e Këshillit të Evropës dhe Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT).

Shqipëria ndahet në 12 qarqe administrative (qarqe ose prefektura). Që prej qershorit të vitit 2015, këto qarqe janë ndarë në 61 bashki. Këto qarqe janë ndarë më tej në 36 rrethe të cilat u bënë jofunksionale në vitin 2000. Në total janë rreth 2980 fshatra/komunitete në Shqipëri, të njohura më parë si vendbanime.

Çështjet e mbrojtjes mjedisore, shëndetit dhe përdorimit të tokës mbulohen nga qeverisja qendrore dhe ajo vendore.

Përgjegjësitë kryesore të qeverisjes vendore mbi mbrojtjen e mjedisit janë: zhvillimi i planeve vendore për mbrojtjen e mjedisit, duke e integruar atë në planet e rregullimit territorial, duke përcaktuar vendet për mbledhjen dhe përpunimin e mbetjeve industriale dhe urbane sipas kriterëve mjedisore dhe planeve të zhvillimit, duke organizuar depozitimet e mbetjeve dhe materialeve të dëmshme dhe ruajtjen e bimësisë në zonat urbane dhe mjediset e tyre, duke menaxhuar mbetjet urbane, impiantet për trajtimin e ujërave të zeza dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta, mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve, kullotave dhe burimeve natyrore me karakter vendor.

Ekspertët e qeverisjes vendore e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me parimin e autonomisë, ndërkohë që ruajnë një marrëdhënie të ngushtë me qeverisjen qendrore. Autonomia e qeverisjes vendore qëndron në nivel politik, legjislativ, administrativ e financiar.



Figura 2. Harta administrative me 61 bashki

2.1.4 Gjendja e sektorëve të ekonomisë

Shqipëria është një vend me të ardhura mesatare që ka bërë hapa të mëdhenj në vendosjen e një demokracie të besueshme shumëpartiake dhe një ekonomie tregu në dy dekada e gjysmë. Përpara krizës globale financiare, Shqipëria kishte një normë rritje vjetore prej 6%, e shoqëruar nga një rënie e shpejtë e varfërisë. Megjithatë, pas vitit 2008, rritja mesatare u përgjysmua dhe u shfaqën çekuilibrat makroekonomikë në sektorët publikë dhe të jashtëm. Ritmi i rritjes u reflektua gjithashtu në varfëri dhe papunësi: nga viti 2002 deri në vitin 2008, varfëria në vend u përgjysmua (deri në 12.4%), por në vitin 2012 u rrit përsëri në 14.3%.

Produkti i brendshëm bruto (PBB) për frymë në Shqipëri është regjistruar së fundmi në vitin 2015 në 4541.39 dollarë amerikanë. Ekonomia e Shqipërisë ka përparuar me 3% vit pas viti në tre muajt e parë të vitit 2016, e ndjekur nga një rritje prej 2.15% në periudhën paraardhëse. Kontribuesit kryesorë në këtë rritje kanë qenë tregtia, akomodimi dhe transporti (+5.75%), ndërtimi (+7.58%), informacioni dhe komunikimi (+14.6%), pasuritë e paluajtshme (+3.7%) dhe administrimi publik, arsimi dhe shëndeti (+0.9%).




Figura 3. Ndryshimi i PBB-së pas vitit 1990¹

Papunësia u rrit nga 12.5% në vitin 2008 në 17.6% në vitin 2014, me një përmirësim të lehtë prej 17.3% në vitin 2015, ndërkohë që papunësia e të rinjve arriti në 32.1% në të njëjtën periudhë.

Tabela 2. Të dhëna të indikatorëve makroekonomikë të Shqipërisë

	2011	2012	2013	2014	2015
Popullsia (në milion)	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8
GDP për banorë (në USD)	4,691	4,359	4,512	4,782	4,151
Rritja ekonomike (PBB, variacioni vjetor në %)	2.5	1.4	1.1	2.0	2.6
Norma e papunësisë	13.4	14.1	17.1	18.0	17.7
Norma e inflacionit (CPI, variacioni vjetor në %)	3.4	2.0	1.9	1.6	1.9
Eksportet (në miliard euro)	1.4	1.5	1.7	1.8	1.7
Importet (në miliard euro)	3.8	3.8	3.7	3.9	3.9

Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas sektorëve ekonomikë është: tregti 47.1%, industri 9.3%, hotele, bare dhe restorante 14.8%, transport dhe komunikim 9.6%, shërbime të tjera 13.3%, ndërtim 4.6%, bujqësia dhe peshkimi 1.2%.

Bujqësia mbetet një prej sektorëve më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm në Shqipëri. Bujqësia është burimi kryesor i punësimit dhe të ardhurave, veçanërisht në zonat rurale të vendit. Bujqësia kontribuon në 18.9% të PBB-së së vendit. Të mbjellat ndikohen kryesisht nga kulturat që janë më përfaqësuese në këtë sektor, të tilla si perimet, drithërat dhe patatet. Prodhimi i perimeve në vitin 2015 ishte 1'030'000 tonë, duke pësuar rritje prej 8.4% në krahasim me një vit më parë, dhe rritje prej 11.5% në krahasim me dy vite më parë. Prodhimi i patateve në vitin 2015 ishte 245'000 tonë, duke pësuar rritje me 2.1% në krahasim me vitin paraardhës. Niveli më i lartë i prodhimit të patateve u arrit në prefekturën e Korçës me 65'436 tonë, e ndjekur nga Fieri me 33'273 tonë dhe Elbasani me 32'457 tonë.

Sektori i peshkimit është i pazhvilluar në Shqipëri. Në krahasim me një mesatare prej 15.1 kg për banorë në vit të konsumit të prodhimeve të peshkut për vendet e Mesdheut, ky konsum në Shqipëri është relativisht i ulët, me rreth 3.3 kg për banor në vit. Peshkimi në ligatinat detare, që mbulon rreth 10'000 ha, është i shpeshtë, dhe aty merren rreth 42–97 kg produkte për hektar. Industria e përpunimit të peshkut po zgjerohet. Megjithatë, sektori bujqësor në Shqipëri vazhdon të hasë disa sfida, që përfshijnë madhësitë e vogla të fermave dhe fragmentarizimin e tokës, infrastrukturën e dobët, kufizimet e tregut, aksesin e kufizuar në kredi dhe grante dhe institucionet e papërshtatshme rurale.

Aktivitetet kryesore industriale janë industria e nxjerrjes së naftës dhe gazit, industria e përpunimit, industria e lehtë, industria e ushqimit dhe pijeve, prodhimi i çimentos, metalurgjia dhe minierat. Zhvillimi i industrisë dhe sektorit mineral në disa rajone të vendit ka shkaktuar gjenerimin e mbetjeve, sterile dhe kimikate, të cilat depozitohen në vende që nuk përmbushin kriteret mjedisore.

Sektori i industrisë ka kontribuar qëndrueshëm me rreth 11% të PBB-së. Varësia e vazhdueshme e Shqipërisë në nxjerrjen e mineraleve ndodh për shkak të ekzistencës së shumë depozitave që mund të përdoren për qëllime tregtare. Depozitat e kromit, bakrit dhe nikelit janë hapur shumë kohë më parë, por pajisjet për minierat dhe metodat janë të vjetruara dhe shumë punime janë ndërprerë. Pavarësisht kësaj,

¹ <https://www.quandl.com/collections/albania>

Shqipëria ka një pozicion të rëndësishëm në Evropë për nxjerrjen e kromit.

Aktivitete të tjera industriale që veprojnë në Shqipëri janë industria e nxjerrjes së naftës dhe gazit, industria e përpunimit, industria e lehtë, industria e ushqimit dhe pijeve, prodhimi i çimentos dhe metalurgjia.

Shqipëria është e pasur me shumë burime energjie, naftë dhe gaz, qymyr dhe lëndë djegëse fosile, si dhe hidrocentrale dhe burime të tjera të rinovueshme energjie. Hidrocentralet zënë rreth 97% të energjisë elektrike të prodhuar. Aktualisht përdoret vetëm 30% e burimeve ujore. Sektori i energjisë kontribuon me rreth 10% të PBB-së. Burimet e energjisë elektrike janë shtuar në 2–3 vitet e fundit me ndërtimin e stacioneve hidroelektrike të koncensionuara (HEC). Pavarësisht numrit të lartë të kontratave me koncesion të realizuara dhe fillimit të prodhimit të stacioneve hidroelektrike nga sektori privat, ende prodhimi nga sektori privat në prodhimin e energjisë elektrike kombëtare është rreth 20%.

Transporti ka një impakt të menjëhershëm në cilësinë e mjedisit në përgjithësi dhe në atë të zonave urbane në veçanti. Sektori i transportit është një prej burimeve kryesore të çlirimit të gazrave dhe kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në ndotjen e ajrit.

2.1.5 Përmbledhje e çështjeve mjedisore

Shqipëria ka trashëguar shumë probleme mjedisore nga e kaluara, të tilla si: erozioni i tokës, shpyllëzimi, humbja e biodiversitetit, mbetjet urbane, ndotja e ajrit në zonat urbane dhe industriale, ndotja e tokës të shkaktuar nga mbetjet e dëmshme të industrive etj.

Raporti i Gjendjes së Mjedisit (RGjM) përgatitet çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM). Informacioni mbi gjendjen e mjedisit është dokumenti bazë që analizon gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Shqipëri, dhe jep rekomandime për politikën e planifikimit mjedisor me bazë njëvjeçare.

Cilësia e ajrit në Shqipëri ndryshon shumë në varësi të vendndodhjes: në zonat rurale dhe malore ajri është i pastër, ndërkohë që në qytete dhe në afërsi të zonave industriale cilësia është shumë më e dobët. Monitorimi i cilësisë së ajrit përqendrohet për indikatorët: PM₁₀, PM_{2.5}, O₃, NO, SO₂, CO dhe Benzeni. Bazuar në vlerësimin e të dhënave të vitit të fundit në Tiranë është vëzhguar një rënie prej 20% në nivelin e përqendrimit të PM₁₀ dhe PM_{2.5}. Kjo ka ndodhur për shkak të përmirësimeve të bëra në infrastrukturë dhe për shkak të disa masave legjislative të ndërmarra në lidhje me standardizimin e makinave dhe automjeteve të përdorura. Në nivel kombëtar, përqendrimi i CO-së dhe Benzenit është në përputhje me standardet e BE-së.

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit Shqiptar paraqet strategjinë për reduktimin e emetimit të ndotësve atmosferikë në disa mënyra, të cilat përfshijnë:

- Monitorimin e cilësisë së ajrit sipas kërkesave të BE-së;
- Kontrollin dhe reduktimin e shkarkimit të gazit në atmosferë nga automjetet;
- Kontrollin dhe reduktimin e shkarkimit të substancave ndotëse nga impiantet industriale;
- Kontrollin dhe reduktimin e pluhurit të shkaktuar nga ndërtimi;
- Planifikimin për menaxhimin e cilësisë së ajrit.

Shqipëria ka shumë liqene natyrore (Shkodra, Ohri, Prespa), të cilat shërbejnë si rezerva ujore të rëndësishme. Shumica e ujërave të vendit, veçanërisht i lumenjve Shkumbin, Fan, Gjanicë, Lanë, është i ndotur nga shkarkimet industriale. Një pjesë e këtij uji përdoret në bujqësi dhe në këtë kuadër impiantet e trajtimit të ujit janë shumë të domosdoshëm.

Monitorimi i ujërave nëntokësore realizohet në basenet kryesore ujëndarëse, ku vlerësohen këta parametra kimikë: NO₃, NH₄, HCO₃, Cl, SO₄, Na, Ca, Mg, K, Fe, oksigjeni i tretur, përqureshmëria dhe përmbajtja e substancave të dëmshme. Niveli i parametrave kimikë të monitoruar është brenda limiteve të lejuara. Ujërat nëntokësore në Shqipëri klasifikohen si ujëra të ëmbla dhe kanë reaksion neutral dhe alkalinitet të dobët, si dhe fortësi të lartë.

Është vërejtur një përmirësim i cilësisë së ujërave bregdetare gjatë viteve të fundit. Kjo ka ndodhur për shkak të investimeve të bëra në infrastrukturën e trajtimit të ujërave. Deri para disa viteve, burimi kryesor i ndotjes për ujërat e brigjeve kanë qenë shkarkimet e ujërave të patrajtuara. Megjithatë, investimet e bëra në disa prej qyteteve kryesore kanë ndryshuar në mënyrë domethënëse cilësinë e ujërave të brigjeve detare. Sipas vlerësimit të bërë, më shumë se 90% të stacioneve të brigjeve detare në vitin 2016 u klasifikua brenda kategorisë A dhe 6% brenda kategorisë B (ku A është kategoria e cilësisë shumë të mirë dhe B e cilësisë së mirë).²

Shqipëria ka një nivel të lartë diversiteti biologjik të peizazheve, ekosistemeve dhe nivelin e specieve. 40 habitate janë identifikuar si të rralla dhe të rrezikuara, duke bërë që numri i specieve të rrezikuara të

² <http://akm.gov.al/>

arrijë në 320. Shqipëria ka një mbulim bimësie me diversitet të lartë specimesh, të cilat, të grupuara sipas vlerave të tyre, ndahen në: bimësi për lëndë drusore, për dru zjarri, për kullota, për industri, për mjekësi, për dekorim etj. Fauna është po ashtu e diversifikuar. Disa specie endemike janë gjithashtu të pranishme. Ndërmjet mishngrënësve përmendim ujkun, dhelprën, çakallin, ariun e murrmë, macen e egër etj. Barngrënësit, si: dreri, dhia e egër, derri i egër, lepuri i egër etj., luajnë një rol të rëndësishëm. Po ashtu, në dete dhe ujëra të brendshme gjenden shumë peshq me vlerë ekonomike. Fauna është dëmtuar nga gjuetia e shfrenuar, shpyllëzimi, përdorimi i kimikateve në bujqësi, ndotja e ujit, tokës dhe ajrit etj.

Gjatë dy dekadave të fundit, sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve ra me 1.4%, kjo për shkak të ndryshimit të kategorive të përdorimit të tokës në zonat pyjore, dhe lidhet drejtpërdrejt me transformimin dhe modifikimin e tokave të pyjeve. Po ashtu ekzistojnë probleme që lidhen me prerjet e paligjshme, lëvizjet demografike, rritjen e kërkesës për dru dhe energji, mbi përdorimi i burimeve të pyjeve etj.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane me fonde publike ka pësuar një trend rritës me kalimin e viteve e shpjeguar midis të tjerave me anë të sjelljes shoqërore të njerëzve si reflektim i ndryshimit të stilit të tyre të jetesës. Në vitin 2015 sasia e mbetjeve të menaxhuara ishte rreth 1.4 milion tonë, në vitin 2014 rreth 1.2 milion tonë dhe në vitin 2013 rreth 950 mijë tonë. Sasia vjetore e mbetjeve të gjeneruara për banor në të gjithë vendin ka pësuar një trend rritës përkatësisht: 396 kg/banor në vitin 2015, 355 kg/banor në vitin 2014 dhe 321 kg/banor në vitin 2013.

Sasia e mbetjeve industriale dhe mbetjeve urbane të menaxhuara ka pasur një rritje nga viti në vit, kështu në vitin 2015 sasia e tyre ishte 94 kg/banorë, më 2014-n ishte 90 kg/banorë dhe më 2013-n ishte 44 kg/banorë.

Mbetjet industriale dhe mbetjet urbane përbëjnë grupin kryesor të mbetjeve në vendin tonë. Në mbetjet e menaxhuara, sasia e mbetjeve organike është rritur në krahasim me sasinë e përgjithshme. Në vitin 2015, mbetjet organike përbënin rreth 51.4% të sasisë së përgjithshme të mbetjes, nga 50.2% që ishte në vitin 2014 dhe 41% në vitin 2013.

Mbetjet e menaxhuara trajtohen kryesisht duke i depozituar ato në landfille dhe vende të tjera ruajtëse të miratuara nga organet përkatëse të qeverisjes vendore. Depozitimi i rregullt i mbetjeve është rritur dhe respektivisht, në vitin 2015 u depozituan 68.8%, në vitin 2014 u depozituan 63.4% dhe në vitin 2013 u depozituan 50.6% të sasisë së përgjithshme të mbetjeve të menaxhuara të vendit. Riciklimi i mbetjeve është pothuajse në të njëjtat nivele me një tendencë të lehtë në rritje. Në vitin 2015 u ricikluan 25.3% të mbetjeve totale dhe në vitin 2014 ky indikator ishte 21.6%, ndërkohë që në vitin 2013 ishte 24%. Në vitin 2015, për prodhimin e energjisë u dogjën rreth 1.5% të mbetjeve, në vitin 2014 rreth 0.5% dhe në vitin 2013 kjo shifër ishte vetëm 0.1%.

Një ligj i ri mbi mbrojtjen mjedisore është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2012. Objektivi i tij është rritja e nivelit të mbrojtjes mjedisore duke vendosur një rrjet të konsoliduar institucionesh mjedisore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, i lidhur me implementimin e politikave mjedisore. Në përgjithësi Shqipëria ka treguar progres mbi çështjet mjedisore, në lidhje me menaxhimin e problemeve mjedisore, por duhen ende shumë përpjekje veçanërisht për implementimin e legjislacionit mjedisor.

Veçanërisht, trajtimi i ujërave dhe menaxhimi i mbetjeve janë në fazat e para të zhvillimit të tyre. Vendi është i prekur nga efektet e ndryshimit të klimës, veçanërisht nga përmbytjet dhe thatësira, si dhe mungesat e energjisë elektrike për shkak të varësisë ndaj hidrocentraleve të cilat kërkojnë importe sezonale energjie.

2.2 Korniza institucionale, politike dhe rregullatore

2.2.1 Politikat mjedisore dhe korniza legjislative

Kushtetuta e Shqipërisë kërkon që institucionet të ruajnë një mjedis të shëndetshëm, ekologjikisht të përshtatshëm për brezat aktualë dhe ata të ardhshëm. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm përfshihet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila ka një nen të veçantë mbi këtë subjekt. Neni deklaron se “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm; dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm (Kushtetuta e Shqipërisë, kapitulli V, neni 59).

Institucioni kryesor përgjegjës për çështjet mjedisore është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) e ngritur për herë të parë në vitin 2001. Ky institucion, synon të zhvillojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen e mjedisit, nga pikëpamja e zhvillimit të qëndrueshëm.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) u themelua në vitin 2014 sipas implementimit të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Mbi mbrojtjen e mjedisit”. AKM-ja është një institucion qendror publik, i pavarur në vendimmarrje dhe që e ushtron juridiksionin e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ajo është e financuar nga buxheti i shtetit dhe burimet e saj, si dhe është e pavarur në vendimmarrje dhe e ushtron funksionin

siç parashikohet në ligj³.

Në tabelën në vijim jepen institucionet që përfshihen në çështje mjedisore dhe përgjegjësitë institucionale.

Tabela 3. Institucionet shqiptare që kanë përgjegjësi ligjore për mjedisin

Ministritë	Agjencitë dhe institucionet
Ministria përgjegjëse për mjedisin Ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural Ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale Ministria përgjegjëse për ekonominë	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Departamentet rajonale mjedisore Departamentet rajonale të shërbimeve pyjore Inspektorati përgjegjës për mjedisin Agjencia kombëtare e Burimeve Natyrore Instituti i Shëndetit Publik Agjencia Kombëtare e Mjedisit Qendra e Trajnimit dhe Grumbullimit të Kimikateve; Inspektorati shtetëror përgjegjës për industrinë Inspektorati përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut

Në dekadën e fundit dhe veçanërisht që nga viti 2001, janë hartuar dhe miratuar disa ligje dhe akte ligjore për mjedisin. Korniza ligjore kombëtare e Shqipërisë është e harmonizuar gjerësisht me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ajo bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përbëhet nga ligje dhe akte rregullatorë, të tilla si vendime të Këshillit të Ministrave (VKM), akte ministrore, rregulla, udhëzime dhe standarde.

Instrumentet kombëtare ligjore të mëposhtme adresojnë (drejtojnë) menaxhimin e NOQ-ve në Shqipëri, si pjesë e menaxhimit të kimikateve:

Legjislacioni mjedisor bazohet në ligjin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, si dhe ligjin në fuqi nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (VNM), i cili është përafshuar me direktivën 2011/92/EU mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin.

Ligji synon të mbrojë mjedisin nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve nga projektet e propozuara, të cilat mund të shkaktojnë impakte të drejtpërdrejta ose të tërthorta mbi mjedisin, për shkak të madhësisë, natyrës ose vendndodhjes të tyre, para se ata të miratohen.

Ligji përcakton parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat që sigurojnë një nivel më të lartë mbrojtjeje në mjedis, duke synuar identifikimin dhe përcaktimin e efekteve të mundshme të drejtpërdrejta ose të tërthorta mbi mjedis, kryesisht për t’i parandaluar ato.

Ligji përcakton politikat kombëtare dhe vendore mbi mbrojtjen e mjedisit, kërkesat për përgatitjen e vlerësimit të impaktit në mjedis dhe vlerësimeve strategjike mjedisore, kërkesat për aktivitetet e lejuara që ndikojnë mjedisin, parandalimin dhe reduktimin e ndotjes mjedisore, normat dhe standardet mjedisore, monitorimi dhe kontrolli mjedisor, detyrat e organeve shtetërore në lidhje me çështjet mjedisore, roli i shtetit dhe sanksionet e vendosura për shkeljet e ligjit.

Ligji ka përcaktuar AKM-në si organin administrativ përgjegjës për ekzekutimin e aktiviteteve profesionale dhe që lidhen me fushën e mbrojtjes mjedisore. Mbrojtja mjedisore siguron mbrojtjen e plotë ligjore të cilësisë së mjedisit, mbrojtjen e biodiversitetit dhe të ambientit, përdorimin racional të burimeve natyrore dhe energjisë në mënyrën më të mirë për mjedisin, si kushti bazë për një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

Neni 5 i këtij ligji, përcakton parimin e zhvillimit të qëndrueshëm: “Autoritetet publike, nëpërmjet zhvillimit, adoptimit dhe implementimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve dhe projekteve brenda kompetencës së tyre, rrisin zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social, duke përdorur burime natyrore në mënyrë që të përmbushin nevojat aktuale dhe të ruajnë mjedisin, pa cenuar mundësinë e gjeneratave të ardhshme për të përmbushur nevojat e tyre”.

Për më tepër, ligji përcakton udhëzimet për vlerësimin e ndikimit në mjedis, palët që duhet të përfshihen dhe detyrimin e autoriteteve mjedisore për të përpunuar informacionin ekzistues për hartimin e raporteve VNM, të vlefshme për zhvilluesit e projekteve. Një dispozitë e veçantë është parashikuar për zonat e veçanta të mbrojtura, në të cilat nuk do të lejohet zhvillimi i projekteve, me përjashtim të disa rasteve. Pjesë e këtij ligji janë dhe dispozitat për vlerësimin e ndikimeve në mjedisin ndërkuftar.

Ligji VNM përcakton tipin dhe shkallën e projekteve që kërkojnë një VNM para implementimit. Ligji përshkruan dy nivele të VNM-së për projektet: i) VNM-ja paraprake (fillestar); dhe ii) VNM-ja e thelluar.

- VNM-ja paraprake. Kjo bëhet për projektet që mund të kenë më pak impakte potenciale. Ato

³ <http://www.akm.gov.al>

përfshijnë projektet e renditura në aneksin 2 të ligjit mbi VNM-në.

- VNM-ja e thelluar. Kjo është për projekte me ndikim e potenciale të rëndësishme, siç listohen në aneksin 1 të ligjit, ato projekte të listuara në aneksin 2 të cilat ministria përgjegjëse e mjedisit i konsideron që kanë një impakt të rëndësishëm mbi mjedisin (duke përfshirë aktivitetet që do të implementohen në zonën e mbrojtur). Procedura e thelluar e VNM-së përfshin gjithashtu: debatin publik dhe këshillimet me autoritetet përkatëse.

Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit” dhe VKM-ja nr. 31, datë 20.1.2016, “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit”, ka vendosur bazat ligjore për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit dhe për arritjen e synimeve, sipas Konventës mbi Diversitetin Biologjik dhe konventave të tjera të lidhura me biodiversitetin në të cilat Shqipëria është pjesë, si dhe bazuar në direktivat e BE-së (p.sh. Direktiva e Habitatit dhe Zogjve të Egër). Ligji identifikon instrumentet për planifikimin e biodiversitetit (Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Biodiversitetit, rrjetin e inventarit dhe monitorimit të biodiversitetit, planet e emergjencës dhe vlerësimet e impaktit ndërkufitar), si dhe tri kategoritë e mbrojtjes: ekosistemet e mbrojtura, të mbrojtura veçanërisht dhe të degraduara, habitatet dhe peizazhet.

Ligji, “Për lejet mjedisore” nr. 10448, u miratua në datën 14.7.2011 dhe është ndryshuar me ligjin nr. 60/2014, datë 19.6.2014. Ky ligj synon “parandalimin dhe kontrollin e ndotjeve që vijnë nga disa kategori aktivitetesh, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë mbrojtjeje për mjedisin si një i tërë dhe për shëndetin e njeriut dhe përmirësimin e cilësisë së jetës”. Ligji përcakton “masat për lejimin e veprimit të një grupi aktivitetesh ndotëse, masat e krijuara për të parandaluar, ose nëse kjo nuk është e praktikueshme, për të reduktuar emetimet në ajër, ujë dhe tokë nga aktivitete të tilla, duke përfshirë masat që lidhen me mbetjet, në Republikën e Shqipërisë.

Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve”, është ndryshuar me ligjin nr. 32/2013 dhe ligjin nr. 156/2013. Ligji implementohet nëpërmjet:

- Vendimit nr. 177, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, të ndryshuar;

- Vendimit nr. 117, datë 13.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje”, të ndryshuar;

- Urdhrit nr. 893, datë 4.10.2013 të ministrit të Mjedisit, “Për miratimin e modelit të regjistrave të subjekteve që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vavra të përdorura”;

- Urdhrit nr. 1957 datë 6.11.2014, të ministrit të Mjedisit, “Për miratimin e modelit të autorizimit për eksportin e mbetjeve dhe modelin e autorizimit për kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme apo inerte”.

Qëllimi i këtij ligji është “të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin duke parandaluar ose reduktuar impaktet negative nga gjenerimi i mbetjeve dhe nga menaxhimi i mbetjeve, si dhe duke reduktuar impaktet e përgjithshme të përdorimit të burimeve dhe duke përmirësuar eficiencën e këtij përdorimi, nëpërmjet sigurimit të një menaxhimi të arsyeshëm mbetjesh”. Ligji përcakton rregullat që lidhen me trajtimin mjedisor të mbetjeve të ngurta në çdo fazë: krijimin, mbledhjen, ndarjen, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe derdhjen. Ligji synon më tej reduktimin e mbetjeve dhe reduktimin e impaktit të dëmshëm dhe të rrezikshëm të tyre. Përgjegjësia për menaxhimin e mbetjeve u takon njësisë të qeverisjes vendore. Trendi i gjenerimit të mbetjeve nga viti 2009 në vitin 2015 tregon një rritje në krahasim më atë të një viti më parë.

Legjislacioni për cilësinë e ajrit (në fuqi deri në dhjetor 2017), ligji nr. 8897, datë 16.5.2002 “Mbi mbrojtjen e ajrit”, i ndryshuar me ligjin nr. 10266, datë 15.4.2010, identifikon burimet e ndotjes së ajrit (instalimet e stacioneve të energjisë, burimet e lëvizshme të ndotjes). Ligji, gjithashtu, vendos disa vlera kufij (vlerat kufij për cilësinë e ajrit dhe pragjet alarmuese, vlerat kufij për emetimet në ajër nga burimet e palëvizshme, vlerat kufij për emetimet nga burimet e lëvizshme dhe përmbajtja e substancave të dëmshme në lëndët e djegshme). Legjislacioni dytësor është zhvilluar tashmë. Pavarësisht kësaj, mungesa pajisjeve dhe stafit të trajnuar për kontrollin e vlerave kufij ka ndikuar në zbatimin e duhur të tij. Ekziston gjithashtu nevoja për trajnimin e subjekteve ndotëse, nëpërmjet projekteve pilot për menaxhimin e regjistrave, për ndërtimin dhe implementimin e programeve monitoruese, planeve të emergjencës etj.

Ligji nr. 8897, datë 16.5.2002 “Mbi mbrojtjen e ajrit”, i ndryshuar, është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, në datën 30.12.2017. Ligji i ri 162/2014, ka për qëllim të përmirësojë shëndetin publik dhe të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet integritetit të çështjes së mbrojtjes së ajrit në politika të tjera, si dhe përcaktimit të kërkesave për pakësimin e shkarkimeve, monitorimin, vlerësimin, planet e cilësisë së ajrit, dhe për bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar

për këtë qëllim.

2.2.2 Rolet dhe përgjegjësitë

Këshilli i Ministrave ka përgjegjësinë e politikës mjedisore në Shqipëri. Koordinimi i kësaj politike arrihet nga ministria përgjegjëse për mjedisin. Për disa çështje mjedisore përgjegjëse janë disa ministri dhe agjenci shtetërore në nivele qendrore dhe lokale.

Ministria përgjegjëse për Mjedisin harton strategjitë dhe politikat kombëtare mjedisore. Monitorimi dhe zbatimi i ligjit është po ashtu përgjegjësi e kësaj ministrie. Ajo bashkëpunon me ministrinë e linjës dhe merr në konsideratë mendimin e tyre përpara se të ofrojë propozime në Këshillin e Ministrave. Implementimi i ligjeve dhe standardeve mjedisore është detyrë e të gjithë aktorëve qeveritarë ose joqeveritarë, si dhe e publikut në përgjithësi. AKM-ja nën MTM ka përgjegjësinë për implementimin e ligjeve dhe standardeve mjedisore.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka përgjegjësinë për koordinimin e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke përfshirë programimin dhe monitorimin e asistencës e Bashkimit Evropian.

Ministria përgjegjëse për bujqësinë, është autoriteti kompetent që harton politikat mbi plehrat dhe produktet e mbrojtjes së bimëve (PMB), si dhe monitoron mbetjet e tyre në bimë, produkte bimore dhe produkte ushqimore me origjinë bimore dhe shtazore. Legjislacioni i produkteve të mbrojtjes së bimëve (PMB) dhe i plehrave për përdorim për bimësinë, rregullon regjistrimin, tregtimin, ambalazhimin, etiketimin, ruajtjen dhe përdorimin tyre, si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe të dhënave, shkëmbimin e informacionit dhe çështje të tjera të hollësishme. Produktet e mbrojtjes së bimëve mund të tregtohen ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm nëse janë të regjistruara. PMB-të përdoren nga përdoruesi i fundit, duke respektuar kërkesat dhe udhëzimet, që jepen në dokumentin e regjistrimit të tyre.

Ligji nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, përcakton autoritetet kompetente në këtë fushë. Referuar këtij ligji:

- Ministria përgjegjëse për mjedisin/Zyra e Kimikateve, është autoriteti kompetent për menaxhimin e kimikateve në vendin tonë;
- Ministria përgjegjëse për tregtinë dhe ministria përgjegjëse për industrinë janë autoritetet kompetente për kontrollin në treg të kimikateve;
- Ministria përgjegjëse për industrinë është autoriteti kompetent për licencimin e veprimtarive që lidhen me kimikate të klasifikuara si të rrezikshme, sipas legjislacionit në fuqi.
- Ministria përgjegjëse për shëndetësinë është përgjegjëse për marrjen e informacionit mbi sigurinë dhe rreziqet e kimikateve të rrezikshme për shëndetin, me qëllim hartimin e masave parandaluese kurative, veçanërisht për rastet e emergjencave shëndetësore.
- Shërbimi i Toksikologjisë Klinike të QSUT-së është organi përgjegjës për marrjen e informacionit përkatës nga importuesit dhe përdoruesit /përdoruesit profesionalë që vendosin në treg përzierjet, me qëllim hartimin/përgatitjen e masave parandaluese dhe kurative, veçanërisht në rastet e përgjigjeve të emergjencave shëndetësore.

Pika 4, neni 12, i ligjit nr. 27/2016, përcakton se praktikat më të mira laboratorike dhe institucionet përgjegjëse për inspektimin e verifikimin e këtyre praktikave, si dhe për testimet e përcaktuara në pikat 5, 6, 7 dhe 8, të këtij neni, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të ministrit përgjegjës për tregtinë në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrin përgjegjës për bujqësinë. **Kufizimet** për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të rrezikshëm të caktuar, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Instituti i Shëndetit Publik realizon kryerjen e analizave të produkteve biocide për monitorime.

Tabela që vijon tregon ligjet dhe rregulloret në lidhje me mjedisin dhe agjencitë zbatuese në Shqipëri.

Tabela 4. Ligjet dhe agjencitë zbatuese

Nr.	Ligji, direktiva etj.	Korniza institucionale për zbatimin e ligjit
1	Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar;	Ministria përgjegjëse për mjedisin; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; inspektorati përgjegjës për Mjedisin; agjencitë e qeverisjes qendrore dhe vendore;
2	Ligji nr. 10440, datë 7.8.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar;	Ministria përgjegjëse për Mjedisin; Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
3	Ligji nr. 9700, datë 26.3.2007, “Për mbrojtjen mjedisore nga ndikimet ndërkuftare”	Ministria përgjegjëse për mjedisin; ministria përgjegjëse për Evropën dhe punët e jashtme;

Nr.	Ligji, direktiva etj.	Korniza institucionale për zbatimin e ligjit
4	Ligji nr. 8897, datë 16.5.2002, "Për mbrojtjen e ajrit", rregulluar me ligjin nr. 10266, datë 15.4.2010; shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 162/2014, "Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis", në datë 4.12.2017;	Ministria përgjegjëse për mjedisin; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Instituti i Shëndetit Publik;
5	Ligji nr. 9010, datë 13.2.2003, "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta", rregulluar me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009, "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë".	Ministria përgjegjëse për mjedisin; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë);
6	Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për administrimin e ujërave të ndotura" (rregulluar me ligjin nr. 10448/11 "Mbi lejet mjedisore").	Ministria përgjegjëse për mjedisin; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; nj. qeverisjes vendore (bashkitë);
7	Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura", rregulluar me ligjin nr. 9868, datë 4.2.2008. Shfuqizuar me ligjin nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura".	Ministria përgjegjëse për mjedisin; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; inspektorati përgjegjës për mjedisin;
8	Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar me ligjin nr. 32, datë 14.2.2013 dhe ligji nr. 156, datë 10.10.2013.	Ministria përgjegjëse për mjedisin; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; nj. qeverisjes vendore (bashkitë);
9	Ligji nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", rregulluar me ligjin nr. 9592, datë 27.7.2006.	Ministria e Kulturës; Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë; Instituti i Monumenteve; Qendra e Regjistrimit të Pasurive Kulturore;
10	Ligji nr. 9108, datë 17.7.2003, "Për substancat dhe preparatet kimike", shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve", në datë 29.3.2018.	Ministria përgjegjëse për mjedisin; inspektorati përgjegjës për mjedisin; Instituti i Shëndetit Publik; Autoritetet doganore, ministria përgjegjëse për tregtinë, ministria përgjegjëse për industrinë, inspektorati shtetëror nën ministrinë përgjegjëse për tregtinë; inspektorati shtetëror nën ministrinë përgjegjëse për industrinë;
11	VKM-ja nr. 676, datë 20.12.2002, "Për deklarimin e Monumenteve natyrore të Shqipërisë si "Zona të Mbrojtura"	Ministria përgjegjëse për mjedisin; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; inspektorati përgjegjës për mjedisin; nj. qeverisjes vendore (bashkitë).

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, nën ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, është përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e rregullave në lidhje me tregtinë, eksportin dhe importin e mallrave.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, nën Ministrinë përgjegjëse për Bujqësinë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjës për kontrollin e ushqimeve, pesticideve dhe importit e eksportit të materialeve bimore.

Institucionet e tjera qendrore të cilat merren me kimikatet në përgjithësi, janë:

Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Energjinë dhe Qendra e Trajtimit dhe Grumbullimit të Kimikateve të Rrezikshme (QTGK), si institucion varësie i saj, kanë përgjegjësi për menaxhimin dhe reduktimin e rrezikut që paraqesin në shëndetin e njerëzve dhe mjedis kimikatet e rrezikshme, të cilat janë gjendje në ish-ndërmarrjet industriale dhe ndërmarrjet e varësisë së MIE-s. QGK është krijuar me VKM-në nr. 843, datë 14.10.2015, e cila ka funksion identifikimin, evidentimin, grumbullimin, depozitimin, ruajtjen dhe përgatitjen për eliminim të kimikateve të fushës së veprimtarisë së kësaj ministrie.

Ministria e Mbrojtjes, e cila është përgjegjëse për menaxhimin dhe eliminimin e mbetjeve të dala nga procesi i shkatërrimit të armëve kimike.

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), i cili është përgjegjës për kontrollin e eksportit, importit, transitimit të agjentëve të armëve kimike, prekusoreve të tyre, si dhe të kimikateve që mund të përdoren si prekusorë të agjentëve kimikë toksikë, të përcaktuara në konventën e armëve kimike, si dhe në listat e kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nivel vendor, janë dhe disa autoritete lokale që lidhen me departamentet mjedisore rajonale dhe inspektoratin vendas, të cilat marrin masa për të shmangur dëmet e shëndetit dhe të mjedisit nga kimikatet.

Bashkëpunimi ndër-institucional organizohet nëpërmjet grupeve të punës *ad-hoc* (me përfaqësues nga

institucione të ndryshme) për përgatitjen e drafteve ligjore ose strategjive, komiteteve të qeverisjes së projekteve, komiteteve ndërministrrore etj.

Bashkëpunimi midis autoriteteve përgjegjëse në fushën e menaxhimit të kimikateve është e rregulluar nëpërmjet legjislacionit përkatës. Ministritë, dogana dhe inspektoratet bashkëpunojnë midis tyre në kryerjen e detyrave të përcaktuara sipas ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”. Referuar pikës 2, të këtij ligji, për të mundësuar bashkëpunimin e institucioneve të përfshira në menaxhimin e kimikateve ngrihet një Komitet Ndërsektorial për Sigurinë Kimike (KNSK). KNSK-ja vepron si një forum këshillues për koordinim në politika dhe në vendimmarrje, për shkëmbimin e informacionit dhe kontrollin e ndërsjellë, pa mandat për vendimmarrje detyruese. Funkcionet, përbërja, si dhe rregullat e procedurat për funksionimin e Komitetit Ndërsektorial për Sigurinë Kimike përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

2.2.3 Angazhimet ndërkombëtare dhe detyrimet përkatëse

Përveç kornizave ligjore shqiptare, Republika e Shqipërisë respekton detyrimet ndërkombëtare të vendosura nga konventat dhe marrëveshjet e ratifikuara nga shteti shqiptar, siç është Konventa e Stokholmit mbi Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (NOQ), e ratifikuar nga ligji nr. 9263, datë 29.7.2004. Fillimisht 12 NOQ janë përcaktuar për veprim ndërkombëtar. Këto përfshijnë pesticidet dhe kimikatet industriale, të tilla si: DDT-ja dhe PCB-ja, të cilat janë përdorur në Shqipëri.

Konventa kryesisht parashikon:

- Masat për reduktimin/eliminimin e shkarkimeve të NOQ-ve të prodhuar në mënyrë të qëllimshme ose jo;

- Regjistrimin e përdorimeve specifike;
- Masat për reduktimin ose eliminimin e shkarkimeve nga vend-depozitimet ose mbetjet;
- Planet e veprimit;
- Kërkimin dhe monitorimin;
- Shkëmbimin e informacionit, ndërgjegje-simin dhe edukimin;
- Marrëveshjet teknike dhe financiare
- Raportimin dhe vlerësimin
- Mospërputhjet dhe zgjidhjen e mos-marrëveshjeve.

Sipas kësaj konvente, palët duhet të ndalojnë prodhimin dhe përdorimin e pesticideve NOQ: aldrin, klordan, dieldrin, endrin, heptaklor, heksaklorobenzen, mireks dhe toksafen; si dhe të reduktojnë përdorimin e DDT-së vetëm në raste shumë specifike. Aneksi B jep kufizimet e DDT-së dhe përdorimet në përputhje me udhëzimet specifike të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Vendet që mund të përdorin ose prodhojnë DDT, duhet të nënshkruajnë një marrëveshje. Për vendet e tjera, përdorimi dhe prodhimi duhet ndaluar.

Megjithatë, të gjitha përgjashtimet duhet të rishikohen pas një periudhë të caktuar kohore:

- Kufizimi i përdorimit të PCB-ve për sistemet e mbyllura, me synimin e nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit dhe heqjen në mënyrë të sigurt mjedisore deri në vitin 2025 për pajisjet ose deri në vitin 2028 për mbetjet;

- Masat duhet të ndërmerren për të eliminuar ose reduktuar shkarkimet nga NOQ-ve të prodhuar në mënyrë jo të qëllimshme;

- Palët duhet të zhvillojnë plane për zbatimin e detyrimeve të tyre sipas konventës;
- Palët duhet të vendosin mekanizma dhe skema për rritjen e ndërgjegjësimit dhe informacionit;
- Palët duhet të inkurajojnë ndërmarrjen e kërkimeve drejt eliminimit të NOQ-ve dhe gjetjes së alternativave të reja.

Konventa e Bazelit mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Depozitimit të tyre, dhe amendimi III/1, është ratifikuar me ligjin nr. 9279, datë 28.10.2004, dhe ka të bëjë me lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe depozitimin e tyre. Konventa e Stokholmit i referohet dokumenteve udhëzuese të hartuara sipas Konventës së Bazelit në lidhje me depozitimin në mënyrë të përshtatshme mjedisore të mbetjeve që përbajnë ose që janë të kontaminuara me NOQ.

Konventa e Vjenës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit dhe Protokollit i Montrealit me katër amendamentet e tij (instrumenti i Montrealit), ka të bëjë me kontrollin e emetimit të substancave ozonholluese (SOH) në atmosferë. Studimi i SOH-ve është realizuar në vendin tonë dhe tregoi tipat dhe sasitë e këtyre substancave që përdoren, shiteshin ose ruheshin në Shqipëri.

Shqipëria gjithashtu respekton detyrimet që rrjedhin nga amendamentet e Protokollit të Montrealit, specifikisht: amendamenti i Londrës (sipas ligjit nr. 9484, datë 2.3.2006), amendamenti i Kopenhagënit (sipas ligjit nr. 9480, datë 16.2.2006), amendamenti i Montrealit (sipas ligjit nr. 9485, datë 6.3.2006) dhe amendamentit të Pekinit (sipas ligjit nr. 9484, datë 2.3.2006).

- Shqipëria është gjithashtu pjesë e:
- Konventës së Vlerësimit të Impaktit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar (ESPO);
 - Konventës Aarhus mbi Aksesin e Informacionit, Pjesëmarrjes Publike në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi;
 - Protokollit të Kievit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor;
 - Konventës mbi Diversitetin Biologjik;
 - Konventës së Ligatinave me Rëndësi Ndërkombëtare, veçanërisht atyre që janë si habitate të shpendëve ujorë;
 - Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike dhe Protokollit të Kiotos mbi Ndryshimet Klimatike;
 - Konventës mbi Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të largët;
 - Konventës mbi Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhjeve Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare etj.

Tabela në vijim tregon disa prej konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat lidhen me mjedisin dhe janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Tabela 5. Konventat ndërkombëtare dhe marrëveshjet e ratifikuara nga Shqipëria

Emri i konventës	Ratifikimi nga Shqipëria
Konventa e Stokholmit mbi Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm	29.07.2004
Konventa e Bazelit mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Depozitimit të tyre, dhe Amendamenti i tij III/1	28.10.2004
Protokollit i Montrealit, respektivisht: Ndaj amendamentit të Londrës, ndaj amendamentit të Kopenhagënit, ndaj amendamentit të Montrealit, dhe ndaj amendamentit të Pekinit	2.3.2006; 16.2.2006 6.3.2006; 2.3.2006.
Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)	1.12.1994
Protokollit i Kiotos	1.4.2005
Konventa e Ramsarit mbi Ligatinat (1971)	29.2.1996
Konventa mbi Biodiversitetin (diversiteti biologjik) (1992)	Pjesë që prej 1994; pjesë në protokoll që prej 2005
Konventa e Bernit (1976): Ruajtja e Jetës së egër dhe Habitave Natyrore	13.1.1999
Konventa e Aarhus (Konventa mbi Aksesin e Informacionit, 1998; Pjesëmarrja publike në vendimmarrje dhe aksesin ndaj drejtësisë në çështjet mjedisore)	27.6.2001
Konventa e Bonn-it ose CMS-ja (1979); Konventa mbi Ruajtjen e Specieve Migruese të Kafshëve të egra	1.9.2001
Konventa e Barcelonës (1976); Konventa për Mbrojtjen e Detit Mesdhetar nga Ndotja	9.7.2004
Konventa Espoo; Konventa e Vlerësimit të Impaktit në Kontekstin ndër-kufitar së bashku me amendamentet dhe protokollet (1991)	12.5.2006
Konventa mbi Mbrojtjen dhe Trashëgimisë Kulturore Nënujore (2001)	19.3.2009

Burimi: Ministria e Mjedisit, 2016

Shqipëria si vend kandidat për t'u bërë pjesë e mjedisit evropian, është angazhuar gjithashtu në disa marrëveshje rajonale dhe bilaterale me vendet fqinje.

2.2.4 Parimet e legjislacionit dhe rregulloreve ekzistuese që trajtojnë NOQ-të

Legjislacioni në lidhje me substancat kimike në Republikën e Shqipërisë rregullon menaxhimin e substancave dhe përzierjeve kimike, produkteve të mbrojtjes së bimëve, substancave shpërthyes, substancat e gazta dhe të lëngshme të djegshme, substancat e rrezikshme, substancat ozonholluese, ndotësit organikë të qëndrueshëm etj.

Transpozimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian për fushën e kimikateve në legjislacionin kombëtar ka shënuar përparësi me miratimin në mars të 2016-s të ligjit nr. 27, datë 17.3.2016, "Për menaxhimin e

kimikateve” dhe të disa akteve zbatuese si:

- VKM-ja nr. 488, datë 29.6.2016, “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, i cili përafuron plotësisht Rregulloren (KE) nr. 1272/2008 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor 2008 mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve, që ndryshon dhe shfuqizon direktivat 67/548/KEE dhe 1999/45/KE dhe ndryshon Rregulloren (KE) 1907/2006. Detyrimet që lidhen me klasifikimin dhe etiketimin e substancave dhe përzierjeve do të hyjnë në fuqi hap pas hapi. Së pari do të hyjnë në fuqi detyrimet që lidhen me substancat (deri në korrik 2018) dhe pastaj detyrimet që lidhen me përzierjet (2 vjet më vonë në korrik 2020);

- VKM-ja nr. 489, datë 29.6.2016, “Për miratimin e listës së substancave me interes shumë të lartë (SVHC), kriteret për përfshirjen e substancave në listën e SVHC-ve dhe lëshimin e një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC”, që përafuron plotësisht shtojcat XIII, XIV dhe XVI të rregullores (KE) nr. 1907/2006, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 18 dhjetor 2006 në lidhje me regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH), krijimin e një Agjencie Evropiane të Kimikateve, që ndryshon direktivën 1999/45/EC dhe shfuqizimin e rregullores së Këshillit (KE) nr. 793/93 dhe rregulloren e Komisionit (KE) nr. 1488/94, si dhe direktivën e Këshillit 76/769/EEC dhe direktivat e Komisionit 91/155/EEC, 93/67/EEC, 93/105/EC dhe 2000/21/EC;

- VKM-ja nr. 665, datë 21.9.2016, “Për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme”, e cila përafuron plotësisht Rregulloren (BE) nr. 649/2012, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 4 korrik 2012 lidhur me eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme, të ndryshuar nga rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) nr. 1078/2014, të datës 7 gusht 2014 dhe 2015/2229, e datës 29 shtator 2015.

Legjislacioni dytësor i miratuar, transponon shumë nga përcaktimet administrative, teknike dhe shkencore, rregullat e aplikimit dhe kërkesat e hollësishme të rregulloreve CLP, REACH dhe eksporti dhe importi i kimikateve të rrezikshme.

Ligji nr. 27, datë 17.3. 2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, synon përveç të tjerave, sigurinë dhe vlerësimin e riskut të kimikateve duke përfshirë këtu edhe NOQ-të, me përcaktimet si vijon:

- Vlerësimi i sigurisë kimike të substancave pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur në Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë për Kimikatin, duke përfshirë edhe rekomandimet për uljen e rrezikut dhe kontrollin e efekteve të dëmshme të substancave të rrezikshme;

- Vlerësimi i rrezikut të substancave të rrezikshme që shkaktojnë shqetësim shumë të lartë (SVHC) kontrollohen ashtu siç duhet dhe këto substanca zëvendësohen në mënyrë progresive nga substancave më pak të rrezikshme ose të aplikohen teknologji të tjera me alternativa të disponueshme që janë të përshtatshme ekonomikisht dhe teknikisht;

- Të sigurohet një ruajtje dhe asgjësim i sigurt për kimikatet e hedhura në treg, në përputhje me kërkesat e dispozitave të këtij ligji;

- Prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi profesional të kimikateve, që kryejnë vlerësimin e sigurisë kimike, duhet të përdorin metodat e përshkruara në këtë ligj dhe rregulloret në zbatim të tij.

Ligji nr. 27/2016 ka hyrë në fuqi 2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare. Me fillimin e efekteve juridike të këtij ligji në datë 29.3.2018, aktet e mëposhtme shfuqizohen:

a) Ligji nr. 9108, datë 17.7.2003, “Për substancat dhe preparatet kimikate”, i ndryshuar;

b) Vendimi nr. 824, datë 11.12.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme”.

VKM-ja nr. 824/2003, e shfuqizuar është zëvendësuar me VKM-në nr. 488, datë 29.6.2016 “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve”,

Miratimi i ligjit nr. 27, datë 17.3.2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, si dhe miratimi i 3 akteve nënligjore që rregullojnë importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme, kufizimet dhe ndalimet e tyre përpara vendosjes në treg, listën e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë, është hapi i parë në krijimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut nga kimikatet me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit.

Ligji nr. 9362, i datës 24.3.2005, “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, i ndryshuar. Ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 105/2016, datë 27.10.2016, “Për mbrojtjen e bimëve”.

VKM-ja nr. 1188, datë 20.8.2008, “Mbi miratimin e rregullave për importin, paketimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe largimin e PMB-ve”, ndryshuar me VKM-në nr. 462, datë 10.7.2012; janë përcaktuar qartë rregullat për importin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe eliminimin e PMB-ve në formën e tyre tregtare, të cilat do të importohen dhe përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Procedurat për regjistrimin dhe kriteret e vlerësimit të PMB-ve janë përcaktuar në VKM-në nr. 335, datë 6.6.2018, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, e cila ka shfuqizuar VKM-në nr. 1555, datë 12.11.2008, “Për

përcaktimin e rregullave për regjistrimin dhe kriteret e vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar. Në këtë VKM përcaktohet se:

- Të gjitha PMB-të që vendosen në treg dhe përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë vetëm të regjistruara;
- Në Republikën e Shqipërisë, pranohen për regjistrim vetëm PMB-të që janë të regjistruara në një nga vendet e Bashkimit Evropian;
- Lënda/ët vepruese në përmbajtje të PMB-së të jenë të miratuara me urdhër të ministrit, që mbulon bujqësinë;
- Dokumenti i regjistrimit të PMB-së përmban certifikatën e regjistrimit dhe etiketën me fletëudhëzuesin. Përmbajtja e etiketës dhe e fletëudhëzuesit duhet të jetë në gjuhën shqipe;
- Aplikanti duhet të vërë në dijeni SPMB-në për PMB-në në procedurë regjistrimi ose të regjistruar për cdo informacion të ri, për mbetjet e saj ose për lëndën/t vepruese, për efektet potenciale të rrezikshme për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve, për ujërat nëntokësore dhe për mjedisin;
- Ministria përgjegjëse për bujqësinë informon në median e shkruar ose elektronike veprimtaritë e organizuara lidhur me sigurinë, cilësinë, efektshmërinë, përdorimin dhe parandalimin e rreziqeve nga tregtimi dhe përdorimi i PMB-ve”.

Nëpërmjet këtyre masave synohet regjistrimi i substancave aktive dhe përbërësve të tjerë të PMB-ve, në mënyrë që të mbrohen bimët dhe produktet e tyre nga parazitët, pa pasur impakt në shëndetin e njeriut, të kafshëve dhe të mjedisit.

Akti i parë nënligjor që lidhet me NOQ është VKM-ja nr. 860, datë 20.12.2006, “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm”, që kishte për qëllim rehabilitimin e disa zonave të ndotura me NOQ, si dhe eliminimin dhe largimin e mbetjeve të kimikateve NOQ nga vendi ynë për djegien e tyre.

Një akt nënligjor i rëndësishëm që lidhet me NOQ-të është VKM-ja nr. 360, datë 29.4.2015, “Për miratimin e listës së Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”, i cili ka për qëllim të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga ndotësit organikë të qëndrueshëm (NOQ), bazuar në parimin e parandalimit, nëpërmjet: a) ndalimit, nxjerrjes nga përdorimi të NOQ-ve ose kufizimit të prodhimit, vendosjes në treg dhe përdorimit sipas përcaktimeve të dhëna në këtë vendim; b) reduktimit të shkarkimeve në mjedis të NOQ-ve deri në eliminimin e tyre; c) menaxhimit të mbetjeve që kanë në përbërjen e tyre ose që janë të kontaminuara me NOQ. Në këtë vendim përcaktohet qartë kontrolli i prodhimit, vendosja në treg, përdorimi, eksportimi dhe transitimi i NOQ-ve/mbetjeve të kontaminuara/që kanë në përbërje NOQ, si dhe kontrolli doganor i tyre, duke respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stokholmit. Gjithashtu, përcaktohet që ministria përgjegjëse për mjedisin përgatit Planin Kombëtar të Veprimit (PKV) për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e NOQ-ve, si dhe AKM-ja përcaktohet si institucioni kryesor përgjegjës për monitorimin dhe raportimin në lidhje me NOQ-të.

Gjithashtu, VKM-ja nr. 387, datë 6.5.2015, “Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura”, ka për qëllim të rregullojë asgjësimin e kontrolluar të PCB-ve, çndotjen ose asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e PCB-ve të përdorura, në mënyrë që ato të eliminohen plotësisht në vendin tonë.

Të gjitha kimikatet e përfshira në konventën e shkallës së parë, të dytë dhe të tretë, pajisje të tjera që prodhojnë kimikate, dhe ato të veçanta që kontrollohen sipas kësaj konvente, mund të inspektohen në çdo kohë nga Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike, sipas zbatimit të kornizave ligjore të mësipërme. Po ashtu, kimikatet e mësipërme i raportohen Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike, e cila mund të bëjë inspektime në çdo kohë.

2.2.5 Prioritetet, problemet dhe objektivat për fuqizimin institucional dhe rregullator

Menaxhimi i NOQ-ve në Shqipëri mbështetet në Konventën e Stokholmit, dhe në një tërësi ligjesh mjedisore. Bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë, neni 122 “Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar është pjesë e një sistemi të brendshëm juridik”, pas publikimit në fletoren zyrtare. Marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar është superiore në krahasim me ligjet vendase.

Bazuar në këtë përkufizim kushtetues, Konventa e Stokholmit është pjesë e sistemit juridik kombëtar të Shqipërisë. Në legjislacionin shqiptar nuk ekziston asnjë ligj që i kundërvihet kësaj konvente. Përgatitja e kuadrit të caktuar ligjor që garanton zbatimin e kërkesave të Konventës, është pjesë e përpjekjeve të përgjithshme për të harmonizuar legjislacionin kombëtar me atë të BE-së në fushën e mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit.

Nga pikëpamja institucionale, Konventa e Stokholmit paraqet gjithashtu detyrimet për vendet, të cilat

e kanë nënshkruar/ratifikuar atë. Pavarësisht kësaj, nuk ka përkufizime për organet e reja apo përkrahjet e përcaktuara të punës për ato ekzistuese, që vendet respektive të merren me dispozitat e Konventës së Stokholmit. Detyrimet për vendet janë të qarta, dhe u përket atyre që të hartojnë strukturat e tyre në mënyrë që të aplikojnë efektivisht vetë Konventën.

Megjithatë, ekziston një nevojë e shprehur për pjesëmarrje të gjerë, jo vetëm nga ana e shtetit, por edhe nga shoqëria civile, institucionet shkencore, universitetet dhe laboratorët, rrjetet për mbledhjen, vlerësimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor etj. Në procesin e implementimit të Konventës së Stokholmit, identifikimi i institucioneve të mësipërme është shumë i nevojshëm, dhe përfshirja e tyre e detyrueshme.

Çështjet e mëposhtme janë identifikuar në lidhje me kuadrin institucional ekzistues në Shqipëri:

- Vlerësimi i organeve dhe strukturave ekzistuese, si kapaciteti më i rëndësishëm veprues, për vlerësimin e rëndësishëm të çështjeve që rrjedhin nga Konventa e NOQ-ve;
- Rivlerësimi dhe përditësimi i detyrimeve konkrete, që institucionet përkatëse kanë aktualisht në lidhje me menaxhimin e NOQ-ve, në përputhje me funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre;
- Krijimi i skemës së re institucionale, e cila të përfshijë të gjitha strukturat dhe organet në nivel qendror dhe vendor, përcaktimin e roleve, funksioneve, përgjegjëseve, kompetencave dhe detyrave të secilit prej tyre, marrëdhënien e tyre dhe rregullat e funksionimit të të gjithë sistemit;
- Përcaktimin e pikave të kontaktit në nivel kombëtar dhe lokal dhe/ose sektorial, të cilat së bashku përbëjnë Rrjetin Kombëtar të NOQ-ve;
- Pikat e kontaktit duhet të ndërtojnë skemën e tyre të komunikimit, si dhe duhet të përgatisin programe operative për mënyrën e realizimit të detyrave respektive.
- Standardizimi dhe përgatitja e dokumenteve, regjistrave, inventarëve etj., lidhur me NOQ-të, në mënyrë që të ketë një formë standarde dhe unike; përcaktimi i rregullave dhe procedurave që të merren me dokumentacionin për mirëmbajtjen e tij në qendra të veçanta kombëtare.

Problemet janë të njëjta:

- Mungesa e zbatimit të ligjit;
- Mungesa e shpërndarjes së informacionit;
- Mungesa e strukturave të veçanta për çështjet e menaxhimit të NOQ-ve.

Në kuadër të përgjegjëseve për zbatimin e kësaj konvente, duhet të ndërmerren një sërë hapash në lidhje me:

- Përmirësimin e kuadrit ligjor kombëtar për adresimin e çështjeve të NOQ-ve;
- Zgjerimin e kapacitetit institucional në nivele qendrore dhe vendore;
- Vlerësimin dhe krijimin e një inventari kombëtar të NOQ-ve dhe përditësimin e tij;
- Zhvillimin, përditësimin dhe implementimin e një plani kombëtar për të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme këto kimikate, në mënyrë që të reduktohen impaktet mbi mjedisin dhe shëndetin.

2.3 Vlerësimi i gjendjes së NOQ-ve në Shqipëri

Vlerësimi i gjendjes dhe inventarit të NOQ-ve u bazuan në metodologjinë e dhënë nga UNEP-i, dhe u realizua sipas hapave të mëposhtëm:

- Përgatitja e planit për inventarin (duke përfshirë identifikimin e institucioneve kryesore, përcaktimi i qëllimit të inventarit dhe hartimin e planit të punës);
- Zgjedhja e metodologjisë që do të përdoret;
- Grumbullimi i të dhënave nga sektorët kryesor (bazuar në përdorimin specifik të NOQ-ve);
- Përpunimi dhe vlerësimi i të dhënave të marra;
- Nxjerrja e konkluzioneve dhe përgatitja e raportit.

2.3.1 Pesticidet NOQs

Vlerësimi aktual i gjendjes së pesticideve NOQ bazohet kryesisht te NOQ-të e rinj pasi inventari i NOQ-ve të tjerë, të cilët janë listuar në Konventën e Stokholmit në vitin 2001, është prezantuar në PKV-në e parë në vitin 2006.

Në grupin e NOQ-ve të rinj të përdorur si pesticide futen: klordekone (chlordecone), alpha heksaklorocikloheksani, beta heksaklorocikloheksani, lindani, pentaklorobenzeni dhe endosulfani.

Klordekoni është prodhuar për herë të parë në vitin 1951 dhe u fut në treg duke u përdorur si pesticid në vitin 1958. Emrat tregtarë të formulimit kimik që ka si lëndë aktive klordekon janë Kepone dhe GC-1189.

Lindani është prodhuar dhe përdorur si pesticid gjerësisht në vendin tonë, mbetje të të cilit janë evidentuar gjatë raportimit të parë. Prodhimi dhe përdorimi i lindanit ose forma gama e heksaklorocikloheksanit është i lidhur dhe me prezencën e formave të tjera izomerike alfa dhe beta

heksaklorocikloheksani. Kështu, për çdo ton lindan prodhohen nga 6–10 tonë alfa dhe beta heksaklorocikloheksan.

Pentaklorobenzeni (PeCB) është një komponim kimik që përmbahet në pesticidin pentakloronitrobenzen (PCNB) ose quitozene në sasinë 10g/kg. Kështu përdorimi i PCNB-së ose quitozenit në bujqësi shoqërohet me emërtimin edhe të PeCB.

Endosulfani është një insekticid kolorganik që ka filluar të përdoret që nga viti 1950. Ky pesticid është përdorur në vendin tonë. Emri tregtar i preparatit që ka si lëndë aktive endosulfan është Thiodan.

Disa nga kripërat e acidit perfluoroktan sulfonik janë përdorur si pesticide (insekticide/ acaricide) dhe për këtë arsye do të merren edhe të dhëna mbi përdorimin e mundshëm dhe gjendjen e tyre në vendin tonë.

Për NOQ-të e rinj të cituar më lart të përdorur si pesticide u morën të dhëna nga ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe kompanitë tregtuese mbi sasinë e importit, përdorimin dhe gjendjen e mundshme të tyre deri tani.

Informacioni i marrë nga ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural mbi përdorimin dhe gjendjen e NOQ-ve të rinj të përdorur si pesticide jepet në tabelën e mëposhtme (tabela 6).

Tabela 6. Përdorimi dhe gjendja NOQ-ve të rinj të përdorur si pesticide

Nr.	Emërtimi kimik ose emri lëndës aktive	Emri (emrat) tregtar	Sasia e importuar nga viti 2006 deri tani (litra)	Kompania/ Shoqëria importuese dhe tregtuese	Sasia e përdorur nga viti 2006 deri tani (litra)	Sasia e papërdorur ose gjendje (kg)	Vendndodhja dhe paketimi
1	Klordekone	KEPONE; GC-1189	-----	-----	-----	-----	-----
2	Heksaklorocikloheksan	Lindan	-----	-----	-----	-----	-----
3	Pentaklorobenzen (PeCB)	Pentaklorobenzen (PeCB)	----	-----	----	----	----
4	Pentakloronitrobenzen (PCNB)	Pentakloronitrobenzen (PCNB) ose Quitozen	----	----	----	----	----
5	Endosulfan	Thiodan	Gjendja në fund 2003: 680 l 2004: 2000 l 2005: 5140 l 2006: nuk ka import	Prodhues: Bayer Importues: Agroinput Jazexhi	2004: 2020 1 2005: 1970 1 2006: 1430 1 2007: 2400 1	Nuk ka	Nuk ka
6	Acidi Perfluoroktan Sulfonik (C ₈ HF ₁₇ O ₃ S)		----	----	----	----	----
7	Sulfonat Perfluoroktan (C ₈ F ₁₇ SO ₃)		----	----	----	----	----
8	Sulfluramid (C ₁₀ H ₆ F ₁₇ NO ₂ S)	Finitron; Firstline; FluorGuard; Frontline; GX-071; Alstar (pesticide); Mirex S	----	----	----	----	----
9	Totali		7 820 litra		7 820 litra	-----	

Të dhënat e marra tregojnë që nga gjithë NOQ-të e rinj të përdorur si pesticide, vetëm endosulfani është importuar, tregtuar dhe përdorur në vendin tonë gjatë 10-vjeçarit të fundit.

Në vendin tonë nuk është prodhuar endosulfan, por është përdorur për kontrollin e insekteve në pemë frutore, vreshta, agrume, perime, patate etj.

Formulimi tregtar që është përdorur ka qenë thiodan 35 EC, i cili përmban 32.9 % (ose 352 g/l) lëndë

aktive endosulfan (përzierje 70% alfa- dhe 30% beta-endosulfan).

Importi i thiodanit në vendin tonë ka vazhduar deri në vitin 2005 dhe më pas është ndaluar, ndërsa e gjithë sasia e importuar është përdorur deri në vitin 2007 (shiko tabelën 6).

Pesticidet e tjerë si NOQ-të e rinj, si: klordekon (chlordecone), heksaklorcikloheksan (hexachlorocyclohexane), pentakloronitrobenzen (PCNB) që përmban si papastërti pentakloro-benzenin (PeCB) dhe kripërat e acidit perfluorooktan sulfonik nuk janë importuar, tregtuar dhe përdorur në vendin tonë gjatë 10-vjeçarit të fundit.

Takimet me institucionet përgjegjëse, kompanitë importuese dhe tregtuese të pesticideve, si dhe intervistat me fermerët konfirmojnë mospërdorimin e këtyre pesticideve gjatë këtyre 10 viteve të fundit.

Ndërsa endosulfani është importuar deri në vitin 2005 dhe përdorimi i tij ka vazhduar deri në vitin 2007. Ky pesticid i tregtuar në emrin tregtar thiodan, i cili përmban 32.9% (ose 352 g/l) lëndë aktive endosulfan, është përdorur në bujqësi për mbrojtjen e bimëve nga insekte të ndryshme si afidet, vemjet, buburrecat etj.

Sasia e përdorur nga viti 2004 më 2007 është 7820 litra thiodan, duke qenë se ky preparat përdoret në përqendrimin 0.1–0.2% ose nga 1–1.5 litra/ha dhe mund të kemi deri në dy trajtime në vit, sipërfaqja e trajtuar me këtë pesticid varion nga 3000 deri në 3500 ha për 4 vite ose rreth 750-850 ha në vit. Krahasuar me totalin e sipërfaqes së tokës bujqësore të kultivuar kjo sipërfaqe është shumë e vogël.

Bazuar në këto të dhëna mund të prezumohet që mbetjet e endosulfanit në mjedis janë jo të konsiderueshme. Por problematika mbetet në zonat e përdorimit sidomos në pemëtoret dhe serrat, ku përdorimi i tij ka pasur përparësi. Kështu, analiza të tokave të serrave, pemëtoreve për mbetjet e mundshme të endosulfanit, por jo vetëm duhet që të realizohen në procesin e monitorimit të mbetjeve të pesticideve si NOQ në mjedis.

Edhe pse pesticidet e klasifikuara si NOQ nuk importohen dhe tregtohen në vendin tonë, mbetje të këtyre pesticideve mund të jenë si papastërti e pesticideve apo lëndëve aktive që lejohen të importohen dhe tregtohen. Pra mbetjet e pesticideve NOQ në formulimet e lejuara mund të përbëjnë një problematikë shqetësuese në rast të një mungese të kontrollit të cilësisë së pesticideve që importohen/tregtohen jo vetëm për sa i përket lëndës së tyre aktive, por edhe papastërtive ose komponimeve shoqëruese.

Kështu, në këtë kuadër duhet të citojmë që është shumë e rëndësishme analiza cilësore dhe sasiore jo vetëm e lëndëve aktive të pesticideve që importohen dhe tregtohen në vendin tonë, por edhe e papastërtive apo komponimeve shoqëruese të këtyre pesticideve.

2.3.2 DDT-ja dhe lindani

Nga të dhënat e marra nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë (Instituti i Shëndetit Publik), ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe ministria përgjegjëse për mjedisin mbi gjendjen e mundshme të pesticideve (DDT-ja dhe lindan) rezulton se nuk ka gjendje fizike të këtyre komponimeve. Pasi siç raportohet edhe në raportin e parë sasitë e identifikuarat gjatë inventarit 2006 të DDT-së dhe heksakloran/lindanit u hoqën nga Shqipëria në kuadër të projektit të MMPAU-së, “Ripaketimi dhe heqja nga Shqipëria e pesticideve dhe e kimikateve të tjera nga Bishti i Pallës” të financuar nga qeveria holandeze dhe ky eliminim u përfundua në korrik 2006.

Gjatë inspektimit të vendeve me mbetje të mundshme të këtyre pesticideve sidomos në Portoromano–Durrës, konstatohet që ish-zona qendrore e prodhimit të lindanit pas largimit të mbetjeve, është e rrethuar dhe kapsuluar (betonuar) dhe në parim nuk lejon ndotje të mëtejshme. Por emetimet e mëparshme nëpërmjet ajrit, rrjedhjeve ujore, erozionit të tokës dhe bazuar në qëndrueshmërinë e lartë të këtyre komponimeve na çojnë në përfundimin se monitorimi i zonës përreth, analiza të tokave, ujërave, e organizmave bimor dhe shtazor, analizimi i mostrave të gjakut të njeriut për vlerësimin e ndikimit në shëndet dhe mjedis të NOQ-ve dhe mbetjeve të tyre dhe ecurinë e këtyre komponimeve është i domosdoshëm.

Përfundime dhe rekomandime

Nga analiza e mësipërme mbi inventarin dhe problematikën që lidhet me pesticidet NOQ nxjerrim përfundimet ose konkluzionet si vijon:

- Legjislacioni në vendin tonë mbi pesticidet NOQ është i përafëruar me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- Nuk ka gjendje fizike dhe nuk përdoren pesticide NOQ në vendin tonë;
- Mbetje të pesticideve NOQ në mjedis raportohen nga disa studime të realizuara në vendin tonë;
- Nuk ka një vlerësim dhe monitorim të mbetjeve të pesticideve NOQ në mjedis dhe shëndet, të transportit të tyre në organizma bimor dhe shtazor.
- Nuk kryhen analiza të papastërtive ose të komponimeve shoqëruese të pesticideve që

importohen/tregtohen në vendin tonë, pasi ata mund të përmbajnë pesticide NOQ.

Nisur nga përfundimet e mësipërme mund të japim rekomandimet si vijon:

- Legjislacioni mbi pesticidet NOQ duhet në vijimësi të përditësohet/përafrohet me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- Të vendosen normat e lejuara të përmbajtjes së pesticideve NOQ në mjedis si tokë, ujë, ajër etj. në përputhje me normativat e vendosura nga institucionet ndërkombëtare;
- Të realizohen studime të gjendjes së pesticideve NOQ në mjedis për të marrë masat për reduktimin/eliminimin në zonat që mund të rezultojnë me nivele të larta ose tej normave të lejuara;
- Të monitorohen mbetjet e pesticideve NOQ në zonat e ndotura, hotspotet e evidentuara ndikimi i tyre në mjedis dhe shëndet dhe të jenë pjesë e vlerësimit dhe raportimit të gjendjes së mjedisit në vendin tonë.
- Të realizohen analiza cilësore dhe sasiore jo vetëm të lëndëve aktive të pesticideve që lejohen të importohen/tregtohen në vendin tonë, por edhe e papastërtive ose mbetjeve të tyre për prezencë të mundshme të pesticideve NOQ.

2.3.3 Bifenilet e poliklorinuara (PCBs)

Gjendja ose inventari i PCB-ve në vendin tonë lidhet kryesisht me përmbajtjen e tyre në transformatorët/kondesatorët që përdoren në sistemin energjetik. Sistemi energjetik aktual përbëhet nga Korporata Elektroenergetike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE). Informacioni mbi gjendjen e transformatorëve dhe mundësinë e përmbajtjes së PCB-ve që lidhet kryesisht me ekzistencën e transformatorëve të vjetër të prodhuar para viteve 1990 u morr nga kompanitë e mësipërme.

PCB-të nuk janë prodhuar kurrë në Shqipëri, vaji i transformatorëve është importuar gjithmonë nga shtete të tjerë të Evropës ose Azisë. Transformatorët më të vjetër në sistemin energjetik shqiptar janë rusë, prodhim i viteve 1950. Në të kaluarën furnizuesit kryesorë të Shqipërisë me transformatorë kanë qenë ish-Bashkimi Sovjetik dhe Kina. Transformatorët e prodhuar në ish-Bashkimi Sovjetik, që tashmë janë shumë të pakët, e kanë moshën rreth 50 vjet. Pjesa më e madhe e transformatorëve në Shqipëri janë prodhuar në Kinë, Bullgari, Maqedoni dhe Rumani, ndërsa vitet e fundit janë importuar shumë transformatorë nga Italia, Kroacia, Zvicra dhe Belgjika dhe numri i tyre ka ardhur vazhdimisht në rritje.

Në vitin 2005 është ndërmarrë përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm. Në kuadrin e përgatitjes së këtij Plani u krye inventari paraprak i PCB-ve me objektiv identifikimin e të gjithë transforma-torëve me PCB që ishin në përdorim dhe/ose jashtë përdorimit, zbatimin e masave paraprake kryesisht në pajisjet me PCB në përdorim për të siguruar monitorimin e përputhjes teknike të gjitha pajisjeve me PCB që ishin në përdorim, si dhe për të siguruar ndjekjen e pajisjeve me PCB deri në fund të jetës së tyre. Gjatë këtij inventari janë evidentuar rreth 5.3% e transformatorëve ose 320 copë që mund të jenë të ndotur me PCB.

Të dhënat aktuale mbi inventarin e transformatorëve në sistemin energjetik të vendit tonë paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 7. Të dhëna mbi transformatorët në TEC dhe HEC sipas divizioneve KESH/OST/OSHEE

Nr.	KESH/OST/OSHEE	Numri i përgjithshëm i transformatorëve	Masa totale e vajit (litra)
1	Divizioni i prodhimit	39	459701
2	Operatori i Sistemit të Transmetimit	67	1819407
3	Divizioni i shpërndarjes/kabinat	12395	3718500
4	Divizioni i shpërndarjes/nënstacionet	288	2648014
5	Totali	12789	8679542

Sasia më e madhe e transformatorëve, për pasojë edhe e vajit mineral që përmbahet në to, disponohet nga objektet e sistemit elektroenergetik, që janë: OSHEE-ja, OST-ja dhe KESH-i. Nga të dhënat që disponohen, në Objektet e Ushtrisë Shqiptare, gjithashtu, ka një sasi modeste pajisjesh elektrike që përmbajnë vaj, por këta transformatorë janë të fuqisë së ulët që shkon deri në 560 kV si rrjedhojë dhe sasia e vajit në këta transformatorë është relativisht e vogël, duke variuar nga 20 deri 1000 litra.

Numri i kondensatorëve në objektet e KESH/OSHEE është i vogël dhe ata janë vendosur në Nënstacionin 220 kV në Fier (2x30 MV Ar), në Nënstacionet 110 kV në Lushnjë dhe në Ballsh (secili prej tyre është 25 MVar) të cilët i përkasin OSHEE-së, ndërsa dy operatorët e tjerë nuk i përdorin

kondensatorët (shiko tabelën e mëposhtme).

Kondensatorët përmbajnë sasi të vogël vaji dhe në trupin e tyre ka pak pika lidhëse, kështu që ata nuk kanë krijuar ndotje mjedisi përreth tyre, por është e rëndësishme marrja e masave teknike për ndalimin e rrjedhjeve të mundshme të vajit të tyre dhe ndotjes së mjedisit përreth.

Tabela 8. Numri i kondensatorëve në objektet e OST-së

Nr.	OST/Nënstacionet	Numri i përgjithshëm i kondensatorëve	Masa e përgjithshme e vajit (litra)
1	Nënstacionin 220 kV në Fier	2x30	1800
2	Nënstacionet 110 kV në Lushnjë	1x30	900
3	Nënstacionet 110 kV në Ballsh	1x30	90
4	Totali	4x30	3600

Rreth 47% e sasisë së përgjithshme të transformatorëve janë prodhuar para vitit 1990 (rreth 6000 copë) dhe vjetërsia mesatare e transformatorëve është më e madhe se 28 vjet. Rreth 97% e transformatorëve janë transformatorë të vegjël të vendosur në kabina elektrike që i përkasin OSHEE-së. Pjesa tjetër e transformatorëve është vendosur në HEC-et e KESH-it dhe në nënstationet e OST-së e OSHEE-së, rreth 288 prej tyre i përkasin OSHEE-së, 39 i përkasin KESH-it dhe 67 i përkasin OST-së.

Nga të dhënat e inventarit të parë të PCB-ve rezultoi se 5,3% sasisë së vajit pritej të ishte e ndotur me PCB. Aktualisht, KESH-i ka kryesisht transformatorë të rinj që i takojnë periudhës pas vitit 1990, duke përjashtuar mundësinë e përmbajtjes së PCB-ve në vajin e tyre pasi dhe mbushja me vaj e transformatorëve bëhet me vaj pa përmbajtje të PCB-ve. Gjithashtu, KESH-i ka hartuar një plan veprimi për analizën e PCB-ve në vajin e transformatorëve.

Në objektet energjetike shqiptare janë akoma në përdorim mjaft transformatorë të vjetër të prodhuar para vitit 1990, të cilët kanë krijuar ndotje të mjedisit veçanërisht në tokë dhe ujë për shkak të rrjedhjeve të vajit dhe pikimeve gjatë procesit të mirëmbajtjes ose për shkak të vjetërsisë së tyre. Një pjesë e madhe e transformatorëve janë vendosur në tokë ose mbi një bazament por nuk kanë rezervuar dytësor poshtë transformatorëve. Lehtësisht mund të evidentohet toka e ndotur poshtë transformatorëve prandaj është e nevojshme ndjekja e problemit të ndotjes së tokës dhe ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Një vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet zonave më të ndotura me vaj transformatorësh siç janë reparti i riparimit të transformatorëve në Tiranë që i përket OSHEE-së dhe reparti i rigjenerimit të vajit në Tiranë që i përket OST-së. Me gjithë punën e bërë për ndërgjegjësimin e të gjithë personelit duke filluar nga drejtuesit e duke vazhduar me të gjithë personelin, për marrjen e masave paraprake për të shmangur ndotjen e mjedisit e kryesisht të tokës dhe ujërave nga pikimet apo rrjedhjet e vajrave, ka pasur një përmirësim të situatës por përsëri mbetet shumë për të bërë. Këto ambiente kanë shumë vite që operojnë me vajra si rrjedhojë ka një ndotje shumëvjeçare të akumuluar në tokë qoftë kjo e betonuar apo dhé. Kërkohet një koordinim i mirë ndërmjet institucioneve, si dhe financim i mirë për rehabilitimin e tyre apo krijimin e ambienteve të reja për këtë operim dhe rehabilitimin e atyre ekzistues.

PCBs janë objekt i tri konventave ndërkombëtare që lidhen me trajtimin e mbetjeve të rrezikshme dhe konkretisht: Konventa e Bazelit, Konventa e Roterdamit dhe Konventa e Stokholmit, PCB-të trajtohen duke iu referuar prodhimit, deklarimit, përdorimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, transportit, monitorimit, nxjerrjes jashtë përdorimit dhe eliminimit të tyre.

Vaji i transformatorëve është elementi kryesor në të gjitha objektet e sistemit energjetik, i cili mund të ndotë mjedisin përreth me PCBs. Këto objekte kanë në përdorim sasi shumë të mëdha të vajit mineral, rreth 10 000 tonë. Kështu, monitorimi dhe marrja e masave për reduktimin ose eliminimin e derdhjeve të vajrave dhe zëvendësimin e tyre me transformatorë të rinj është e rëndësishme për ruajtjen e mjedisit nga ndotja me PCBs.

Në vendimin nr. 387, datë 6.5.2015, "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura" përcaktohet që pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB dhe PCB të përdorura, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të eliminohen brenda vitit 2018. Në këtë kuadër, zotëruesit e pajisjeve, objekteve, materialeve dhe lëngjeve që përmbajnë PCB në vëllim, duhet të dërgojnë informacion ose vetëdeklarim paraprak pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), e cila harton inventarin paraprak (brenda vitit 2016) dhe inventarin përfundimtar për pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB dhe PCB të përdorura, bazuar në vetëdeklarimet përfundimtare të zotëruesve të tyre, brenda vitit 2019. Gjithashtu AKM-ja ngarkohet me monitorimin e ecures së procesit të asgjësimit dhe/ose çndotjes së pajisjeve që përmbajnë PCB e PCB të përdorura.

Sot është kufizuar në maksimum prodhimi dhe përdorimi i PCB-ve, sikurse u tha më sipër, duhet të kalojnë shumë vite që ato të mos jenë më një problem mjedisor. Janë bërë përpjekje që të përdoren substanca të tjera në vend të PCB-ve si homologë të kloruar të naftalenit dhe të benzenit, por edhe këto nuk janë të parrezikshme.

Përfundime dhe rekomandime

- Për shkak të përdorimit të transformatorëve shumë të vjetër, riparimit të tyre në kushte jo plotësisht me standarde rezultojnë që disa mjedise poshtë transformatorëve ose në mjediset e riparimit të tyre të vërehen rrjedhje vaji dhe ndotje potenciale të mjedisit përreth me PCBs, kjo sidomos në repartin e riparimit të transformatorëve në Tiranë ku ndodhet edhe magazina qendrore për të gjithë transformatorët e dëmtuar që vijnë nga të gjitha rrethet e Shqipërisë dhe Reparti i Rigjenerimit të Vajit në Tiranë.

- Sipas të dhënave të inventarit rezultojnë që prania e PCBs në vendin tonë është relativisht e ulët, por një studim më i plotë duhet në këtë drejtim.

- Duhet të ndërmerren masat e nevojshme për pastrimin e vendeve të ndotura me vajra të pajisjeve elektrike dhe, potencialisht, me PCBs.

- Duhet të funksionojë një sistem monitorimi për kontrollin e pajisjeve me PCBs dhe analiza të sistemeve mjedisore mbi prezencën potenciale të PCBs për të marrë masa mbi reduktimin/eliminimin e PCBs nga mjedisi.

2.3.4 NOQ-të e prodhuar joqëllimisht

NOQ-të e prodhuar në mënyrë jo të qëllimshme, siç përcaktohet në Konventën e Stokholmit, janë dibenzofuranet e polikloruara (PCDF), dibenzo-p-dioksinat e polikloruara (PCDD), heksaklorobenzeni (HCB), si dhe bifenilet e polikloruara (PCBs), ku PCB-të janë formuar si nënprodukte. Pentaklorobenzeni (PCB) është përfshirë në aneksin C të Konventës në vitin 2009 dhe naftalenet e polikloruara janë përfshirë në këtë aneks në vitin 2015.

Dibenzofuranet e polikloruara (PCDF) dhe dibenzo-p-dioksinat e polikloruara (PCDD) janë ndotësit mjedisor të gjetur në pothuajse të gjithë komponentët mjedisor në sasi të vogla. Por për shkak të toksicitetit të lartë dhe qëndrueshmërisë së tyre në mjedis përbëjnë një shqetësim mjedisor.

Dioksinat janë ndër kimikatet më toksike të njohura nga njeriu. Helmime akute shkaktohen rrallëherë, por dioksinat, janë të qëndrueshme dhe bioakumulohen te njeriu. Si pasojë, efektet kronike janë problemi kryesor. Kështu, afro 90% e PCDD dhe PCDF merren nga njeriu nëpërmjet zinxhirit ushqimor. Rrugë të tjera të rëndësishme të ekspozimit mund të jenë thithja nëpërmjet frymëmarrjes ose gjellitja e grimcave të ndotura.

Sipas inventarit të parë të raportuar më 2006, janë evidentuar 9 kategori burimesh të NOQ-ve të paqëllimshme. Konstatohet se djegia e pakontrolluar e mbetjeve urbane është burimi kryesor i shkarkimeve në ajër duke zënë rreth 73.54% të totalit dhe djegia e mbetjeve spitalore, është burimi tjetër i madh i shkarkimeve, duke kontribuar me rreth 23.8% të totalit kombëtar, ndërsa kontributi i kategorive të tjera mbetet i parëndësishëm.

Për të realizuar inventarin aktual të shkarkimeve të mundshme të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht u morën të dhëna nga AKM-ja, Raporti i Gjendjes së Mjedisit, si dhe INSTAT-i.

Llogaritja e shkarkimeve të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht PCDD/PCDF bazohet në metodologjinë e dhënë nga UNEP: “*Toolkit for Identification and Quantification of Releases of Dioxins, Furans and Other Unintentional POPs, January 2013*”.

Sipas kësaj metodologjie indentifikohen 10 burime të mundshme të shkarkimeve të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht, me emetime në ajër, ujë, tokë, produkte dhe mbetje që shprehen në gram toksicitet ekuivalent në vit.

Të dhënat përmbledhëse të inventarit aktual të shkarkimeve të mundshme të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 9. Shkarkimi i PCDD/PCDF në Shqipëri për vitin 2014

Grupi	Burimet	Shkarkimi vjetor (g TEQ/vit)				
		ajër	ujë	tokë	produkte	mbetje
1	Djegia e mbetjeve në incenerator	6.4	0.0	0.0	0.0	0.2
2	Prodhimi i metaleve ferrorë dhe joferrorë	4.4	0.0	0.0	0.0	1.6
3	Prodhimi i energjisë dhe ngrohja	2.4	0.0	0.0	0.0	1.2
4	Prodhimi i mineraleve	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0
5	Transporti	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0

Grupi	Burimet	Shkarkimi vjetor (g TEQ/vit)				
		ajër	ujë	tokë	produkte	mбетje
6	Djegia e pakontrolluar e mбетjeve	12.8	0.0	6.5	0.0	0.0
7	Prodhimi i kimikateve dhe mallrave për konsum	0.0	0.0	0.0	5.0	0.0
8	Të ndryshme	0.0	0.0	0.0	0.0	4.4
9	Vend-depozitimet e mбетjeve	0.0	0.1	0.0	0.0	2.5
10	Identifikimi në hot-spotet potenciale				0.6	0.0
1-10	Shuma	26.5	0.1	6.5	5.6	10.0
SHUMA TOTALE				49		

Burimi i djegieve të pakontrolluara të mбетjeve është kontribuesi kryesor i emetimeve të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht në mjedis me afro 40% të emetimeve. Vërehet një pakësim i kontributit të djegieve të pakontrolluara të mбетjeve në emetimin e NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht krahasuar me raportimin e parë në vitin 2006, nga 73.54% në 40% për shkak të masave të marra vitet e fundit në lidhje me menaxhimin e mбетjeve në vendin tonë. Këtu futen të gjitha kategoritë e djegieve të pakontrolluara ose djegiet në mjedis të hapur si djegia e mбетjeve urbane, djegiet e mбетjeve të automjeteve (si p.sh., gomave), djegiet nga aksidente të ndryshme të objekteve, mallrave, makinave etj., si dhe djegiet e mбетjeve bujqësore dhe pyjore.

Djegia e mбетjeve në impiante djegie ose incenerator është gjithashtu një burim i emetimit në mjedis të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht me afro 13%, këtu vendin kryesor e zënë djegia e mбетjeve spitalore.

Emetimi kryesor i NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht në ajër është afro 53%, pjesa tjetër e emetimeve është pjesë e mбетjeve të prodhuara me afro 20% dhe emetime në tokë dhe në produkte ose mallrat e prodhuara me afro 12-13%. Ndërsa emetimet në ujë rezultojnë në sasi të vogla.

Burimet kryesore të dioksinave dhe furaneve janë proceset e djegies së mбетjeve urbane, disa procese të teknologjisë, të metalurgjisë, si sintetizimi, industria e sintezës së lëndëve organike dhe e lëndëve plastike. Në vendet e zhvilluara djegia e mбетjeve lejohet të bëhet vetëm në impiante djegie të posaçme. Aty djegia e mбетjeve bëhet në një temperaturë shumë të lartë, në mënyrë që përbërjet organike të shkatërrohen sa më thellë. Dioksinat dhe furanet janë të qëndrueshme në temperaturat 600 deri në 800°C.

Në këtë kontekst, djegia e hapur e mбетjeve urbane sidomos atyre plastike, që ndodh në jo pak raste në vendin tonë është një burim i ndotjes së mjedisit me dioksina dhe furane të cilat përbëjnë një rrezik potencial për jetën e banorëve të zonave përreth, por edhe më gjerë. Kështu, eliminimi i djegies në mjedise të hapura të mбетjeve është domosdoshmëri për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njerëzve nga emetimi në mjedis i dioksinave dhe furaneve.

Përfundime dhe rekomandime

- Djegiet e pakontrolluara të mбетjeve janë kontribuesi kryesor i emetimeve të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht në mjedis.

- Djegia e mбетjeve në impiante djegie ose incenerator është gjithashtu një burim i emetimit në mjedis të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht, këtu vendin kryesor e zënë djegia e mбетjeve spitalore.

- Marrja e masave për kontrollin e djegieve të pakontrolluara të mбетjeve urbane dhe djegieve të mбетjeve spitalore është i domosdoshëm për të reduktuar/eliminuar emetimin e NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht në mjedis dhe efektet negative që shkaktojnë në shëndetin e banorëve.



2.3.5 Difenil eteret e polibromuara (PBDEs): hekzaBDE, heptaBDE, tetraBDE dhe pentaBDE

Difenil eteret e polibromuara ose polibrom difenil eteret (PBDEs) janë një grup komponimesh organike aromatike të bromuara (figura 4), të cilat janë përdorur që në vitin 1970 si shtesa në shumë produkte konsumi. PBDEs u prodhuan me tri shkallë të ndryshme bromimi dhe u cilësuan si c-Penta-, c-Okta- dhe c-Deka-BDE.

Këto kimikate janë përdorur gjerësisht në shumë sektorë industrialë për prodhimin e një numri të madh produktesh dhe artikujsh. Për shembull NOQ-PBDEs janë përdorur në industrinë elektronike për prodhimin skeletëve plastikë të pajisjeve kompjuterike dhe në industrinë e transportit për prodhimin e mbushjeve në automjete.

PoliBrom difenil eteret sikurse të gjithë Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (NOQ) zotërojnë veti toksike, i rezistojnë degradimit dhe kanë veti që të bioakumulohen. Ato transportohen nëpër vende të ndryshme me anë të ajrit, ujit dhe specieve që migrojnë duke i depozituar ato shumë larg vendit të origjinës, ku më pas grumbullohen në ekosistemet tokësore dhe ato ujore.

PoliBrom difenil eteret që paraqesin më shumë interes janë:

-  c-pentaBDEs (tetrabrom difenil eter, pentabrom difenil eter)
-  c-OktaBDEs (hekza bromdifenil eter; heptabrom difenil eter; oktabrom difenil eter dhe nanobrom difenil eter)




Figura 4. Struktura e polibrom difenil etereve (PBDEs)

Sektorët kryesorë të përdorimit të NOQ-PBDEs janë ai i prodhimit të pajisjeve elektrike dhe elektronike, si dhe sektori i transportit.

Metodologjia e inventarit të NOQ-PBDE-ve

Metodologjia e inventarit të NOQ-PBDEs në mallra dhe produkte të ndryshme, si dhe mbetjet e tyre bazohet në udhëzuesin për inventarin e PBDEs që listohen në Konventën e Stokholmit si NOQ (UNEP 2014). Grupet e mallrave që mund të përmbajnë NOQ-PBDEs janë pajisjet elektrike dhe elektronike dhe mjetet e transportit. Kështu, inventari realizohet mbi gjendjen e mundshme të NOQ-PBDE-ve në këto mallra dhe produkte.

Metodologjia e inventarit të NOQ-PBDEs për pajisjet elektrike dhe elektronike, si dhe mbetjet e tyre

Pajisjet elektrike dhe elektronike janë nga flukset e mallrave që rritet më shpejt, si dhe krijojnë një fluks të madh mbetjesh dhe riciklimesh. Këto materiale përmbajnë një sasi të madhe të c-OktaBDE. Një inventarizim i pajisjeve elektrike dhe elektronike, si dhe i mbetjeve të tyre është një hap i rëndësishëm për menaxhimin e materialeve që përmbajnë OctaBDE kryesisht c-OktaBDE (hekza-; hepta-; okta- dhe nona- BDE).

Përmbajtja e NOQ-PBDEs në monitorët e TV-ve dhe kompjuterëve do të llogaritet duke marrë në konsideratë të dhënat e mëposhtme:

- Popullsinë e vendit
- Peshë e monitorëve: **25 kg** për pajisje (peshë mesatare TV ose kompjuter)
- Përmbajtja e polimerit në veshjen CTR: **30%**
- Kufiri i përmbajtjes së c-OktaBDE, **0.87–2.54 kg/tonë** për polimerët e përdorur në veshjet CRT.

Një kufi i c-oktaBDE në pajisjet CRT llogaritet në këtë mënyrë:

$$M_{PBDE(0)} = [Nr \text{ i CRTs/frymë}] \times \text{popullsinë} \times 25 \text{ kg} \times 0.3 \times [0.00087 - 0.00254] \text{ (ek.1)}$$

Ku:

$M_{PBDE(0)}$ sasia e NOQ-PBDEs në kg

Për inventarizimin e sasive të NOQ-PBDEs dhe kryesisht të c-oktaBDEs, si dhe për lehtësi studimi do t'u referohemi katër kategorive kryesore të pajisjeve elektrike dhe elektronike (sipas legjislacionit në fuqi për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike). Inventarizimi do të mbështetet në tre hapa kryesorë:

a) Përcaktimi i POP-PBDEs në pajisjet elektrike dhe elektronike të importuara

Ky përcaktim bëhet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$M_{c\text{-OktaBDE}i\text{importuar } EEE(0)} = M_{EEE(0)i\text{importuar}} \times f_{EEE(0)i\text{shpërndarjes}} \times f_{\text{Polimer}} \times C_{c\text{-OktaBDE}i\text{Polimer}} \text{ (ek.2)}$$

ku:

- $M_{c\text{-OktaBDE}i\text{importuar } EEE(0)}$ është sasia e c-OktaBDE në pajisjet elektronike dhe elektrike të importuara në [kg]
- $M_{EEE(0)i\text{importuar}}$ është sasia e pajisjeve elektronike dhe elektrike të importuara (të reja dhe egzistuese) në një vit në ton

- $f_{EEE(0)i\text{shpërndarjes}}$ është shpërndarja e pajisjeve elektrike dhe elektronike përmes importueve në [% në peshë]
- f_{Polimer} është sasia e përgjithshme e fraksionit të polimerit që ndodhet në pajisjen elektronike dhe elektrike
- $C_{c\text{-OktaBDE}i\text{Polimer}}$ është sasia e c-OktaBDE në fraksionin e përgjithshëm të polimerit në pajisjen elektronike dhe elektrike në [kg/t]

b) Përcaktimi i NOQ-PBDEs në pajisjet elektrike dhe elektronike në përdorim/shitje

Një përcaktim i tillë bëhet sipas formulës:

$$M_{c\text{-OktaBDE}i\text{EEE}(0)} = M_{EEE(0)i\text{stok}} \times f_{\text{Polimer}} \times C_{c\text{-OktaBDE}i\text{Polimer}} \text{ (ek.3)}$$

Ku:

- $M_{c\text{-OktaBDE}i\text{importuar } EEE(0)}$ është sasia e c-OktaBDE në pajisjet elektronike dhe elektrike të në shitje dhe përdorim në [kg]

- $M_{WEEE(0)stok}$ është sasia e pajisjeve elektronike dhe elektrike të mbetura stok (të reja dhe ekzistuese) në një vit në ton

- $f_{Polimer}$ është sasia e përgjithshme e fraksionit të polimerit që ndodhet në pajisjen elektronike dhe elektrike
- $C_{OctaBDE;Polimer}$ është sasia e c-OktaBDE në fraksionin e përgjithshëm të polimerit në pajisjen elektronike dhe elektrike në [kg/t]

c) Përcaktimi i sasisë së POP-PBDEs në mbetjet e pajisjeve elektronike dhe elektrike

Përcaktimi bëhet sipas formulës:

$$M_{c-OctaBDE;WEEE(0)} = M_{WEEE(0)} \times f_{Polimer} \times C_{c-OctaBDE;Polimer} \quad (ek.4)$$

ku:

- $M_{c-OctaBDE;WEEE(0)}$ është sasia e c-OktaBDE në Mbjetet e Pajisjeve Elektrike dhe Elektronike në [kg]

- $M_{WEEE(0)}$ është sasia e mbetjeve në një vit [në tonë]

- $f_{Polimer}$ është sasia e përgjithshme e fraksionit të polimerit që ndodhet në pajisjen eletronike dhe elektrike

- $C_{OctaBDE;Polimer}$ është sasia e c-OktaBDE në fraksionin e përgjithshëm të polimerit në pajisjen eletronike dhe elektrike në [kg/t]

Bazuar në të dhënat e marra, si dhe në ekuacionet 2, 3 dhe 4 ne mund të përcaktojmë sasinë e c-OktaBDEs në pajisjet elektrike, elektronike dhe mbetjet e tyre.

Metodologjia e inventarit të NOQ-PBDEs në sektorin e transportit

Spektori i transportit (makinat, trailerat, autobusët, trenat, avionët dhe anijet) është një nga sektorët me materiale më të shumta mallrash i cili kohët e fundit përbën dhe rrjedhën më të madhe të mbetjeve dhe riciklimeve.

Një sasi e madhe e përdorimit të c-PentaBDE ka qenë përdorur në këtë sektor; përdorimi kryesor ka qenë për trajtimin e shkumave fleksible PUR (ndenjëset, sistemet menaxhese akustike, tavani i makinës etj.) dhe një sasi shumë e vogël në veshjet e ndenjësve.

Makinat dhe mjetet e tjera përmbajnë sasinë më të madhe NOQ-PBDEs. Prandaj dhe metodologjia që do të përdorim fokusohet në këto mjete.

Për vlerësimin e sasisë NOQ-PBDEs të gjeneruar nga sektori i transportit u përdorën këto të dhëna:

- Numri i mjeteve të regjistruara që ndodhen në përdorim dhe në shitje
- Viti i prodhimit
- Numrin e makinave që kanë dalë jashtë përdorimit (të çregjistruara)
- Sasinë e makinave që shkon për skrap.

Në rastin përcaktimit të sasisë NOQ-PBDEs që gjenerohen nga sektori i transportit përdoret një formulë e përgjithshme për të gjitha zërat e paraqitur si vijon:

$$Sasia\ e\ NOQ-PBDE_{Skategori\ mjeti} = Numri\ i\ mjeteve_{kategorit} \times POP-PBDE_{Skategori} \times F_{rajonal} \quad (ek. 5)$$

Ku:

- Numri i mjeteve $_{kategorit}$ për kategori të prodhuara para viteve 2005 dhe pas viteve 2005;
- $NOQ-PBDE_{Skategori}$ është sasia e NOQ-PBDE që ndodhet në një mjet të vetëm (160g për autovaturat, trajlerat, makineritë bujqësore; 1kg për autobusët);

- $F_{rajonal}$ është faktor rajonal për mjetet ($F_{rajonal} = 0.5$ për mjetet që janë prodhuar para 2005; $F_{rajonal} = 0.05$ për mjetet e prodhuara pas 2005).

Nisur nga të dhënat e marra dhe ek.5 përllogarisim sasinë e NOQ-PBDEs që vjen nga sektori i transportit.

Inventarizimi i NOQ-PBDE-ve për pajisjet elektrike dhe elektronike, si dhe mbetjet e tyre

Bazuar në të dhënat e marra dhe metodologjinë e prezantuar më lart mbi inventarin e PBDEs po paraqesim rezultatet e arritura. Fokusi kryesor i pajisjeve elektronike ka qenë sidomos tek elektroshtëpiaket, si: televizorë, frigoriferë, lavatriçe etj., si dhe te kompjuterët, pasi këto materiale përmbajnë një sasi të madhe të c-OktaBDE.

a) Inventarizimi paraprak i NOQ-PBDE-ve

Për inventarizimin paraprak të NOQ-PBDEs që vijnë nga pajisjet elektrike dhe elektronike, si dhe nga mbetjet e tyre bazohemi në përcaktimin minimal të sasisë së NOQ-PBDEs që ndodhet në televizorët dhe monitorët e kompjuterëve dhe numrin e përdorimit të tyre për frymë.

Duke përdorur formulën:

$$M_{PBDE(0)} = [nr. i CRTs/frymë] \times popullatën \times 25\ kg \times 0.3 \times [0.00087 - 0.00254]$$

është llogaritur sasia totale e NOQ-PBDEs që vijnë nga pajisjet elektrike dhe elektronike si vijon:

$$M_{PBDE(0)} = 0.08 \times 2\ 893\ 005 \times 25\ kg \times 0.3 \times 0.0017 = \mathbf{2951\ kg}$$

Mbi bazën e sasisë totale të NOQ-PBDEs janë llogaritur përbërësit kryesor sipas % që zënë ndaj

totalit, këto të dhëna pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 10. Inventari fillestar i PBDE-ve te monitorët dhe TV-CRT

Homologët	Shpërndarja e homologeve të c-OctaBDE	Total c-OctaBDE (Kg)
HexaBDE	11%	324.61
HeptaBDE	43%	1263.93
c-OctaBDE**	35%	2194.85
NonaBDE**	10%	295.10
DecaBDE**	1%	29.51
Shuma		2951.00

b) Inventari i detajuar i sasisë së NOQ-PBDEs

Për inventarizimin e detajuar të sasive të NOQ-PBDEs dhe kryesisht të c-OktabDEs, si dhe për lehtësi studimi i referohemi katër kategorive kryesore të pajisjeve elektrike dhe elektronike sipas legjislacionit në fuqi për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike. Kështu, inventarizimi mbështetet në tre hapa kryesorë:

- Llogaritjen e NOQ-PBDEs në pajisjet elektrike dhe elektronike të importuara;
- Llogaritjen e NOQ-PBDEs në pajisjet elektrike dhe elektronike në përdorim ose shitje;
- Llogaritjen e NOQ-PBDEs në mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Bazuar në të dhënat e marra për vitin 2014 dhe metodologjinë e cituar më lart po japim rezultatet e nxjerra mbi inventarin e detajuar të NOQ-PBDEs që vijnë nga pajisjet elektrike dhe elektronike dhe nga mbetjet e tyre, që prezantohen në tabelën në vijim.

Tabela 11. Përmbledhëse e inventarizimit të detajuar të PBDE-ve në pajisjet elektrike dhe elektronike (PEE) për vitin 2014

Homologët	Shpërndarja e homologëve të c-OctaBDE (%)	PBDEs në PEE të importuara (kg)	PBDEs në PEE në përdorim/shitje (kg)	PBDEs në PEE si mbetje (kg)	Totali (kg)
HexaBDE	11%	0.35	219.89	14.11	234.35
HeptaBDE	43%	1.38	859.57	55.15	916.10
c-OctaBDE	35%	1.13	699.65	44.89	745.66
NonaBDE	10%	0.32	199.90	12.83	213.05
DekaBDE	1%	0.03	19.99	1.28	21.30
Shuma		3.22	1999	128.25	2130.47

**Janë shuma të llogaritura në bazë të formulave dhe të dhënave të grumbulluara.*

Rezultatet tregojnë se në inventarizimin e PBDE-ve mund të përdoren edhe të dhënat e inventarit paraprak, por më të sakta janë të dhënat e inventarit të detajuar të prezantuar më lart.

Të dhënat e inventarit tregojnë se një sasi prej 2130 kg PBDEs në pajisjet elektrike dhe elektronike dhe sasia kryesore prej afro 1999 kg gjendet në pajisjet elektrike dhe elektronike të përdorura ose shitura. Sikurse vihet re nga tabela përmbledhëse sasia e NOQ-PBDEs që kalon si mbetje është më e lartë (**128.25 kg**) sesa sasia e NOQ-PBDEs që hyn gjatë importimit (**3.22 kg**). Një nga arsyt është zëvendësimi i monitorëve të kompjuterëve dhe televizorëve CRT me monitorë që kanë peshë më të vogël, si dhe përmbajtje të c-OctaBDE më të ulët respektivisht për monitorët e sheshtë të kompjuterëve kjo vlerë është 0.225kg/t ndërkohë që për monitorët CRT të kompjuterëve përmbajtja e c-oktaBDE është 2. 54 kg/t (afërsisht 10 herë më e lartë).

Inventari i NOQ-PBDEs në sektorin e transportit

Përmbajtja e NOQ-PBDEs vërehet edhe në mjetet e sektorit të transportit (makinat, trailerat, autobusët, trenat, avionët dhe anijet) i cili është një nga sektorët me materiale më të shumta mallrash, i cili kohët e fundit përbën dhe rrjedhën më të madhe të mbetjeve dhe riciklimeve.

Një sasi e madhe e përdorimit të c-pentaBDE ka qenë përdorur në këtë sektor; përdorimi kryesor ka

qenë për trajtimin e shkumave fleksible PUR (ndenjëset, sistemet menaxhese akustike, tavani i makinës etj.) dhe një sasi shumë e vogël në veshjet e ndenjësve. Makinat dhe mjetet e tjera përmbajnë sasinë më të madhe të NOQ-PBDEs. Prandaj dhe metodologjia që do të përdorim fokusohet në këto mjete.

Bazuar në metodologjinë e përsëritur në mënyrë të detajuar dhe të dhënave mbi numrin e automjeteve në vendin tonë (sipas INSTAT-it) po japim rezultat e llogaritjeve të inventarit të NOQ-PBDE-ve që vijnë nga sektori i transportit (tabelat 12 dhe 13).

Tabela 12. Inventari i PBDE-ve sipas automjeteve të transportit dhe vitit të prodhimit.

Emërtimi	Mjetet e regjistruara/përdorim				Mjetet e çregjistruara/varreza			
	Prodhimi para 2005	Sasia e PBDEs (kg)	Prodhimi 2005 e në vazhdim	Sasia e PBDEs (kg)	Viti i prodhimit para 2005	Sasia e PBDEs (kg)	Prodhimi 2005 e në vazhdim	Sasia e PBDEs (kg)
*Kategoria I	310062	24805	154866	124	58436	4675	5905	5
**Kategoria II	544	272	605	3	136	68	3	-
TOTALI	310606	25077	155471	127	58572	4743	5908	5

*Kategoria I përmbledh të gjitha automjetet me përjashtim të autobusëve

**Kategoria II përmbledh autobusët

Tabela 13. Sasia e NOQ-PBDEs të pranishme në sektorin e transportit

	Shpërndarja e homologëve të c-pentaBDE (%)	NOQ-PBDEs të mjetet në përdorim aktual	NOQ-PBDEs të mjetet e çregjistruara (ose në varreza)	Sasia e përgjithshme e c-PentaBDE
NOQ-PBDEs të inventarizuara		Σ PentaBDE (kg)	Σ PentaBDE (kg)	Σ PentaBDE (kg)
tetraBDE	33%	8317.3	1566.8	9884.2
pentaBDE	58%	14618.3	2753.8	17372.2
hexaBDE	8%	2016.3	379.8	2396.2
heptaBDE	0.5%	126.0	23.7	149.8
Të tjera	0.5%	126.0	23.7	149.8
TOTALI		25204	4748	29952

Të dhënat e inventarit tregojnë që një sasi prej afro 28,952 kg PBDEs gjendet në makineritë e transportit dhe sasia më e madhe e NOQ-PBDEs vjen nga makinat e prodhuara para vitit 2005 (afërsisht 25,077 kg) në krahasim me makinat e prodhuar pas vitit 2005 (127 kg). Kjo është e kuptueshme pasi numri i makinave të importuara në vendin tonë të cilat kanë vit prodhimi 2005 e në vazhdim është shumë më i ulët sesa numri i makinave të importuara që kanë vit prodhimi para 2005. Pavarësisht kësaj ajo që vihet re për mjetet motorike të reja fraksioni rajonal i tyre është 10 herë më i ulët se faktori rajonal i makinave që kanë vitit prodhimi para 2005 vlera të cilat janë 0.5 dhe 0.05 për makinat e vjetra dhe të reja respektivisht.

Përfundime dhe rekomandime

- Burimet kryesore për emetimin në mjedis të NOQ-PBDEs janë pajisjet elektrike dhe elektronike të vjetra ose kryesisht kompjuterët dhe televizorët CRT, si dhe automjetet e transportit të prodhuara para vitit 2005, pasi këto mallra kanë përmbajtje më të lartë të komponimeve të PBDEs.

- Reduktimi i përdorimit të kompjuterëve dhe televizorëve CRT dhe automjeteve të prodhuara para 2005 është i domosdoshëm për të reduktuar/eliminuar emetimin e NOQ-PBDEs në mjedis.

2.3.6 Acidi perfluoroktan sulfonik (PFOS), kripërat e tij dhe fluori i perfluoroktan sulfonilit (PFOF)

Acidi perfluoroktan sulfonik është një anion i cili është plotësisht i fluorinuar dhe zakonisht përdoret në trajtën e kripërave në aplikacione të ndryshme ose i ndërfutur në polimerët e klasave të larta. Qëllimi i listimit në Konventën e Stokholmit të këtij acidi, kripërave të tij dhe komponimeve të tjera që lidhen me të është kufizimi i përdorimit dhe prodhimit të PFOS-së dhe substancave që lidhen me të. Termi “substancë që lidhen me PFOS” është përdorur për të gjitha substancat që përmbajnë një ose disa grupe PFOS (të identifikuar si C₈F₁₇SO₂) të cilat supozohen që në mjedis të zërthehen në PFOS.

Substancat që lidhen me PFOS-të i referohen një grupi të madh substancash të cilat përmbajnë për- dhe sulfate të polifluorinuara me një gjatësi vargu prej tetë karbonesh, të cilat mund të jenë kripëra të thjeshta të PFOS-ve (p.sh.: kalium, litium, amonium, dietanaminë) ose polimere që përmbajnë PFOS. Figura si në vijim ilustron formulën strukturore të PFOS-ve (UNEP, 2002).




Figura 5. Formula strukturore e PFOS

Pjesa kryesore e derivateve të PFOS-ve janë polimerët me peshë molekulare të lartë në të cilët PFOS-ja është vetëm një fraksion i polimerit dhe produktit final. PFOS, kripërat e tij dhe PFOSF i përkasin grupit të kimikateve të quajtura komponime të perfluorinuara (PFC; perfluorinated compounds). Konventa e Stokholmit i cilëson PFOS si tepër rezistente dhe me veti bioakomuluese, megjithëse ato nuk ndjekin modelin klasik të NOQ-të të tjerë, të cilët vendosen në indet dhjamorë; PFOS-të lidhen me proteinat në gjak dhe në mëlçi. Ato kanë aftësi që të transportohen në largësi të mëdha dhe të plotësojnë kriterin e toksicitetit të vendosur nga Konventa e Stokholmit. PFOS-ja dhe derivatet e tij mund të çlirohen në mjedis nga proceset industriale dhe gjatë përdorimit të tyre në aplikimet industriale dhe ato të përditshme.

Inventari i PFOS-ve

Inventarizimi i PFOS-ve sikurse dhe inventarizimi i PBDE-ve bazohet në udhëzuesin e UNEP-it “Udhëzues për inventarin e Acidi Perfluoroktan Sulfonik (PFOS) dhe kimikateve të lidhura më të që janë listuar në Konventën e Stokholmit si Ndotës Organikë të Qëndrueshëm” (UNEP 2012).

Objekti kryesor i inventarit të PFOS-ve është marrja e të dhënave të nevojshme për plotësimin e detyrimeve sipas Konventës së Stokholmit dhe për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit Inventari realizohet shkallë-shkallë, nëpërmjet hapave që përfshijë planin e punës: 1. Përzgjedhja e metodologjisë; 2. Mbledhja dhe grumbullimi i të dhënave; 3. Përpunimi i të dhënave; 4. Dhe përgatitja e raportit përfundimtar.

PFOS-ja dhe kripërat e tij kanë përdorim në disa sektorë. Për inventarizimin e tyre së pari përcaktojmë burimet ku këto komponime janë të pranishme dhe të dhënat e grumbulluara përdoren për të llogaritur sasinë e PFOS-së. Sasia e përgjithshme e PFOS-së (dhe derivateve të saj) përcaktohet me anë të formulës:

$$T_c = L \times C \quad (\text{ek.1})$$

Ku:

T_c = Sasia e përgjithshme e PFOS-ve të përdorur në procese industriale

L = Përqendrimi në ppm ose në % i PFOS-ve në përbërësit kimikë

C = konsumimi vjetor i përbërësve kimikë

E njëjta formulë do të përdoret dhe për përcaktimin e sasisë totale të PFOS-ve (dhe substancave që përmbajnë qoftë dhe një grup anioni të kësaj substance).

Sasia totale e PFOS-së e përdorur në prodhimin e artikujve si mobilie, këpucë dhe rroba do të përcaktohet nga përqendrimet e PFOS-ve në materialin e përdorur gjatë prodhimit të artikujve. Formula që do të përdoret:

$$T_s = A \times W \times S \quad (\text{ek.2})$$

Ku:

T_s = Sasia e përgjithshme e PFOS-ve në artikuj ose produkte të shitura në treg për një vit

A = Sasia e PFOS-ve e aplikuar në material ose fibër (në peshë ose %)

W = pasha e materialit në një artikull, pesha e fibrës ose produktit

S = numri mesatar i artikujve ose produkteve të shitura në treg/vit.

Inventarizimi i acidit perfluoroktan sulfonik dhe substancave që lidhen me të, u përqendrua kryesisht te materialet që përmbajnë këtë komponim dhe që përdoren në mjediset shtëpiake dhe industri. Në vendin tonë nuk janë përdorur kripërat e acidit perfluoroktan sulfonik si pesticide sipas të dhënave të Ministrisë përgjegjëse për Bujqësinë, kështu që këtu nuk prezantohen vlera të përdorimit si pesticid.

Përcaktimi i sasisë së përgjithshme të PFOS-së së përdorur në proceset industriale gjatë përdorimit të përbërësve kimikë, lëngjeve të ndryshëm që e përmbajnë atë apo dhe formulimet kimike sikurse janë formulimet e tekstileve, jepet më lart te metodologjia.

Bazuar në metodologjinë e mësipërme dhe të dhënat e përafërta të sasisë së mallrave që përdoren në një vit në vendin tonë dhe që përmbajnë PFOS kemi llogaritur sasi të minimale dhe maksimale të PFOS-ve në vit, këto të dhëna jepen në tabelën në vijim.

Tabela 14. Sasia e acidit perfluoroktan sulfonik (PFOS) dhe substancave që lidhen me të

Nr.	Kategoria e mallrave	Konsumimi i përafërt vjetor Kg/vit	Sasia PFOS (mg /kg artikull)*	Sasia e PFOS (kg/vit) (min dhe max)
1	Lëngje (vajra) hidraulike në fushën e aviacionit	10000	500-1000	5 -10
2	Shkuma kundër zjarrit	10000	500-1500	5-15
3	Letra (mbulesa) tavoline, karton dhe ambalazhe	1000000	500-5000	500-5000
4	Veshje muri (letër)	25000	500-5000	12.5-125
5	Tapetë sintetikë	500000	500-5000	250-2500
6	Lëkurë (përfshi dhe çanta, këpucë etj)	300000	500-5000	150-1500
7	Tekstile dhe tapiceri	400000	500-5000	200-2000
8	Detergjente	5000000	50-100	250 -500
10	Produkte për pastrim shtëpie	1000000	50-100**	50-100
11	Bojëra dhe toner printeri/fotokopje	100000	100	100
12	Llak	200000	50-100	1-2
13	Bojëra	60000000	50-100	300 -600
14	Ngjitës (adhesive)	5000	50-100**	0.25- 0.5
16	Gjeneratorë fotoacidë	150000	200-1000	30-150
17	Substanca fotorezistente	50000	200-1000	10-50
18	Shuma			1863.75-12552.5

*mg/kg = ppm

**PFOS BAT/BEP Guidelines (Secretariat of the Stockholm Convention, 2012)

Sikurse shikohet nga tabela e mësipërme sasia e PFOS-ve varion nga 1863.75 kg/vit deri në 12552.5kg/vit ose ndryshe sasia mesatare e PFOS-ve që ekspozohet 7208kg/vit. Burim kryesor ndotje janë përdorimi i letrave të kuzhinës, kartonëve dhe ambalazheve të ndryshme që varion nga 500 kg/vit deri në 5000kg/vit, e ndjekur kjo nga tapetet sintetike; tekstilet dhe tapiceritë dhe përdorimi i lëkurës me kufij nga 250–2500kg/vit; 200–2000kg/vit dhe 150–1500kg/vit respektivisht. Burime ndotëse me potencial më të ulët janë ngjitësit dhe llaku që variojnë në kufij 0.25–0.5kg/vit për ngjitësit dhe 1–2 kg/vit për llaqet këto të fundit të ndjekura nga lëngjet (vajrat) hidraulike që përdoren në fushën e aviacionit dhe nga shkumat kundër zjarrit përkatësisht me 5–10kg/vit për fluidët dhe 5–15kg/vit për shkumat kundër zjarrit.

Përfundime dhe rekomandime

- Burimet kryesore të emetimit në mjedis në vendin tonë të acidit perfluoroktan sulfonik (PFOS) dhe substancave që lidhen me të janë kartonët, ambalazhet dhe letrat e plastifikuara, produktet e lëkurës dhe lëngjet hidraulike etj., ndërsa ky komponim nuk ka pasur përdorim si pesticid.

- Kontrolli i cilësisë së produkteve që mund të përmbajnë PFOS është i rëndësishëm për të reduktuar/eliminuar emetimin në mjedis dhe efektet negative të mundshme në shëndet të NOQ-PFOS dhe substancave që lidhen me të.

2.3.7 Hekzabromciklododekan (HBCD)

Hekzabromciklododekani (HBCD) është shtuar në listën së substancave të dëmshme në maj të 2013-s. Si të gjithë ndotësit e tjerë organikë të qëndrueshëm kjo substancë shfaq veti toksike, rezistent ndaj degradimit dhe është i bioakumulueshëm. Transportohet përmes ajrit, ujit dhe specieve migruese në vende të cilat ndodhen larg vendit ku ato çlirohen dhe më pas akumulohen në ekosistemet tokësore dhe ujore. Hekzabromciklododekani ka një strukturë ciklike në të cilën janë të vendosura atomet e bromit (shiko figurën 6). HBCD-ja është lipofilik, me tretshmëri të ulët në ujë dhe ka afinitet të lartë për grimcat e ngurta. Formula kimike e komponentit është C₁₂H₁₈Br₆ dhe peshë molekulare 641 g/mol. Zakonisht ka tre stereoisomerë të cilët konsistojnë në 70–95% γ-HBCD dhe 3–30% α- dhe β-HBCD, ndërsa në teori mund të formohen 16 stereoisomerë.




Figura 6. Formula strukturore e HBCD

Aplikimi kryesor i HBCD-së është në shkumat polistirene që përdoren për izolim të cilat përdoren gjerësisht për ndërtime dhe konstruksione. Izolimi me këta tipa shkumash mund të gjendet dhe në mjetet e transportit dhe argjinaturat e rrugëve dhe hekurudhave. Këto shkuma polistirene gjenden në dy forma dhe përmbajnë 0.7 deri 3%.

Aplikimi i dytë më i rëndësishëm është në mbulesat tekstile ku HBCD-të ndodhet në përqendrim 2.2–4.3%.

Një aplikim tjetër, por më i vogël është në pajisjet elektrike dhe elektronike në të cilat përqendrimi i HBCD-ve varion nga 1–7%.

Inventarizimi i heksabromociklodo-decanit (HBCD)

Inventarizimi i HBCD-ve në nivel kombëtar sikurse në të gjitha rastet e inventarizimit të ndotësve organikë të qëndrueshëm bazuar në udhëzuesin e UNEP-it për inventarin e HBCD-ve (2015), realizohet nëpërmjet pesë hapave të cilat janë listuar më poshtë:

1. Planifikimi i inventarit (përzgjedhja e personave që do të kryejnë inventarizimin; identifikimi i aktorëve kryesorë; të përcaktohet qëllimi i inventarit dhe zhvillimi i planit të punës)
2. Përzgjedhja e metodologjisë (përfaqja eksperimentale);
3. Grumbullimi dhe hartimi i të dhënave nga sektorë kryesorë (pajisjet elektronike në përdorim dhe mbetjet elektronike që shkojnë në riciklim dhe ato që janë në magazina; sektori i transportit dhe mjetet e dala jashtëpërdorimit; përdorues të tjerë të tillë si mobilie, tekstile etj.);
4. Përpunimi dhe vlerësimi i të dhënave;
5. Përgatitja e raportit përfundimtar.

Inventari i HBCDs në polistirenet e zgjeruara (EPS-exclude polystyrene) dhe polistirenet e presuara (XPS-extrude polystyrene)

Polimeret e zgjeruara dhe ato të presuarat kanë qenë përdoruesit kryesorë të HBCD-ve në tregun kombëtar. Përdorimi i HBCD-ve në polimere varet nga aplikimi dhe rajoni. Në Evropën Perëndimore afërsisht 70% e polistireneve të zgjeruara janë me veprim inhibues ose ngadalësues të flakës, kurse në Evropën Lindore për këtë qëllim përdoret 99% e këtij tipi polistireni.

Polistirenet e bymyera (zgjeruara) dhe të presuarat në sektorin e ndërtimit

Përdorimi kryesor i HBCD-ve është në polistirenet e zgjeruara (EPS) dhe në ato të presuarat (XPS). Ka një numër të madh përdoruesish në sektorin e ndërtimit. Inventarizimi i HBCD-ve është i thjeshtë nëse identifikohen burimet e përdoruesve. Duke ditur sasinë në % të HBCD-ve që përdoren tek artikuj të ndryshme, si dhe sasinë që importohet apo janë në përdorim ne mund të llogarisim sasinë e HBCD-ve. P.sh., HBCD-të që ndodhet në EPS varion nga 0.5–0.7% në peshë, ndërsa HBCD-të që ndodhet në XPS varion nga 0.8–2.5% në peshë.

Përdorime të HBCD-ve në artikuj të ndryshëm

HBCD-ve janë përdorur në mobilie dhe në jastëkë. Shtrirja e këtij përdorimi akoma nuk është dokumentuar. Përdorime të tjera të polistireneve janë shtrirë dhe në materialet e paketimit.

Përdorimi i HBCD-ve në tekstilet e ndenjëset e transportit dhe tekstile të tjera

Tekstilet në transport përgjithësisht lidhen me tapiceritë dhe tekstile të tjera. Në pjesën më të madhe të aplikimit në sektorin e transportit ku siguria është qëllimi kryesor ekzistojnë rregulla kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat orientojnë sigurinë e tyre nga zjarri. Përdorimi i fikseve të zjarrit në makina apo materialeve të përdorura për ngadalësimin e flakëve ka treguar në një studim të kryer në UK përmbajtjen në nivele të larta të PBDE-ve në serum dhe gjakut të njerëzve, si dhe një ekspozim të lartë të HBCDs në pluhurin e makinës. Një përdorim të gjerë të tekstileve që kanë përmbajtje të lartë substancash që përmbajnë komponime që ngadalësojnë flakët e zjarrit janë përdorur në spitale, burgje, në aeroporte dhe hotele.

Inventari i heksabromociklododekan (HBCD)

Inventari i HBCD-ve përqendrohet në të dhënat e përdorimit të materialeve të ndërtimit dhe tekstileve ose mobilieve shtëpiake që janë dy sektorët kryesorë që përdorin material me përmbajtje të HBCD-së.

Ndërsa përmbajtja e HBCD-ve në pajisjet elektrike dhe elektronike dhe mbetjet e tyre, si dhe në materiale të tjera si bojëra, veshje etj., kanë një rëndësi shumë të vogël pasi dhe përmbajtja e HBCD-së në këto materiale është shumë e ulët dhe nuk do të jepen llogaritje të këtyre vlerave për shkak të rëndësisë së ulët.

Inventari i HBCD-ve në sektorin e ndërtimit

Materiale izoluese përdoren gjerësisht në sektorin e ndërtimit por në këto materiale ka përmbajtje të HBCD-ve. Përqindja e HBCD-ve në polistirenet e zgjeruara (EPS) varion nga 0.5–0.7% dhe në ato të presuarat (XPS) varion nga 0.8–2.5%. Sasia e HBCD-së që vjen nga EPS-ja dhe XPS-ja është e vështirë që të llogaritet në mënyrë të ndarë pasi si EPS-ja ashtu dhe XPS-ja që të dyja ndodhen në konstruksionet e ndërtimit dhe zënë rreth 97% të shkumave, izoluesve të ndryshëm etj. Në rastin tonë marrim si llogaritje të HBCD-së në polistirenet e zgjeruara (EPS) dhe në ato të presuarat (XPS) një vlerë mesatare të tyre 1.1%.

Duke pasur parasysh përqindjet e mësipërme, si dhe peshën që zë EPS-ja dhe XPS-ja në sektorin e ndërtimit, vlerësojmë sasinë e HBCD-ve nga sektori i ndërtimit, të dhëna të cilat i kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 15. Përdorimi i HBCD-ve në EPS/XPS në sektorin e ndërtimit

Nr.	Emërtimi i burimit	Sasia e importuar (ton)	Në përdorim / shitje				Mbetje që shkojnë në landfill/ riciklim (ton)	HBCD në EPS/XPS (kg)
			Konsumatori (ton)	Biznesi (ton)	Institucione shtetërore (ton)			
1	Shkuma për izolimin e tavaneve	500	350	100	50	5	5500	
2	EPS për izolimin e çatave të pjerrëta	20	10	5	5	0.5	220	
3	Izolimi i dyshemeve	100	50	40	10	2	1100	
4	Polistirene për izolimin e mureve të brendshme	150	100	35	15	2.5	1650	
5	Polistirene për izolimin e mureve të jashtme	150	100	35	15	2.5	1650	
6	Izolues zhurmash	20	5	14	1	1	220	
7	Materiale paketimi me përmbajtje shkume PS	50	30	15	5	0.5	550	
8	Panele të përbëra dhe laminate	100	50	40	10	1	1100	
9	TOTALI	1090	695	284	111	15	11990	

Inventari i HBCD-ve në tekstile

Sektori i dytë i rëndësishëm i përdorimit të materialeve që përmbajnë HCB është industria e tekstileve, ku shpesh artikuj të ndryshëm kanë përmbajtje polisterne në % të ndryshme. Në këto materiale përmbahen edhe HBCD në % që varion nga 2.2 deri në 15%, sipas materialit dhe % së polistirneve në këto tekstile. Nisur nga sasia e përafërt e materialeve të tekstileve në vendin tonë dhe përmbajtjes mesatare të HBCD-ve në këto materiale janë llogaritur përmbajtjet e HBCD-ve, të cilat jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 16. Përdorimi i HBCD-ve në artikuj të ndryshëm

Nr.	Emërtimi i burimit	Sasia e materialeve (ton)	Përmbajtja e HBCDs (%)	Sasia totale e HBCDs (kg)
-----	--------------------	------------------------------	------------------------	------------------------------

1	Tekstile të përdorura në tapiceritë e mjeteve	800	3%	24000
2	Tekstile të përdorura në mobiliet shtëpiake	1200	3%	36000
3	Jastëkë	150	2%	3000
4	Dyshekë	550	2%	11000
5	Tekstile të përdorura në grila	5	3%	150
6	Uniforma zjarrfikësish	1.5	8%	120
7	Uniforma ushtarake kundër zjarrit	1.5	8%	120
8	Materiale paketimi që përmbajnë polistiren	15	2%	300
9	Perde ose batanije tekstile me përmbajtje HBCDs që përdoren në shtëpi, burgje dhe spitale	75	3%	2250
10	TOTALI	2798		76940

Sikurse vihet re nga tabelat e mësipërme njerëzit janë të ekspozuar gjerësisht ndaj HBCD-ve. Ndotja më e madhe vjen nga tekstilet e përdorura në mobiliet shtëpiake. Madje duhet theksuar fakti se sasia e HBCD-ve që vjen nga tekstilet e mobilieve është më e lartë se sa sasia e përgjithshme e HBCD-ve që vjen nga sektori i ndërtimit përkatësisht **11990 kg** dhe **76940 kg** nga tekstilet e mobilieve të shtëpive. Kjo shpjegohet me faktin se përdorimi i materialeve izoluese në sektorin e ndërtimit është më e theksuar vitet e fundit pasi më parë pak janë përdorur. Sasia e lartë e HBCD-ve mund të jetë një rrezik potencial për shëndetin kryesisht të fëmijëve, pasi ata qëndrojnë për një kohë më të gjatë në kontakt me këta artikuj dhe në të shumtën e rasteve ata vendosin duart në gojë pa i larë ato paraprakisht.

Përfundime dhe rekomandime

- Ndotja më e madhe me HBCD vjen nga tekstilet e përdorura në mobiliet dhe mjediset shtëpiake dhe më pas nga sektori i ndërtimit.
- Përdorimi i materialeve izoluese në sektorin e ndërtimit duhet të jetë i kontrolluar për cilësinë e mallrave që përdoren sidomos në raport me përmbajtjen e HBCD-ve.
- Forcimi i kontrollit dhe vlerësimi i cilësisë së tekstileve dhe materialeve izoluese që mund të përmbajnë HBCD është i rëndësishëm për të reduktuar/eliminuar emetimin në mjedis të NOQ-HBCD, për të minimizuar efektet e HBCD-ve në shëndetin e fëmijëve dhe mbrojtjen e punëtorëve nga ekspozimi në punë i këtyre komponimeve në sektorin e ndërtimit. Kontrolli dhe monitorimi i vazhdueshëm i burimeve të emetimit në mjedis të NOQ-ve është i domosdoshëm për të ruajtur dhe vlerësuar ndikimin e HBCD-ve në mjedis, shëndetin e njeriut në përgjithësi, fëmijëve dhe punëtorëve në veçanti, pasi këto komponime janë të dëmshme për mjedisin dhe rrezikojnë shëndetin e njeriut.

2.3.8 Hekzabromobifenili (HBB)

Hekzabromobifenili (HBB) u listua si NOQ në aneksin A të Konventës së Stokholmit në vitin 2009, si një komponim për të cilin vendet anëtare janë të detyruara të ndalojnë prodhimin, përdorimin, importin dhe eksportin e tij. Por për shkak të prodhimit të tij në sasi shumë të vogla dhe përdorimit të kufizuar, si dhe ku shumica e materialeve që përmbanin HBB janë shkatërruar dekada më parë, sipas të dhënave të UNEP-it (2012), ky komponim nuk është subjekt i inventarit dhe planit të veprimit për vendin tonë.

2.3.9 NOQ-të e tjerë të rinj (hekszaklorobutadieni, pentaklorofenoli me kriperat dhe esteret e tij, naftalenet e poliklorinuara)

Disa komponime të tjera iu shtuan listës së NOQ-ve sipas Konventës së Stokholmit në maj 2015. Këto komponime kimike ishin:

1. Hekzaklorobutadieni (HCBT), i cili u listua në aneksin A të konventës pa ndonjë përjashtim specifik;
2. Pentaklorofenoli me kriperat dhe esteret e tij (PCP), i cili u listua në aneksin A të konventës, dhe
3. Naftalenet e poliklorinuara (PCNs), të cilat u listuan në aneksin A dhe C të konventës, me përjashtim specifik për përdorim vetëm për prodhimin e naftaleneve të polifluorinuara duke përfshirë edhe oktafluoronaftalenin.

Në vendin tonë këto komponime kimike nuk janë prodhuar për shkak të mungesës së industrisë kimike por ato janë ose mund të jenë importuar si produkte më vete ose si pjesë përbërëse e produkteve të tjera. Megjithatë, prodhimi i tyre ka ndaluar edhe në botë vite më parë, grupi i punës nuk mundi të gjente të dhëna rreth importit dhe përdorimit të tyre si komponime kimike. Kështu, bazuar në VKM-në nr. 360, datë 29.4.2015, lejohet deri më 1 korrik 2016, vendosja në treg dhe përdorimi i artikujve të prodhuar para ose deri më 1 korrik 2015 që përmbajnë në përbërje naftalene të poliklorinuara.

Megjithatë, një inventar dhe plan veprimi për këto si komponime të pastra ose në përbërje të artikujve të tjerë, duhet të planifikohet, veçanërisht për pentaklorofenolin me kriperat dhe esteret e tij (PCP), i cili është përdorur në të kaluarën në vendin tonë.

2.3.10 Mbetjet dhe vendet e ndotura me NOQs

Në këtë kuadër mund të citojmë dy pikat kryesore të listuar në planin e parë të veprimit për NOQ-të:

- Studimi i terrenit dhe zhvillimi i planeve rehabilituese për zonat potencialisht të ndotura me NOQ;
- Studime në terren, marrje kampionësh dhe analizimi i tyre, përcaktimi i përparësive, përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i kostos për projektet e rehabilitimit të zonave të ndotura.

Akoma këto dy pika nuk janë plotësisht të plotësuara dhe kërkojnë vëmendjen e institucioneve përkatëse dhe ministrisë përgjegjëse për mjedisin për t'u realizuar në vijimësi.

Disa nga hotspotet që duhet të studiohen dhe monitorohen të cilat lidhen me NOQ-të citohen dhe në Raportin për Gjendjen e Mjedisit 2014 të evidentuara nga Projekti i UNDP-it për "Identifikimin e zonave të ndotura me prioritet të Shqipërisë", dhe këto janë:

- Alba Film, Tiranë që ka kimikate të ndryshme toksike 50 kg në një sipërfaqe 2 ha;
- Ndërmarrja Tekstile, Berat që ka amonium 30 tonë dhe kimikate 126 kg në 0.6 ha;
- Magazina në Rrëshen që ka pesticide dhe permanganat 725 kg në një sipërfaqe 0.2 ha;
- Uzina e fosfateve – Laç që ka mbetje të kimikateve dhe sterileve në një sipërfaqe 38 ha;
- Magazina Bujqësore – Lushnjë që ka mbetje të pesticideve në një sipërfaqe 0.2 ha.
- Reparti i rigjenerimit të vajit dhe riparimit të transformatorëve në Tiranë.

Një shqetësim në vendin tonë për shkak të ndotjes me pesticide NOQs, përbën zona e ish-uzinës kimike dhe prodhimit të pesticideve në Portoromano Durrës. Deri në momentin që u mbyll në vitin 1990 aty prodhoheshin pesticide klororganik si lindan (γ -HCH), tiram etj. Për shkak të derdhjeve dhe mbetjeve të ruajtura jo në kushte normale, u shkaktua një ndotje e zonës përreth. Kështu, prezenca e pesticideve klororganik është detektuar në ujë, tokë, sedimente, si dhe në organizma. Mostrat e marra nga toka afër vendit të ruajtjes së pesticideve kanë rezultuar me një përmbajtje të HCH që variojnë nga 1290-3140 mg/kg tokë, pra një përmbajtje shumë e lartë. Përmbajtja totale e izomerëve të HCH në mostrat e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor rezultonte 0.28 dhe 1.47 $\mu\text{g/litër}$ respektivisht, pra në ujin nëntokësor vlera është afro 3 herë më e lartë se norma e lejuar e pesticideve në total për ujin e pijshëm (0.5 $\mu\text{g/litër}$).

Gjithashtu, prezenca e klororganikëve është vërejtur edhe në mostrat e midhjeve të zonës të analizuara, ku sasia totale e izomerëve të DDT-së variojnë nga 45.4 në 448.7 ng/g masë të freskët, ndërsa sasia totale e izomerëve të HCH variojnë nga 5.7 në 52.8 ng/g masë të freskët.

Në zonën rreth ish-Uzinës Kimike në Portoromano Durrës, janë gjetur përmbajtje të lartë klorobenzenve në tokë, ujë, sedimente, si dhe në organizmat detar afër uzinës. Kështu, një mostër uji nëntokësor e marrë afër uzinës rezultonte të përmbante afro 4.4 mg/L klorobenzen, 4000 herë më tepër se norma e lejuar në ujin e pijshëm në vendet e BE-së.

Përmbajtjet e TeCBs dhe HCB së detektuar në mostra toke ishin 1.86 dhe 3.7 ng/g, respektivisht. HCB është detektuar edhe në mostra të midhjeve në ujin e detit afër Portoromanos dhe përqendrimi shkonte deri në 22.4 ng/g masë të freskët.

3. STRATEGJIA DHE ELEMENTET PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT

3.1 Angazhimi politik

Që nga koha e inventarit të parë të NOQ-ve të vitit 2006 në Shqipëri, deri në vitin 2017, hapa progresive janë bërë në zbatimin e Konventës së Stokholmit dhe përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së në menaxhimin e NOQ-ve. Hapat progresive në menaxhimin e NOQ-ve lidhen me çështjet e mëposhtme:

- Mbetjet e DDT-së dhe lindanit, si dy nga pesticidet NOQ më të rëndësishme, janë eliminuar, ndërkohë që mbetjet e tyre në komponentë të ndryshëm mjedisor duhet të vlerësohen;
- Prodhimi, importi dhe përdorimi i NOQ pesticideve në Shqipëri është i ndaluar dhe nuk ekziston;
- Importi, transiti dhe përdorimi i pesticideve të tjera është i bazuar në procedurat standarde dhe konform praktikave më të mira ndërkombëtare;
- Përdorimi i materialeve dhe pajisjeve që përmbajnë mbetje NOQ është nën kontroll dhe disa masa mjedisore janë marrë për menaxhimin e tyre;
- Janë identifikuar burimet e NOQ-ve jo të qëllimshme dhe disa masa janë marrë për të ulur emetimin e tyre të shkaktuar nga djegiet e mbetjeve të ndryshme në mjedis të hapur dhe industri të tjera;
- Ndërgjegjësimi i publikut për rrezikun e NOQ-ve mbi shëndetin dhe mjedisin është rritur ndjeshëm.

Nga analiza e mësipërme e NOQ-ve në Shqipëri janë identifikuar objektivat dhe planet specifike të menaxhimit dhe/ose asgjësimit të tyre në përmbushje të detyrimeve të Konventës së Stokholmit, si më poshtë:

- Përcaktimi i përgjegjësive institucionale në nivel kombëtar dhe rajonal për asgjësimin dhe

menaxhimin e komponimeve të NOQ-ve dhe rritjen e kapaciteteve institucionale dhe sektoriale për zbatimin e detyrimeve të Konventës dhe raportimit;

- Krijimi i sistemeve menaxhuese dhe forcimi i kapaciteteve teknike për eliminimin/ reduktimin e mbetjeve që gjenerojnë substanca të NOQ-ve me qëllim shmangien e emetimit të paqëllimshëm të tyre në mjedis;

- Hartimi, në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së, i akteve nën ligjore (bazuar në ligjin për kimikatet, 2016) për administrimin mjedisor të NOQ-ve, duke përfshirë normat e përcaktuara për NOQ në komponentët e mjedisit, shkarkimet nga aktivitetet ekonomike, monitorimin dhe limitet në produktet ushqimore;

- Caktimi i institucioneve për monitorimin e NOQ-ve në mjedis (ajër, ujë, tokë dhe biota) dhe përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për kryerjen e monitorimit (mostrimi dhe analizat përkatëse);

- Informimi nëpërmjet formave dhe mjeteve të ndryshme të komunikimit të gjendjes në mjedis dhe efekteve në shëndet të prezencës së NOQ-ve nga institucionet përgjegjëse qendrore dhe lokale, aktorët industrialë, dhe qendrat respektive të kërkimit veçanërisht të efekteve të dioksinave dhe furaneve;

- Sigurimi i financimeve të nevojshme për rritjen e kapaciteteve institucionale, asistencë teknike, përcaktimin e mekanizmave më të sigurta për zbatimin e Konventës së Stokholmit dhe monitorimin e tyre në mjedis kryesisht nëpërmjet fondeve të buxhetit të qeverisë;

- Zgjerimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit, shkëmbimi i informacionit shkencor për të administruar NOQ-të dhe përdorimin e teknologjive më të mira të mundshme (BAT) dhe praktikat më të mira të mundshme mjedisore (BEP).

- Eliminimi i pajisjeve që përmbajnë PCB nga përdorimi.

Analiza e të dhënave dhe posaçërisht inventarit të kryer deri më tani në Shqipëri rezulton se pothuaj të gjitha komponimet që përmbajnë NOQ importohen. Ato përdoren në masë të ndryshme, por nuk prodhohen në vend.

Pesticidet të cilat përmbajnë NOQ që prej vitit 2007 nuk importohen më në Shqipëri. Ish-vendi i përzierjes dhe magazinimit të pesticideve në Durrës është inkapsuluar me beton dhe gjithë mbetjet janë asgjësuar. Lista e pesticideve të ndaluara nga importi dhe regjistri kombëtar i komponimeve kimikate (të rrezikshme ose jo) janë eficiente. Megjithatë, për shkak të qëndrueshmërisë së tyre në mjedis dhe shpeshherë mos kontrolli i shkallës së pastërtisë së pesticideve që përdoren në bujqësi kërkojnë monitorim dhe Plan Veprimi të posaçëm në përmbushjen e detyrimeve të Konventës së Stokholmit, si vijon.

Substancat DDT dhe lindan, të përdorura para viteve 1990 rezulton se nuk ekzistojnë gjendje fizike të tyre. Siç raportohet edhe në raportin e parë sasitë, e identifikuar gjatë inventarit 2006, të DDT-së dhe hegzakloran /lindanit u hoqën nga Shqipëria në kuadër të projektit MMPAU, “Ripaketimi dhe heqja nga Shqipëria e pesticideve dhe e kimikateve të tjera nga Bishti i Pallës”, të financuar nga qeveria holandeze dhe ky eliminim u përfundua në korrik 2006 dhe për këto komponime nuk kërkohet Plan Veprimi në nivel kombëtar.

PCB-të përmbahen kryesisht në transformatorët/kondesatorët që përdoren në sistemin energjetik dhe sipas PKV-së të vitit 2006 rreth 5,3% e vajit të tyre ka pasur përmbajtje të NOQ-ve. Duke qenë se një pjesë e mirë e tyre janë në funksion më poshtë prezantohet Plani i Veprimit.

NOQ-të e prodhuar në mënyrë të paqëllimshme, siç përcaktohet në Konventën e Stokholmit, janë dibenzofuranet e polikloruara (PCDF), dibenzo-p-dioksinat e polikloruara (PCDD), hegzaklorobenzeni (HCB), si dhe bifenilet e poliklorinuar (PCBs), ku PCBs-të janë formuar si nënprodukte. Burimet e tyre në Shqipëri janë të identifikuar dhe, për shkak të manaxhimit të dobët të mjedisit (menaxhimi i kategorive të ndryshme të mbetjeve dhe sidomos djegiet e pasigurta), është i domosdoshëm plani specifik për to.

PoliBrom difenil eteret (PBDEs) janë një grup komponimesh organike aromatike të bromuara që orgjinohen nga industrina elektronike (për prodhimin skeleteve plastike të pajisjeve kompjuterike) dhe në industrinë e transportit (për prodhimin e mbushjeve në automjete). Shqipëria nuk prodhon PBDEs, por përdor mjetet dhe pajisje që përmbajnë këto substanca.

Acidi perfluoroktan sulfonik (PFOS), kripërat e tij dhe floruri i perfluoroktan sulfonilit (PFOSF) dhe Hegzabromciklododekan (HBCD), dhe si edhe PBDEs nuk prodhohen, por përdoren. Duke qenë se shkalla e përdorimit të tyre është e madhe për të katër grupet më sipër (PBDEs, PFOS, PFOSF dhe HBCD) do të ketë një plan veprimi të veçantë.

Objektivat dhe prioritetet për zbatimin e Konventës së Stokholmit janë të përcaktuara në planet e mëposhtme të veprimit në përputhje me rekomandimet e Konventës së Stokholmit:

1. Plani i Veprimit për Masat Institucionale dhe Rregullatore për Zbatimin e Konventës së Stokholmit dhe

raportimi;

2. Plani i Veprimit për PBDEs, PFOS, PFOSF dhe HBCD;
3. Plani i Veprimit për NOQ-të e tjerë të rinj;
4. Plani i Veprimit për PCB-në dhe Pajisjeve që Përmbajnë PCB;
5. Plani i Veprimit për Komponente/procese që prodhojnë substanca NOQ në mënyrë të paqëllimë;
6. Plani i Veprimit për Zonat e Ndotura;
7. Plani i Veprimit për Monitorimin e Përgjithshëm të Kimikateve NOQ;
8. Plan i Veprimit për Arsim, Ngritjen e Vetëdijes dhe Informimit Publik.

3.2 Strategjia e zbatimit dhe planet e veprimit

3.2.1 Kërkesa të përgjithshme për përgatitjen e planeve të veprimit për substancat NOQ

Për klasifikimin, regjistrimin dhe shkallën e rrezikshmërisë së çdo substance kimike nevojitet generimi i informacionit për to nëpërmjet:

- a) Vetëdeklarimit të përputhshëm me të dhënat teknike dhe shkencore të produktit (sipas standardeve të përshkruara në legjislacion) bazuar mbi certifikatatën e origjinës së substancës;
- b) Analizave komplementare ose jo të produktit mbi substancën aktive ose papastërtive në të;
- c) Nëpërmjet testeve, nëse ato janë të mundura, me asistencë të huaj ose të organeve/inspektorateve të fushës përkatëse. Çdo testim i ri ekotoksikologjik dhe toksikologjik dhe analiza të tjera analoge kryhen në përputhje me legjislacionin specifik dhe sipas standardeve të tjera ndërkombëtare ekuivalente.

3.2.2 Vlerësimi social ekonomik për hartimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit (PKV)

Për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit të Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ), në fillim të procesit u përgatit një vlerësim social ekonomik, mbështetur kjo në metodologjinë UNEP (2007) për hartimin dhe zbatimin e PKV-së bazuar në Konventën e Stokholmit.

U përcaktuan dhe u organizuan takime me palët e interesuara si vendim marrësit, sektorët ekonomikë të lidhur në mënyrë direkte apo indirekte me NOQ-të dhe përdorimin e kimikateve, kompanitë që lidhen me prodhimin, transportin dhe përdorimin e substancave që përmbajnë NOQ. Konsultimi me strategjitë dhe politikat të lidhura me zbatimin e Planit, si dhe konsultimi me publikun e gjerë, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë, në zonat e kontaminuara dhe/ose potencialisht të prekura nga përdorimi i pesticideve dhe substancave të tjera që përmbajnë NOQ, u krye në mënyrë që të merreshin opinionet dhe komentet e tyre për aplikimin e praktikave në menaxhimin e NOQ-ve. Në këtë mënyrë, konsultimet u realizuan me burimet më të rëndësishme të informacionit. Bazuar në detyrimet raportuese që vijnë nga Konventa e Stokholm-it, gjatë periudhës së përgatitjes së këtij dokumenti (2014–2016) u kontaktuan tri grupe interesi:

1. Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë (MMSR); gjatë takimeve në këtë ministri u diskutua rreth impaktit mjedisor në jetesën e njerëzve që jetojnë përreth zonave të identifikuar të kontaminuara me NOQ dhe në zonave ku janë përdorur NOQ-të. Identifikimi i çështjeve mjedisore që lidhen me ndotjen e mundshme nga përdorimi i NOQ-ve në zonat e tyre dhe nëse niveli i jetesës ndikohet apo jo nga përdorimi i substancave të NOQ-ve.

2. Ministria e Shëndetësisë; ku u diskutua rreth ndikimit të mundshëm të NOQ-ve në shëndetin e njerëzve, mbetjeve ose depozitimi i mbetjeve të banorët që jetojnë pranë qendrave që përmbajnë zona të kontaminuara.

3. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave; gjatë takimeve u grumbullua informacion rreth rregullave dhe ligjeve për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mjedisit dhe si pasojë e përdorimit në të shkuar e pesticideve NOQ, përdorimi i mundshëm i pesticideve NOQ gjatë viteve të fundit dhe bazat ligjore për regjistrimin, importin dhe përdorimin e pesticideve në vendin tonë.

Në fazën e përgatitjes së Planit Kombëtar të Veprimit u realizuan tri takime (*workshops*) me pjesëmarrës të kualifikuar nga institucione të ndryshme që kishin lidhje me çështjet mjedisore dhe NOQ-të. Këto takime patën në fokus tri tematika të ndryshme lidhur me NOQ: i) aspekti ligjor dhe institucional për kimikatet e rinj NOQ; ii) situata aktuale e pesticideve NOQ dhe rehabilitimi i zonave të kontaminuara; iii) gjendja aktuale e PCB-ve dhe plani i veprimit për eliminimin e vajit të transformatorëve dhe pajisjeve të kontaminuara me PCB.

Në përgatitjen e PKV-së u përfshi i gjithë informacioni, të dhënat dhe komentet të marra gjatë takimeve me palët e interesit dhe mbledhjet e punës (*workshops*)

Pasi Plani u përgatit dhe u prezantua si draft (tetor, 2016) dhe informacioni u shpërnda palëve të interesit për të marrë komentet e tyre në fund të nëntorit. Korrigjimet e bëra në PKV (draft), bazuar në komentet e palëve të interesit konsistuan në: i) marrja e masave më të thjeshtuara në planin e NOQ-ve dhe me buxhet më të vogël; dhe ii) në ndërgjegjësimin e publikut plani duhet të jetë më i detajuar sidomos me masat që lidhen me riskun e NOQ-ve.

3.2.3 Plani i Veprimit për Forcimin e Masave Institucionale dhe Rregullatore

Legjislacioni kombëtar në Shqipëri është duke plotësuar paketën ligjore me të gjitha dispozitat e nevojshme për të siguruar pajtueshmërisë me Konventën e Stokholmit. Mbetet që aktet nën ligjore (VKM, rregullore dhe urdhra) duhet të plotësohen për të siguruar menaxhimin e NOQ-ve veçanërisht për:

1. Ndalimin e importit, eksportit, prodhimit dhe përdorimit e kimikateve NOQ, shtojca A e kimikateve (pesticide);
2. Trajtimi, përdorimi, shkrirja (nga 2025) dhe asgjësimi (nga 2028) të disa kimikateve NOQ aneksi A II (si PCBs);
3. Minimizimin ose eliminimin e kimikateve të aneksit C (NOQ-të prodhuar joqëllimisht nga produkte/procese dhe teknologji etj.);
4. Asgjësimin e mbetjeve të NOQ-ve sipas praktikave më të mira të përputhshme me mjedisin.

Këta objektiva specifike bëhen të detyrueshme përderisa Shqipëria është kandidat e Bashkimit Evropian dhe duhet të implementojë, midis të tjerash, edhe *acquis* e Bashkimit Evropian në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe specifikisht të kimikateve të rrezikshme. Pas PKV-së për NOQ-të (2006) specifikisht janë bërë hapa para në planin institucional për eliminimin, heqjen nga përdorimi, si dhe të monitorimit të tyre. Nëpërmjet VKM-së nr. 860, datë 20.12.2006, “Për eliminimin dhe heqjen nga përdorimi i NOQ-ve” është bërë i mundur eliminimi i mbetjeve të rrezikshme të pesticideve dhe inkapsulimi i vatrës kryesore të prodhim/magazinit të pesticideve. Sipas VKM-së më sipër, të gjitha mbetjet me substanca NOQ do të eliminohen nga territori i Shqipërisë, si dhe që prej vitit 2006 asnjë kimikat me përmbajtje sado të vogël (edhe si papastërti) të NOQ-të nuk lejohet të mbahet në Shqipëri.

Në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit” në nenit 32 të tij përcaktohet vendosja e “Regjistrat të Shkarkimeve dhe Transferimeve të Ndotësve për të përmbushur veç të tjerash edhe ...detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare” ku përfshihen edhe monitorimi i NOQ-ve. Ndërsa në nenin 34 të po këtij ligji përcaktohet se “...Mbrojtja nga efektet e dëmshme të kimikateve, përbërjeve dhe preparateve të tyre përfshih masat dhe procedurat e mbrojtjes nga efektet e tyre të dëmshme mbi mjedisin dhe shëndetin e njeriut” dhe se “...Masat për zbatimin e mbrojtjes nga efektet e dëmshme të kimikateve përcaktohen me ligj të posaçëm”. Kjo detyrë e fundit është përmbushur me ligjin nr. 27/2016, 17.3.2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, ku NOQ-të janë pjesë e rëndësishme.

Akti nënligjor më i rëndësishëm pas VKM-së nr. 860 datë 20.12.2006, është VKM-ja nr. 360, datë 29.4.2015, “Për miratimin e listës së Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”, pasi në këtë vendim përcaktohet qartë kontrolli i prodhimit, vendosja në treg, përdorimi, eksportimi dhe transitimi i NOQ-ve/mbetjeve të kontaminuara/që kanë në përbërje NOQ, si dhe kontrolli doganor i tyre, duke respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stokholmit. Gjithashtu, përcaktohet që ministria përgjegjëse për mjedisin përgatit Planin Kombëtar i Veprimit (PKV) për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e NOQ-ve, si dhe AKM-ja përcaktohet si institucion kryesor përgjegjës për monitorimin dhe raportimin në lidhje me NOQ.

Bazuar në avancimin e legjislacionit mjedisor në tërësi dhe të NOQ-ve në veçanti, duke konsideruar dispozitat e Konventës së Stokholmit, si dhe traktate të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, politikat kombëtare dhe prioritetet për forcimin institucional dhe rregullator sugjerohet:

- NOQ-të dhe PCBs-të e veçantë të përfshihen si pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit;
- Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit mjedisor me atë të BE-së. Kujtojmë se ligji, “Për mbrojtjen e mjedisit” është në përputhje të plotë me atë të BE-së, por ligji, “Për menaxhimin e kimikateve” është pjesërisht i përafuar;
- Ngritja dhe vënia në eficientë e “Zyrës së Kimikateve”, “Regjistrat Kombëtar të kimikateve të importuara”, “Komisionit ndërmintor të kimikateve” dhe akteve të tjera nën ligjore që rrjedhin nga ligji, “Për menaxhimin e kimikateve”.

Harmonizimi i legjislacionit me BE-në

Disa ligje dhe VKM, të cilat direkt ose indirekt trajtojnë rregulla dhe procedura të menaxhimit të NOQ-ve, janë implementuar në dekadën e fundit.

- Ligji nr. 10431 nga 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, është i përafuar plotësisht me direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” e ndryshuar; Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

- Ligji nr. 10440, datë 2011.7.7 “Vlerësimi i ndikimit në mjedis” (VNM), i cili është përafuar pjesërisht me direktivën 2011/92/EU mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin.
- Ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i cili ka përafuar plotësisht direktivën 2008/1/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 15 janar 2008 “Mbi kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes”, të ndryshuar, dhe Direktivën 2001/80/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 tetor 2001 “Mbi kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga instalimet e mëdha me djegie”, të shfuqizuar me direktivën nr. 2010/75/BE, e cila do të transpozohet ligjin e ri për lejet e mjedisit.
- Ligji nr. 27/2016, datë 17.3.2016, “Për menaxhimin e kimikateve” është i përafuar pjesërisht me Rregulloren (KE) 1907/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 18 dhjetor 2006, “Mbi regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH), krijimin e Agjencisë Evropiane të Kimikateve, e cila amendon direktivën 1999/45/KE, shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) 793/93 dhe Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 1488/94, si dhe direktivën e Këshillit 76/769/KEE dhe direktivat e Komisionit 91/155/KEE, 93/67/KEE, 93/105/KEE dhe 2000/21/KE”, e ndryshuar”, dhe me Rregulloren (KE) 1272/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve, e cila amendon dhe shfuqizon direktivat 67/548/KEE dhe 1999/45/KE dhe amendon Rregulloren (KE) 1907/2006”, të ndryshuar.
- Edhe pse Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Bazelit mbi kontrollin ndërkufitar, lëvizja e mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimi i tyre, ka ende boshllëqe në legjislacionin të cilat kërkojnë që të plotësohen në mënyrë të kontrolluar në mënyrë efektive importin e kimikateve/ mbetjeve të tilla.

Tabela 17. Plani i Veprimit për masat institucionale dhe rregullatore për zbatimin e Konventës së Stokholmit dhe raportimi

Përafrimi i legjislacionit me atë të BE-së				
Përshkrimi i masës	Institucioni përgjegjës	Koha	Indikatorët/mjetet e verifikimit	Kosto e masës (në €)
Rishikimi dhe përditësimi i legjislacionit kombëtar që adreson NOQ-të në pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së, të përditësuar 850/2004; 2008/98, 93/86/EEC, 2001/68/EC dhe Direktivën e Këshillit 96/59/KE e datës 16 shtator 1996 për asgjësimin e PCB / PCT.	MTM, AKM	2020	Legjislacioni harmonizuar me Legjislacionin e BE	15,000
Hartimi dhe miratimi i legjislacionit që adreson substancat aktive dhe NOQ-ve në përputhje me Rregulloren e KE-së nr. 1107/2009 dhe përditësimet e rregullores 850/2004	MTM/ MBZHR	2018	Akti i aprovuar	25,000
Hartimi dhe miratimi i udhëzimit për standarde të menaxhimin / kontrollin e PCB-ve gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës	MIE/ KESH/ MTM (Zyra e kimikateve)	2020	Guida me standardet evropiane	2,000
Nxjerrja e akteve nënligjore për përkufizimet dhe detyrimet e përdorimit të BAT-it (përdorimi i teknikave më të mira) për një numër i kufizuar i rëndësishëm industri në Shqipëri, për shembull, rafineritë e naftës, prodhimi i çimentos, trajtimi dhe riciklimi i mbetjeve	MTM	2020	Akte nën ligjore të aprovuara në përputhje me standardet evropiane	40,000
Zbatimi i legjislacionit përkatës lidhur me substancat organike volatile (VOC)	MTM/MIE/A KM/ISHMP	2019–2024	Legjislacioni i zbatuar, në përputhje me direktivat respektive të BE-së	40,000
Përcaktimin e përgjegjësisë institucionale për komponimet NOQ dhe rritja e kapaciteteve institucionale dhe sektoriale për zbatimin e detyrimeve				
Zhvillimi i Planit Kombëtar për Menaxhimin e Sigurt të Kimikateve Hapja e Zyrës së Kimikateve.	MTM dhe AKM	2020	Plani Kombëtar i Hartuar	10,000
	MTM/KESH/O SHEE/MIE	2019	Hapja e zyrës	20,000
Punësimi i dy specialistëve me kohë të plotë në zyrën e kimikateve	MTM	2019	Funksionimi i Zyrës	45,000
Hapja e Zyrës së Komisionit Ndërmënisht të NOQ-ve. Një koordinator i punësuar.	MTM/KESH/ OSHEE/MIE	2019	Funksionimi i zyrës koordinuese të Komisionit Ndërmënisht të NOQ-ve	30,000
Organizimi i një programi trajnimi	MTM dhe AKM	2019	Modulet trajnuese dhe	10,000

për autoritetet kompetente për menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve nga pesticidet, paketimet dhe mbetjet e tjera të PCB-së.			sigurimi i financimit
Rritja e ndërgjegjësimit të organeve kompetente shtetërore, të industrisë dhe të subjekteve të tjera në lidhje me çështjet që lidhen me pajisjet e NOQ-ve, kimikatet, mbetjet dhe NOQ-ve të prodhuar në mënyrë të paqëllimshme.	MTM/KESH/O SHEE/MIE	2019	Numri i takimeve ndërgjegjësuese 12,000

3.2.4 Plani i Veprimit për PBDE-të, PFOS, PFOSF dhe HBCD

Substancat që përmbajnë: PBDEs, PFOS, PFOSF dhe HBCD-të gjenerojnë NOQ si nënprodukte pas përdorimit të tyre në industrinë elektronike; ndërtimit, tekstilë, transportit dhe atë të karkasave të makinave. Në Shqipëri ato nuk prodhohen, nuk riciklohen; ato vetëm grumbullohen dhe depozitohen në landfille, thjesht si materiale të ngurta. Konventa e Stokholmit kërkon inventarizim të tyre, grumbullim dhe riciklim (aty ku teknologjia është e mundur) dhe vendosje të sigurt. Në Shqipëri Plani i Veprimit për këto substanca kërkon këto masa kryesore:

- Inventarizim të të gjithë pajisjeve/makinerve të cilat përmbajnë PBDEs, PFOS, PFOSF dhe HBCD;
- Identifikimi pajisjeve dhe mallrave të importuara me këto komponime;
- Krijimin e bazës së të dhënave sipas specifikave të produkteve/pajisjeve dhe mallrave që përmbajnë këta NOQ.
- Krijimin e bazës ligjore për menaxhimin e tyre;
- Eliminimi i mbetjeve industriale dhe tregtare që përmbajnë këto komponime NOQ.

Tabela 18. Plani i Veprimit për PBDEs, PFOS, PFOSF dhe HBCD

Vlerësim fillestar i gjendjes së kimikateve PBDEs në mjedis				
Përshkrimi i masës	Institucioni përgjegjës	Koha	Indikatorët/mjetet e verifikimit	Kosto e masës (në €)
Përshkrimin e protokolleve/procedurave për ndalimin e prodhimit, përdorimit, importin dhe eksportin e PBDE-ve	AKM	2019	Procedura	0,000
Zhvillimi i inventarit mbi përdorimin e mundshëm dhe magazinimin e mbetjeve të PBDEs në vend	MTM	2020	Inventari-Raport	10,000
Vlerësim fillestar i gjendjes së acidit perfluoroktan sulfonik (PFOS), kripërat e tij, floruri i perfluoroktan sulfonilit (PFOSF) dhe heksabromciklododekan (HBCD)				
Identifikimi i industrive dhe aktiviteteve humane që përdorin pajisje/produkte që përmbajnë PFOS, PFOSF dhe HBCD.	MTM	2019	List	5,000
Përshkrimin e protokolleve/procedurave për ndalimin e prodhimit, përdorimit, importin dhe eksportin e PFOS-ve, PFOSF-ve dhe HBCD-ve.	MTM dhe AKM	2020	Procedura	0,000
Zhvillimi i inventarit mbi përdorimin e mundshëm dhe magazinimin e mbetjeve të PFOS-ve, PFOSF-ve dhe HBCD-ve në vend.	MTM dhe AKM	2021	Inventari-Raport	5,000

3.2.5 Plani i Veprimit për NOQ-të e tjerë të rinj (heksaklorobutadiene, pentaklorofenol me kripërat dhe esteret e tij, naftalenet e poliklorinuara)

NOQ-të e tjerë të rinj si heksaklorobutadiene, pentaklorofenoli (PCP) dhe naftalenet e poliklorinuara (PCNs) paraqesin një rëndësi të madhe mjedisore pasi ndikojnë negativisht mbi shëndetin e njeriut dhe në mjedis. Këto komponime mendohet që nuk janë shumë prezent në sistemet mjedisore në vendin tonë pasi ato nuk janë prodhuar dhe përdorur në sasi të konsiderueshme, ndërkohë që edhe në botë prodhimi i tyre është ndaluar vite më parë. Megjithatë, edhe për këto komponime të NOQ-ve, sidomos për

pentaklorofenolin që është përdorur në të kaluarën, parashikohen masa në kuadër të planit të veprimit.

Tabela 19. Plani i Veprimit për kimikatat heksaklorobutadiene, PCP dhe PCNs

Vlerësim fillestar i gjendjes së kimikateve heksaklorobutadiene, PCP dhe PCNs				
Përshkrimi i masave	Institucioni përgjegjës	Koha	Indikatorët/mjetet e verifikimit	Kosto e masës (në €)
Vendosja e një sistemi të integruar kontrolli (Dogana, ministria përgjegjëse për bujqësinë, ministria përgjegjëse për mjedisin) për eliminimin dhe parandalimin e importit të pajisjeve që përmbajnë komponime të NOQ-ve të tjerë të rinj (edhe si papastërti).	MTM/ MSHMS/MBZ HR/MIE/doga nat	2019	Udhëzues	0,000
Identifikimi i industrive dhe aktiviteteve humane që përdorin pajisje/produkte që përmbajnë NOQ të tjerë të rinj.	MTM/AKM	2020	List	5,000
Zhvillimi i inventarit mbi përdorimin e mundshëm dhe magazinimin e mbetjeve të NOQ-ve të tjerë të rinj në vend.	MTM dhe AKM	2020	Inventari-Raport	5,000

3.2.6 Plani i Veprimit për PCBs dhe Pajisjet që Përmbajnë PCBs

Për substancat e PCB-ve dhe pajisjet që përmbajnë PCBs Konventa e Stokholmit përcakton objektivin e mëposhtëm: masa efektive për sigurinë që pajisjet që përmbajnë PCBs të zëvendësohen më së paku brenda vitit 2025 dhe të eliminohen të gjitha mbetjet me PCBs brenda vitit 2028.

Masat e mëposhtme rekomandohen për PCBs dhe pajisjet që përmbajnë PCBs në kuadër të PKV-së:

- Për të përpunuar dhe zbatuar rregullore në lidhje me administrimin, trajtimin, monitorimin, heqjen nga dhe eliminimin e vajit dhe pajisjeve të ndotura me PCBs;
- Përcaktimi dhe zbatimi i rregullores së brendshme të KESH/OSHE/OST në menaxhimin e transformatorëve, trajtimin dhe heqjen nga puna të tyre;
- Trajnimi i punonjësve përgjegjës për trajtimin dhe mirëmbajtjen e transformatorëve dhe ndikimin në mjedis dhe shëndet të PCB-ve;
- Krijimi i kapaciteteve për analizën gjysmësasiore (me test-kite) për të vlerësuar përmbajtjen e PCB-ve në vajin e transformatorëve;
- Krijimi i kapaciteteve laboratorike në nivel kombëtar për analizën sasiore dhe cilësore të PCB-ve në vajin e transformatorëve;
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për rrezikun në mjedis dhe shëndet të substancave PCBs;
- Identifikimi i vendeve të ndotura me PCBs dhe rehabilitimi i tyre;
- Eliminimi i vajit mineral të ndotur me PCBs;
- Projektimi për të vënë në vend një program monitorimi të PCB-ve në nivel kombëtar.

Tabela 20. Plani i Veprimit për menaxhimin e PCB-ve

Krijimi i sistemit për identifikimin, shënimin, heqjen, ruajtjen dhe asgjësimin përfundimtar të pajisjeve me PCB dhe mbetjeve me PCB				
Përshkrimi i masës	Institucioni përgjegjës	Koha	Indikatorët/mjetet e verifikimit	Kosto e masës (në €)
Krijimi i inventarit të pajisjeve që përmbajnë PCB dhe mbetjeve me PCB në Shqipëri	AKM/UBT- Departamenti Mjedisit	2019	Lista e detajuar e inventarit	15,000
Përgatitja e raportit të pajisjeve që përmbajnë PCB, në përputhje me kërkesat e Konventës së Stokholmit	AKM/UBT- Departamenti i Mjedisit	2019	Raport për pajisjet dhe mbetjet PCB	8,000
Hartimi dhe Zbatimi i një udhëzuesi të Brendshëm për heqjen e vajit të transformatorëve dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të kontaminuara nga rrjedhjet e vajit	KESH/OSHEE /OST/MIE/M TM	2019	Udhëzues i miratuar	5,000
Përpilimi i broshurës për identifikimin e PCB-ve të përdorura në industrinë e plastikës, polimer, ngjyra dhe veshje dhe në ndërtimin	MTM/MIE/	2019	Broshure	3,000
Përgatitja dhe implementimi i një trajnimit specifik për ekipet e riparimit dhe mirëmbajtjes së transformatorëve	KESH/OSHEE /OST	2019	Modulet e trajnimit të brendshëm	2,000

Akreditimi i Laboratorit të PBCs-ve dhe validimi i performancës	AKM/MTM	2022	Certifikata e Akreditimit	3,500
Plani për largimin gradualisht të pajisjeve të mbetura që përmbajnë PCB (veçanërisht transformatorët dhe kondensatorët e energjisë elektrike)	KESH/OSHEE /OST/MTM/A KM	2020	Numri i pajisjeve që hiqen	0.000
Aprovimi dhe implementimi i programit kombëtar të monitorimit të PCB-ve	MTM/AKM	2019 e në vijim	Programi monitorimit	0.000
Hartimi i planit kombëtar për asgjësimin/dekontaminimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe mbetjeve me PCB	MTM/AKM	2019	Plani i Asgjësimit	0.000

3.2.7. Plani i Veprimit për NOQ-të e Prodhuar Joqëllimisht

Në lidhje me NOQ-të e prodhuara, si nënprodukt, joqëllimisht Konventa e Stokholmit përcakton objektivin e minimizimit dhe, kur është e mundur, eliminimin përfundimtar i produkteve/pajisjeve që çlirojnë/japin, joqëllimisht, nënprodukte të NOQ-ve të prodhuar nga burime antropogjenë.

Për administrimin e këtyre NOQ-ve, më poshtë, janë identifikuar masat specifike të menaxhimit të tyre:

- Kompletimi i legjislacionit dhe rregulloreve në lidhje me parandalimin e ndotjes industriale, kontrollit, si dhe administrimin e mbetjeve;
- Forcimi i kapaciteteve (humane dhe teknike) për institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve (në zë të veçantë menaxhimin e landfillëve dhe parandalimi i djegies së hapur);
- Politika të veprimit për reduktimin e dioksinave dhe furaneve nga emetimet e venddepozitimet dhe djegies së mbetjeve;
- Futja e teknikave më të mira dhe praktika më të mira menaxhimi në sektorin industrial dhe atë të ndërtimit;
- Zhvillimi dhe zbatimi i praktikave bashkëkohore të trajtimit të mbetjeve mjekësore në mbarë vendin, për të minimizuar emetimet jo të qëllimshme të NOQ-ve.
- Rritja e Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë për menaxhimin mjedisor të mbetjeve;
- Përditësimi i rregullt i inventarit të emetimeve të NOQ-ve jo të qëllimshme.

Tabela 21. Plani i Veprimit për NOQ-të e Prodhuar Joqëllimisht

Eliminimi i prodhimit të kimikateve NOQ të prodhuar pa qëllim në procesin e djegies së hapur të mbetjeve dhe në industri të tjera përpunuese				
Përshkrimi i masës	Institucioni përgjegjës	Koha	Indikatorët/mjetet e verifikimit	Kosto e masës (në €)
Zhvillimi i rregulloreve dhe vendosja e tarifave mbi prodhimin dhe produktet që mund të jenë burim potencial i komponimeve që prodhojnë NOQ në mënyrë jo të qëllimshme.	MTM dhe AKM	2020	Tarifa për aktivitete specifike	0,000
Rishikimi i rregulloreve ekzistuese dhe standardeve për çlirimin e NOQ-ve të formuar në mënyrë të paqëllimshme.	MTM dhe AKM	Vazhdi misht	Rregullore të rishikuara	0,000
Fushata informuese mbi përfitimet e zëvendësimit e ngrohjes me karburanteve fosile dhe druri me sistemet alternative të ngrohjes.	MTM/AKM/universitetet/A kademia	2019–2024	Numri i workshop-eve	6,000
Hartimi i një rregulloreje për djegiet e mbetjeve bujqësore dhe djegiet në pyje.	MTM dhe MBZHR	2020	Rregullore për praktikatat/procedurat e djegjeve në fushat me barera të keqia	4,000
Hartimi i një plani veprimi TIP në nivel lokal për manaxhimin e mbetjeve shtëpiake për reduktimin e emetimeve të dioksinave dhe furaneve, si dhe ndërtimi i dialogut midis qeverisjeve qendrore dhe lokale në trajtimin e mbetjeve komunale, për efektivitetin e menaxhimit dhe në veçanti të djegies së pakontrolluar e mbetjeve.	MTM	2020	Plan lokal veprimi	3,000
Përmirësimi i kornizës ligjore, financiare dhe institucionale në funksion të parandalimit / eliminimit/çlirimit e NOQ-ve nga produkteve të aplikuara si BAT dhe BEP				

Forcimi i kontrollit ndaj shërbimeve teknike lidhur me emetimet nga automjetet, me qëllim afrimin e tyre me ato evropiane.	MTM/ISHM P/Ministria përgjegjëse për transportin	2019–vazhdim	Numri i kontrolleve	0,000
Prodhimi i pastër në industrinë e ferro-kromit dhe të çelikut.	AKM	Vazhdimisht	Instalime shtesë në industri	0,000
Prodhimi i pastër në mënyrë specifike duke synuar kontrollin e temperaturës dhe që rezultojnë emetimet dioksina në industrinë e çimentos	AKM	Vazhdimisht	Instalime shtesë në industri	0,000
Rritja e njohurive, krijimi i kapaciteteve dhe kryerjen e vetëmonitorimit të emetimeve të NOQ-ve të paqëllimshme në industrinë e ndërtimit dhe riciklimin e mbetjeve.	MTM dhe AKM	Nga 2019 në vazhdim	Numri i vet monitorimeve	5,000
Udhëzues për rrezikun dhe ndarjen e mbetjeve spitalore dhe trajnimet të stafëve ndihmese në të gjitha Spitalet dhe klinikat për minimizimin e mbetjeve dhe ndarjen e tyre.	MSHMS/MTM	2019	Udhëzues i hartuar	8,000
Krijimi i një skeme raportimi, krijimi i të dhënave mbi prodhimin dhe emetimin e NOQ-ve jo të qëllimshme dhe përfshirja e tyre në Raportin e Gjendjes së Mjedisit në Shqipëri.	AKM	2019 e në vijim	Perfshirja e emetimeve në Raportin Kombëtar të Monitorimit	5,000
Vazhdim i raportimeve të të dhënave mbi emetimet e NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht që dorëzohen në Sekretariatit e Konventës.	MTM/AKM	Në vazhdim	Raportime në periudhë	0,000

3.2.8 Plani i Veprimit për Mbetjet e NOQ-ve dhe Vendet e Ndotura

Për mbetjet e NOQ-ve dhe sipërfaqet e ndotura Konventa e Stokholmit përcakton detyrimin si vijon: mbetjet dhe sipërfaqet që përmbajnë ose janë të kontaminuara me komponime NOQ të ndodhur në aneksin A, B ose C duhet të menaxhohen në një mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit e njeriut dhe mjedisin.

Bazuar në analizën e situatës fillestare të vendit, duke pasur parasysh dispozitat ligjore masat për trajtimin/manaxhimin e mbetjeve me NOQ ose sipërfaqet e ndotura nga këto mbetje konsistojnë në:

- Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e NOQ-ve, në nivel lokal, institucional dhe agjencitë e specializuara;
- Rehabilitimi përfundimtar i vendeve të ndotura me NOQ nëpërmjet hartimit të planeve të rehabilitimit, specifik për çdo vend sipas nivelit të kontaminimit të tyre.

Si zona të identifikuar me ndotje nga NOQ-të janë listuar në përpilimin fillestar të PKV-së për Shqipërinë (2006), të cituara edhe më sipër, dhe ndodhen në Durrës (ish-Fabrika Kimike e Porto Romanos), në Vlorë (ish-PVC), në Elbasan (ish-Uzina e Koksit), në Lushnjë (ish-Fabrika e Plastmasit) dhe në Shkodër (Stacioni Hekurudhor Bajzë), Reparti i rigjenerimit të vajit dhe riparimit të transformatorëve në Tiranë etj.

Nëpërmjet masave të marra, të përshkruara më lart, zonat janë pastruar dhe rrethuar në një perimetër të mjaftueshëm për të mbrojtur mjedisin dhe sidomos shëndetin e njerëzve. Sidoqoftë, analiza dhe një sistem monitorimi dhe vlerësimi është i nevojshëm për secilën zonë.

Tabela 22. Plani i Veprimit për mbetjet dhe vendet e ndotura me NOQ

Vlerësim fillestar i gjendjes së mbetjeve me NOQ dhe vendet e ndotura				
Përshkrimi i masës	Institucioni përgjegjës	Koha	Indikatorët/mjetet e verifikimit	Kosto e masës (në €)
Identifikim i sipërfaqeve të ndotura, mostrim dhe analiza mostrash toke dhe gjaku për përcaktimin e nivelit të ndotjes në mjedis dhe shëndet	AKM dhe universitetet/A kademia, Institute kërkimore	2019–2021	Sipërfaqet në ha për secilën zonë	15,000
Trajnimi i strukturave të AKM-së dhe inspektoratit rajonal për zbatimin e ligjit për parandalimin e ndotjes	UBT (Dep. i Agromjedisit)	2019	Module trajnuese dhe numri i trajnimeve	10,000
Miratimi i rregulloreve për rehabilitim të pranueshëm nga aspekti mjedisor	MTM dhe MBZHR	2020	Rregullore - Guidë	0,000
Studimi i përqendrimit të NOQ-ve në sipërfaqet potencialisht të ndotura dhe renditja e tyre sipas nivelit të ndotjes (shëndet dhe mjedis).	AKM dhe universitetet/A kademia	2020–2023	Raport	20,000
Raportimi i të dhënave në sekretariatit e Konventës së Stokholmit	MTM	2019–2023	Të dhëna të raportuara	0,000

Përzgjedhja dhe implementimi i metodave më adekuate për rehabilitimin mjedisor të zonave të ndotura (tejt normave të standardit)	MTM universitetet/A kademia	2020	Metoda-Studim	
Vlerësimi dhe monitorimi i efekteve (shëndet dhe mjedis) në zonën e përzgjedhur për rehabilitim	MTM, Instituti i Shëndetit Publik, universitetet/Akademia	2021–2023	Zonë e rehabilituar	80,000

3.2.9 Plani i Veprimit për monitorimin e përgjithshëm të kimikateve NOQ

Komponimet kimike të klasifikuara në grupin NOQ janë shumë toksike duke kërcënuar shëndetin e njeriut dhe të kafshëve. Ata janë, gjithashtu, shumë rezistentë në kohë dhe për këtë përbëjnë një kërcënim pothuaj të përhershëm në mjedis në të gjithë komponentët globalë të tij: tokë, ujë, ajër. Kryerja e monitorimit të përmbytjeve të tyre, klasifikimit, përdorimit në jetën e përditshme dhe efektet në terma afat shkurtër dhe afat gjatë janë kërkesa të Konventës së Stokholmit. Në VKM-në nr. 360, datë 29.4.2015, përcaktohet që AKM-ja duhet të përfshijë në monitorimin e mjedisit edhe të dhëna për NOQ-të. Deri më tani, NOQ-të nuk janë përfshirë në monitorim, kështu që është e domosdoshme që në planin kombëtar të monitorimit të mjedisit të futen komponimet NOQ.

Ky monitorim do të bëjë të mundur një njohje të saktë të situatës për përmbytjen e NOQ-ve në komponentë të rëndësishëm të mjedisit, kontributin e aktiviteteve të ndryshme sociale dhe ekonomike në ndotjen e mjedisit e shkaktuar nga kjo kategori e kimikateve të rrezikshme, analizën e rrezikut, dhe në këtë bazë, përcaktimi i masave përkatëse të cilat duhet të kontribuojnë për përmirësimin e mjedisit dhe arritjen e standardeve mjedisore.

Në këtë kontekst, këto masa kryesore duhet të ndërmerren:

- Monitorimi i NOQ-ve në zona dhe mjedise të ndryshme, si pjesë e programit kombëtar të monitorimit;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale për studimin dhe kërkimin në lidhje me çështjet e NOQ-ve.

Tabela 23. Menaxhimi i NOQ-ve dhe mbrojtja e mjedisit, ushqimit dhe biodiversitetit

Harmonizimi, plotësimi dhe zhvillimi i ligjeve dhe akte nënligjore për të vendosur monitorimin e komponimeve të NOQ-ve në të gjitha planet e veprimit të mjedisit, ushqimit dhe biodiversitetit				
Përshkrimi i masës	Institucioni Përgjegjës	Koha	Indikatorët/mjetet e verifikimit	Kosto e masës (në €)
Miratimi i programit të monitorimit për substancat e NOQ-ve në të gjitha aksionet dhe planet e veprimit të mjedisit.	MTM/ dhe AKM	2019	Parametrat e NOQ-ve në PKM	0,000
Përfshirja e monitorimit të NOQ-ve, veçanërisht të PCB-ve, si pjesë e Mjedisit Kombëtar Programi i monitorimit.	MTM/ dhe AKM	2019	Parametrat e PCB-ve në PKM	0,000
Hartimi i programit të monitorimit për substanca të NOQ-ve në mjediset e punës.	MTM dhe MSHMS	2019	Program Monitorimi	0,000
Zbatimi i programit të monitorimit për kimikatet me përmbytje të NOQ-ve në: ajër, ujë dhe në det, tokë, biologjike organizma dhe te njeriu				
Kryerja e analizave për nivelin aktual të NOQ-ve në mbetjet e pesticideve në ish-depot dhe vende të kontaminuara, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut.	MTM dhe AKM/universitetet/Akademia	2019	Raport analitik	15,000
Zbatimi i programit të monitorimit për kimikatet NOQ në ujërat sipërfaqësore, nëntokësore dhe në venddepozitimet e mbetjeve.	MTM dhe AKM/universitetet/Akademia, institutet kërkimore	2020–2023	Raport analitik	30,000
Implementimi i planit të monitorimit të tokës në afërsi të ish-zonave të ndotura.	MTM dhe AKM/universitetet/Akademia, institutet kërkimore	2020–2023	Raport analitik	25,000
Implementimi i planit të monitorimit në ujërat detare dhe në sedimentet bregdetare.	MTM dhe AKM/universitetet/Akademia,	2021–2023	Raport analitik	15,000

Implementimi i planit të monitorimit në materiale biologjike (zogj dhe mamiferet detare).	institutet kërkimore MTM dhe AKM/ universitetet/A kademia	2021–2023	Raport analitik	10,000
Implementimi i planit të monitorimit të komponimeve NOQ në mjediset e punës.	MTM dhe AKM/ universitetet/A kademia, institutet kërkimore	2021–2023	Raport analitik	5,000
Raportimi dhe informimi i publikut dhe organizmave ndërkombëtare				
Raportimi i informacionit mbi përmbajtjen e substancave të NOQ-ve në mjedis dhe të mjediseve të punës në Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe në Sekretariatit i Konventës.	MTM dhe AKM/MSHM S/MBZHR/M IE/doganat	2019	Të dhena	5,000
Hartimi i një Raporti të rezultateve mbi gjendjen e mjedisit dhe materialeve biologjike dhe publikimi on line në faqen zyrtare të Ministrisë.	MTM dhe AKM/Universiteti/Akademia, institutet kërkimore	2021	Raport	20,000

3.2.10 Plani i Veprimit për Arsimim, Ndërgjegjësim dhe Informim Publik

Për informimin publik dhe rritjen e ndërgjegjësimit Konventa përcakton: qasje publike në informatat relevante për komponimet NOQ dhe ngritja e ndërgjegjësimit mbi to.

Për shkak se komponimet NOQ dhe sidomos mbetjet e materialeve të përdorimit të përditshëm në shumë aktivitete humane nuk janë lehtësisht të dallueshme nga publiku i gjerë informimi për këto komponime është i domosdoshëm. Ndërgjegjësimi publik është një mjet i madh presioni për politik bërjen dhe masat që eliminojnë/redukojnë rrezikun që vjen nga NOQ-të. Trajnimi dhe rritja e kompetencave profesionale e personave që merren direkt me NOQ-të përmirëson manaxhimin e tyre dhe pas analizës së komponimeve të NOQ-ve masat konsistojnë si me poshtë:

- Rritja e ndërgjegjësimit në komunitetet, informimi publik, angazhimi dhe aksesimi i rrjetit të OJF në dokumenta dhe të dhëna analitike mbi rrezikshmërinë e NOQ-ve dhe efektet e tyre në shëndetin e njeriut dhe mjedisit;

- Trajnimi i personelit që merret direkt me përdorimin e komponimeve të NOQ-ve;
- Angazhimi i medias në problemet mjedisore që lidhen me komponimet e NOQ-ve;
- Futja e njohurive mbi NOQ-të në programet shkollore (informacion i shkurtër në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, në lëndët me zgjedhje).

Tabela 24. Plani i Veprimit për Arsimim, Ndërgjegjësim të Publikut

Zhvillimi i një programi të detajuar - Strategji për informimin e publikut në lidhje me efektet e dëmshme të kimikateve NOQ				
Përshkrimi i masës	Institucioni përgjegjës	Koha	Indikatorët/mjetet e verifikimit	Kosto e masës (në €)
Fushatë sensibilizimi në zona industriale dhe në afërsi të landfillëve për efektet në shëndet, tokë, ujë dhe ajër të ndotjes me PCBs dioksina dhe furane nga djegjet e mbetjeve.	MTM dhe AKM/MSHMS, ISHP/universitete t/Akademia	2019	Numri i fletëpalosjeve	3,000
Përgatitja e broshurave me informacion mbi NOQ-të, të cilat kanë efekt në shëndetin e njeriut dhe mjedis.	MTM dhe AKM/MSHMS, ISHP/ universitetet/Akademia	2020	Broshure	5,000
Hartim i manualit për trajtimin e mbetjeve të pesticideve, paketimin dhe mbetjet nga PCB-ja.	MTM dhe AKM/MSHMS/MBZHR	2020	Manual	0,000
Informimi publik për mënyrën e mbledhjes dhe vendosjes së mbetjeve të komponimeve të NOQ-ve.	MTM dhe AKM/MSHMS	2019	Manual	0,000
Artikuj në shtypin e përditshëm për NOQ-të: gjendja dhe rreziku i tyre në mjedis dhe shëndet.	universitetet/Akademia	2020	Numri i artikujve	0,000

Rritja e ndërgjegjësimit për rrezikun e komponimeve të NOQ Tërheqja e mendimit të publikut në lidhje me gjendjen dhe efektet e NOQ-ve (takime, pyetsorë).	ISHP, Universitetet/Akademia	2023	Numri i takimeve	4,000
Organizimi emisionë në media fokusuar mbi menaxhimin e komponimeve të NOQ-ve.	Universitetet/Akademia	2019–2023	Numri i takimeve televizive	0,000
Përgatitja e një dokumentari dhe spote në televizionet lokale të rrezikuara më shumë nga përdorimi/mbetjet e NOQ-ve.	Universitetet/Akademia	2020	Dokumentar dhe numri i Spoteve	0,000
Hartimi i programit të edukimit të vazhdueshëm në lidhje me kimikatet e NOQ-ve në administratë, industri, shkolla dhe fakultete	MTM/Universitetet/Akademia	2023	Programi i edukimit	0,000
Hartimi i programit të edukimit të vazhdueshëm në shkolla të mesme dhe universitete.	MTM dhe AKM/MSHMS/MBZHR/MIE	2019–2023	Seminare	2,000
Organizimi i trajnimeve dhe seminareve për personat që trajtojnë komponime dhe mbetje të NOQ-ve	MTM dhe AKM/MSHMS/MIE/KESH/OSHEE	2019 e në vazhdim	Manual i hartuar	3,000
Hartimi i një manuali për identifikimin dhe trajtimin e sigurt të pajisjeve që përmbajnë komponime të PCB-së.				

3.3 Propozimet dhe prioritetet për ndërtimin e kapaciteteve

Kapaciteti për kimikatet dhe veçanërisht për menaxhimin e NOQ-ve duhet të forcohet në lidhje me objektivat e PKV-së.

Kapaciteti aktual dhe mundësia për menaxhimin e NOQ-ve në Shqipëri duhet të fuqizohet në mënyrë që të arrihen objektivat e PKV-s. Këto nevoja dhe ndërtimi i kapacitetit në mbështetje dhe përputhje me dispozitat e konventës janë theksuar më poshtë për fushat e veçanta prioritare.

1. Ngritja dhe funksionimi i njësisë së NOQ-ve në ministrinë përgjegjëse për mjedisin:

- Monitorimi i përmbushjes së detyrimeve që vijnë nga Konventa e Stokholmit dhe politikat e lidhura me NOQ-të.

- Koordinimi i aktiviteteve të ministrive që adresojnë NOQ-të, dhe sigurojnë shkëmbimin e informacionit.

- Monitorimi i përmbushjes së legjislacionit mjedisor në të njëjtën linjë me direktivat e BE-se mbi NOQ-të.

- Monitorimi i zbatimit të këshillimeve me institucionet dhe ekspertët në lidhje me ato aktivitete që implementohen me qëllim largimin dhe eliminimin e NOQ-ve dhe rehabilitimin e zonave të ndotura.

- Vlerësimi i projekteve të lidhura me NOQ-të.

2. Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Energjinë duhet të sigurojë kapacitetet teknike për menaxhimin e PCB-ve, zëvendësimin e vajrave me PCBs dhe pajisjeve që përdorin këto vajra, si dhe eliminimi i tyre në mënyrë të sigurt mjedisore.

3. Ministria përgjegjëse për energjinë dhe ministria përgjegjëse për mjedisin duhet të hartojnë procedurat për ruajtjen e sigurt të NOQ-ve (kryesisht ato që përmbajnë vajra), dhe pajisje që përmbajnë NOQ deri në eliminimin përfundimtar.

4. Përgatitjen e studimeve dhe projekteve për eliminimin e NOQ-ve ose materialeve/pajisjeve të ndotura me NOQ.

5. Organizimin e trajnimeve dhe seminareve me aktorë të ndryshëm për çështjet që lidhen me monitorimin, kontrollin, ruajtjen e sigurt dhe eliminimin e NOQ-ve.

6. Rritja e ndërgjegjësimit publik për impaktin e NOQ-ve mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

3.4 Përmbledhja e aktiviteteve dhe mjetet financiare të nevojshme për zbatimin e PKV-së

Mjetet financiare të nevojshme për implementimin e PKV-së për periudhën 2019–2024 janë parashikuar të jenë afro **618,500.00 EURO**, ashtu siç paraqiten në tabelën më poshtë.

Tabela 25. Nevojat financiare për periudhën 2019–2024

I. Masat për forcimin e kornizave institucionale dhe rregullatore		Vlera* (euro)
1	Ngritja dhe vendosja në funksionim e njësisë kombëtare për implementimin e Konventës së Stokholmit	87,000

II. NOQ-të dhe pajisjet / materialet që përmbajnë NOQ

1	Përgatitja dhe implementimi i një udhëzimi të brendshëm KESH/OSHEE/OST mbi menaxhimin, trajtimin dhe largimin e transformatorëve që përmbajnë PCB.	69,000
2	Studimi dhe rehabilitimi gradual i vendeve të ndotura me NOQ.	191,000
3	Eliminimi i vajrave, pajisjeve, materialeve, mineraleve etj., të kontaminuara me NOQ.	99,500
4	Përgatitja dhe implementimi i një programi monitorimi kombëtar për NOQ-të.	84,000

III. Ndërgjegjësimi i publikut, informimi dhe përhapja e informacionit, trajnimi dhe zhvillimi

1	Shtimi i informacionit dhe ndërgjegjësimi në komunitetet ku NOQ-të janë të pranishme, duke sensibilizuar publikun rreth efekteve të NOQ-ve mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin.	25,000
2	Fuqizimi i kapaciteteve mjedisore për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe përhapjes së informacionit mbi NOQ-të.	46,000
3	Angazhimi i OJF-ve në përhapjen e informacionit, sensibilizimin dhe fushatat e rritjes së ndërgjegjësimit.	17,000

TOTALI**618,500.00**

Fondet e nevojshme për zbatimin e PKV-së mund të sigurohen nga burime të ndryshme financiare, si: buxheti i shtetit, Bashkimi Evropian, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare për mjedisin, donacionet private etj.

Burimet e financimit të kostove për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ), janë parashikuar të sigurohen si më poshtë:

1. Ngritja dhe funksionimi i një njësie kombëtare për zbatimin e Konventës së Stokholmit, në shumën 87 mijë euro, do të mbulohet nga Ministria përgjegjëse për Mjedisin. MTM-ja është angazhuar që të ngrejë në vitin 2019, Zyrën e Kimikateve. Ligji nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, në nenin 6 të tij, përcakton detyrimin ligjor për ngritjen e Zyrës së Kimikateve, si garanci për zbatimin e legjislacionit të kimikateve dhe përmbushjen e rekomandimeve të bëra në një sërë raportesh të bëra nga ekspertët ndërkombëtarë lidhur me menaxhimin e kimikateve në vendin tonë. Në kuadër të hartimit të kërkesave buxhetore për periudhën 2019–2021, Ministria përgjegjëse për Mjedisin (MTM) ka propozuar si një politikë të re ngritjen e Drejtorisë për Menaxhimin e Kimikateve.

2. Përgatitja dhe implementimi i një udhëzimi dhe kostoja e parashikuar për të është 69 mijë euro. Ky udhëzim do të përgatitet nga stafi i ministrisë në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe nuk parashikon fonde shtesë nga ato të planifikuara në PBA e Ministrisë përgjegjëse për Mjedisin.

3. Studimi dhe rehabilitimi i vendeve të ndotura me NOQ-të dhe vajrave të përdorura është një buxhet i cili do të mbulohet në bashkëpunim me KESH-in, OSHEE-në, që aktualisht kanë dhe stoqet më të mëdha me NOQ-e, si dhe me projekte të bashkëpunimit me UNEP-in dhe GEF-in. Shqipëria ka përfituar në të kaluarën dhe do të vazhdojë të jetë pjesë e këtyre projekteve rajonale të zbatuara kryesisht nga UNEP/MAP, me qendër në Athinë. Të dyja këto zëra të buxhetit janë në shumën e 290.5 mijë euro. Ministria përgjegjëse për mjedisin, ka të planifikuar në PBA, në zërin projekte dhe monitorime, në shumën 50 mijë euro çdo vit, veç shumës së alokuar për AKM-në, si pjesë e fondeve për programin e monitorimit. Për periudhën 5-vjeçare nga ministria mbulohen në shumën e rreth 250 mijë euro dhe rreth 40 mijë euro, synohen të mbulohen nga donatorët dhe programet rajonale të Mesdheut.

4. Përgatitja dhe implementimi i një programi kombëtar monitorimi për NOQ-të, në shumën 84 mijë euro, do të mbulohet nga buxheti i planifikuar për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për monitorimin, si dhe nga fondi i ministrisë për projektet.

5. Lidhur me objektivin e tretë dhe kostot përkatëse për rritjen e kapaciteteve, shtimin e informacionin dhe pjesëmarrjen e OJQ-ve në këtë proces i cili në total shkon në shumën 88 mijë euro, është një buxhet që mbulohet nga buxheti i planifikuar për ministrinë përgjegjëse për mjedisin.

Në përgjithësi buxheti i parashikuar, mbulohet nga fondet e planifikuara për ministrinë e përgjegjëse për mjedisin dhe një pjesë e vogël e tij mbulohet nga projekte të tjera në proces siç janë projekti (tipi Grant) “Vlerësimi fillestar i Minamatës në Shqipëri”, me vlerë 200,000\$ dhe projekti (tipi Grant) për “Sistemin e informacionit mjedisor” me vlerë 1,120,000 \$. Këto projekte zbatohen nga UNDP prej 2016, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe parashikojnë edhe informacionin lidhur me monitorimin e ndotjeve nga kimikatet.

4. ANEKSET

Aneks 1. Listimi i NOQ-ve sipas anekseve të Konventës së Stokholmit

Në bazë të nenit 3 të Konventës, shtetet anëtare që e kanë pranuar atë janë të detyruar të ndalojnë ose të zbatojnë masat për eliminimin, prodhimin, përdorimin, importin dhe eksportin e komponimeve kimike të përfshira në **aneksin A** të Konventës, të cilat janë:

- Aldrin - pesticid i përdorur për të mbrojtur bimët e kultivuara nga insektet e tokës.
- Klorodan –pesticid i përdorur për të mbrojtur bimët e kultivuara nga insektet.
- Dieldrina - pesticid i përdorur për kontrollin e insekteve dhe vektorët e sëmundjeve.
- Endrin - pesticid i përdorur për kontrollin e insekteve dhe për të kontrolluar brejtësit.

- *Heptaklor* – pesticid i përdorur kundër insekteve të tokës dhe termiteve.
- *Hekzaklorobenzen* - pesticid dhe nënprodukt i formuar gjatë prodhimit të substancave të tjera kimike ose mbetje nga djegia e kimikateve.
- *Mireks* - pesticid dhe shtues në plastikë dhe gomë për reduktimin e shkallës së djegies.
- *Toksafen* – pesticid i përdorur te pambuku, drithërat, frutat, aroret dhe perimet, si dhe për të kontrolluar këpushat dhe merimangat në blegtori.
- *Difenilet e poliklorinuara* (PCBs) - substanca kimike që përdoren si vajra në kaloriferë, transformatorë, si shtues në ngjyra dhe plastike, si dhe shtesa në karbon në fotokopje; prodhohen si mbetje edhe gjatë procesit djegies.

Por përveç komponimeve të sipërcituara, NOQ-të e rinj u përcaktuan në vitin 2009 për t'u përfshirë në aneksin A të Konventës, të cilat janë:

- *α-Hekzaklorociklobekzan* - pesticid dhe nënprodukt nga prodhimi i kimikateve të tjera.
- *β-Hekzaklorociklobekzan* - pesticid dhe nënprodukt nga prodhimi i kimikateve të tjera.
- *γ-Hekzaklorociklobekzan* ose *lindani* - pesticid.
- *Klordekon* - pesticid.
- *Hekzabromobifenil* - substancë kimike industriale.
- *Hekzabromobifenil eter* - substancë kimike industriale.
- *Heptabromobifenil eter* - substancë kimike industriale.
- *Pentaklorobenzen* - pesticid, substancë kimike industriale dhe nënprodukt nga prodhimi i kimikateve të tjera.
- *Tetrabromodifenil eter* - substancë kimike industriale.
- *Pentabromodifenil eter* - substancë kimike industriale.

Në aneksin A të Konventës, kimikati endosulfan dhe izomeret e tij (insekticide) janë përfshirë në vitin 2011, ndërsa në vitin 2013 është shtuar gjithashtu komponimi hegzabromociklododekani (HBCD), që është substancë kimike industriale.

Pentaklorofenoli me kripërat dhe esteret e tij të përdorur si pesticide, hegzaklorobutadiene (HCBD) dhe naftalenet e poliklorinuara të përdorura si kimikate industriale janë përfshirë në aneksin A të Konventës në maj 2015.

Një dispozitë e nenit 3 të Konventës ka të bëjë me kufizimin e prodhimit ose përdorimit të substancave kimike të përfshira në **aneksin B** të Konventës, ku futen substanca të tilla si 1,1,1-trikloro-2,2-di (4-klorofenil) etan i njohur si DDT i përdorur gjerësisht në të kaluarën si insekticid.

Në aneksin B të Konventës dy komponimet kimike të reja janë shtuar në vitin 2009 si Acidi perfluorooktan sulfonik dhe floruri i perfluorooktan sulfonilit, të cilat janë kimikate industriale.

Vendet firmëtare të Konventës duhet gjithashtu, sipas nenit 5 të Konventës, të zbatojë masat për parandalimin e formimit dhe emetimit të NOQ-ve të prodhuar joqëllimisht të cilat përfshihen në **aneksin C** të Konventës.

Në këtë grup përfshihen ndotësit si dioksinat dhe furanet. Dioksinat janë emri i një grupi shumë toksik, të cilat janë substanca kimike të poliklorinuara dhe prodhohen kryesisht nga djegia jo e plotë e komponimeve organike.

Grupi i dioksinave përbëhet nga 75 lloje të dibenzo-p-dioksinat (PCDDs) dhe 135 lloje të dibenzofuraneve të polikloruara (PCDFs). Këto substanca nuk janë prodhuar në shkallë industriale, por vetëm në shkallë laboratorike për kërkime. Megjithatë, ata prodhohen në mënyrë jo të qëllimshme gjatë procesit të djegies (karburantit dhe të mbeturinave), si dhe nga proceset e ndryshme industriale si nënprodukte. Dioksinat mund të grumbullohen në yndyrat e njeriut dhe të kafshëve.

Në aneksin C të Konventës futen edhe komponimet si hegzaklorobenzeni dhe bifenilet e

poliklorinuara, të cilat përfshihen edhe në aneksin A të Konventës siç e cituam edhe më sipër. Këto komponime prodhohen në mënyrë jo të qëllimshme gjatë procesit të djegies jo të plotë të komponimeve organike. Gjithashtu, në këtë aneks janë futur edhe pentaklorobenzeni në vitin 2009 dhe naftalenet e poliklorinuara që janë përfshirë në vitin 2015, por këto komponime janë pjesë edhe e aneksit A të Konventës.